

ROLI I SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAS NË MENAXHIMIN E KRIZAVE NË SHQIPËRI:

**Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit
2019 dhe pandemia COVID-19**



ROLI I SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAS NË MENAXHIMIN E KRIZAVE NË SHQIPËRI:

Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19



Ekipi hulumtues: Blerjana Bino, Orkidea Xhaferaj, Lutjona Lula

Autorët prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci.

Tiranë, nëntor 2020

Objektivi i këtij publikimi është të ofrojë një analizë të thellë në lidhje me OSHC-të dhe angazhimin e mediave në menaxhimin e krizave në Shqipëri duke vlerësuar me kujdes rolin e OSHC-ve dhe mediave gjatë tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019 dhe pandemisë së koronavirusit. Një pjesë e rëndësishme e publikimit është të japësh rekomandime se çfarë mund të përmirësohet në drejtim të një roli më efektiv të shoqërisë civile dhe medias në menaxhimin e krizave.

Para pandemisë koronavirusit, Shqipëria u godit nga një tërmet shkatërrues i nëntorit të vitit 2019. Si tërmeti, ashtu edhe pasojat e tij dhe pandemia e vazhdueshme mund të konsiderohen si kriza të paprecedent për një vend si Shqipëria.

Një raport i publikuar së fundmi nga aleanca globale e shoqërisë civile CIVICUS, 'Solidariteti në kohën e COVID-19', thekson rolin e pazëvendësueshëm të aktivistëve, OJQ-ve dhe organizatave bazë gjatë pandemisë dhe u bën thirrje shteteve të punojnë me shoqërinë civile për të lehtësuar ndikimin e COVID-19 dhe për të krijuar një botë më të mirë post-pandemike.

Një studim i WFD mbi pjesëmarrjen e OSHC-ve në vendimmarrjen në Shqipëri vëren një luhatje të misionit të OSHC-ve si rezultat i qëndrueshmërisë së dobët me ndikim të kufizuar në transformimin aktual shoqëror, politik dhe ekonomik. Ndërsa sektori i shoqërisë civile është zgjeruar për sa i përket numrit të përgjithshëm të OSHC-ve jashtë Tiranës gjatë pesë viteve të fundit, kjo nuk ka rezultuar në konsolidimin e një shoqërie civile të gjallë dhe të mirëfilltë. Si institucionet publike dhe OSHC-të duhet të angazhohen në pjesën e tyre të përgjegjësive për një bashkëpunim efektiv.

Shpresojmë që ky studim të përmirësojë më tej diskursin kombëtar në drejtim të përmirësimeve të nevojshme për një angazhim efektiv të OSHC-ve dhe mediave në ngjarje të tilla të pazakonta.

Studimi u realizua nga një treshe studiuesish, Blerjana Bino, Orkidea Xhaferaj dhe Lutjona Lula dhe u mbështet nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD). Fondacioni dëshiron të falënderojë studiuesit për përkushtimin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti.

WFD është një organ publik në Mbretërinë e Bashkuar i përkushtuar për të mbështetur demokracinë në të gjithë botën. Në gusht 2018, WFD filloi një Nismë

të re Rajonale të Ballkanit Perëndimor tre-vjeçar me titull 'Iniciativa për Demokracinë e Ballkanit Perëndimor '. Nisma financohet nga Fondi i Konflikteve, Stabilitetit dhe Sigurisë i Qeverisë Britanike.

Sokol Haxhiu

Përfaqësuesi në Shqipëri i WFD

Studimet kanë konfirmuar se organizatat e shoqërisë civile dhe media luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizave dhe fatkeqësive, veçanërisht në përgjigjen ndaj emergjencave, në operacionet e ndihmës dhe shpëtimit, dhe në periudhën e rimëkëmbjes dhe përgatitjes si dhe në zbutjen e rreziqeve. Shqipëria është përballur me kriza të njëpasnjëshme të paprecedentë gjatë vitit të kaluar, fillimisht me tërmetin shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019 dhe më pas me shpërthimin e pandemisë Covid-19, që po evidentohet jo vetëm si krizë e shëndetit publik, por edhe si krizë social-ekonomike. Duke pasur parasysh sa më sipër, në këtë studim kryhet një analizë e thelluar e OSHC-ve dhe mediave në krizat e fundit në Shqipëri duke vlerësuar me kujdes rolin e OSHC-ve dhe mediave gjatë tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019 dhe pandemisë Covid-19.

Për këtë studim u përdor qasje e hulumtimit cilësor me një kuadër të konsoliduar analitik dhe shpjegues ku u përdorën intervista të thelluara (13), diskutime në fokus grupe (2) dhe seminare vleftësimi (1) si dhe analiza e përmbajtjes së artikujve të botuar nga media për tërmetin dhe pandeminë. Këto të dhëna parësore u mbështetën me shqyrtimin e literaturës dhe burimeve dytësore nëpërmjet punës kërkimore në zyrë. Kjo qasje bën të mundur një analizë të thelluar të rolit të shoqërisë civile dhe medias në periudha krize. Gjithsesi, në studimet e mëtejshme duhet të merret parasysh ndërthurja e metodave cilësore me ato sasiore për analizimi e rolit të medias, veçanërisht, gjatë krizave.

Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit 2019

► Tiparet kryesore të rolit të shoqërisë civile

Organizatrat e shoqërisë civile, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë kombëtar, mobilizuan burimet e tyre për të ofruar mbështetje në periudhën e emergjencës. Ato ofruan mbështetje të drejtpërdrejtë me mbledhje fondesh nga anëtarët e tyre dhe nga donacionet. Ato shërbyen si pika ndërlidhëse informimi mes familjeve të prekura dhe atyre që ofronin ushqime dhe materiale të tjera të nevojshme. Puna e brendshme dhe praktikrat e zakonshme të punës së OSHC-ve përgjithësisht nuk u prekën drejtpërsëdrejti dhe reagimi i këtij sektori ishte i menjëhershëm. Pjesa më e madhe e organizatave arritën të mblidhnin donacione me ushqime dhe veshmbathje, ndërkohë që OSHC-të kombëtare u angazhuan kryesisht në fushën humanitare, duke siguruar edhe ndihmë financiare për rindërtimin. Më e rëndësishmja, ndihma psikologjike që u ofrua me anë të vullnetarëve, veçanërisht

në kampe, ishte me rëndësi të madhe për qytetarët e prekur.

Gjithsesi, nga ana tjetër, shqetësimi kryesor i ngritur nga OSHC-të ishte mungesa e koordinimit të autoriteteve publike me të gjithë aktorët për t'iu përgjigjur krizës menjëherë. Në disa raste u vu re mungesa e koordinimit dhe donacionet u shpërndanë vetëm në një destinacion duke lënë të pambuluara zonat e tjera të prekura. Një tjetër sfidë ishte të punoje ndërkohë që duhej trajtuar edhe frika personale gjatë punës në terren. Kontaktet dhe rrjeti i OSHC-ve ishin kanali i komunikimit për koordinim teksa bashkitë nuk jepnin asnjë përditësim të situatës. Për OJF-të vendore, siç deklarojnë ata, “zyrat e boshatisura të bashkive” ishin problemi kryesor. Për më tepër, edhe menaxhimi i kohës dhe reagimi i shpejtë për mbledhjen dhe shpërndarjen e ndihmave ishin sfidë më vete, veçanërisht duke pasur parasysh koordinimin e pamjaftueshëm me autoritetet publike përgjegjëse për menaxhimin e krizës. Një shqetësim tjetër i ngritur ishin identifikimi i kauzave që kishin nevojë për mbështetje dhe koordinimi me aktorë të tjerë për ofrimin e ndihmës/shërbimit të nevojshëm.

► Tiparet kryesore të rolit të medias

Ky studim konfirmon rolin e pazëvendësueshëm që media luajti menjëherë pas tërmetit duke dhënë informacione, duke u mobilizuar dhe duke u përqendruar në histori të jetës njerëzore dhe rritje të ndërgjegjësimit. U përdorën edhe mediat sociale për të kërkuar ndihmë, për të rritur ndërgjegjësimin, për të mbledhur fonde, për të mobilizuar vullnetarë, dhe për të organizuar e koordinuar ndihmën dhe mbështetjen. Mbulimi i tërmetit nga media lidhet me fazat e njëpasnjëshme të katastrofës: goditja nga tërmeti, operacionet e shpëtimit, ndihma, rimëkëmbja dhe pasojat. Aspektet më të spikatura të përdorura për të strukturuar lajmet ishin: interesi dhe siguria njerëzore, dëmet dhe pasojat, caktimi i përgjegjësive, solidariteti dhe mobilizimi, rindërtimi dhe mbështetja ndërkombëtare. Zhvillim pozitiv në këtë aspekt ishte hapësira mediatike që iu dha ekspertëve, inxhinierëve dhe shkencëtarëve. Gjithsesi, roli i institucioneve akademike dhe shkencore ishte i kufizuar, ku ekspertë të caktuar merrnin vëmendjen kryesore, gjë që nxjerr në pah mangësitë e arsimit të lartë dhe sektorit të hulumtimeve në Shqipëri. Vihen re edhe disa funksione vëzhguese të mediave, veçanërisht në lidhje me caktimin e përgjegjësive për krizën. Mediat sociale u përdorën edhe për të denoncuar abuzimet dhe keqmenaxhimin, edhe kur kjo gjë nuk mbulohej nga mediat kryesore. Megjithatë, në aspektin negativ mund të thuhet se ndjekja e mëtejshme e problematikës ka qenë në nivel të ulët dhe investigimet e mediave për pasojat e tërmetit apo për aktorët përgjegjëse kanë qenë të kufizuara. Një shqetësim madhor i ngritur nga profesionistët e medias dhe nga aktorë të tjerë ishte se ka pasur kufizime në aksesin e medias tek informacioni publik për shkak të mungesës së transparencës nga institucionet qeveritare dhe vonesave apo shmangieve në zbatimin e Ligjit për Konsultimet Publike. Një çështje tjetër kryesore ishte përhapja e lajmeve të rreme dhe disinformimi, veçanërisht në mediat sociale dhe portalet e lajmeve në internet.

Për sa i përket mediave sociale, studimi nxjerr në pah një mungesë të dukshme të aktiviteteve për uljen e rrezikut dhe të masave parandaluese në panoramën e mediave sociale pa asnjë strategji specifike për komunikimin e krizës para 26 nëntorit 2019. Informacionit dhe provave shkencore në lidhje me tërmetet e Shqipërisë nuk iu kushtua vëmendje e veçantë, pavarësisht se vendi konsiderohet si zonë me aktivitet të lartë sizmik. Nga ana tjetër, mediat sociale ishin jetike në përhapjen e lajmeve për tërmetin katastrofik. Postimet, ripostimet dhe rishpërndarjet e analizave, komenteve, paralajmërimeve dhe përmbajtjeve të tjera ishin tejet të shumta në numër. Mediat sociale shërbyen edhe për të mbushur boshllëkun e informacionit, të shkaktuar nga autoritetet duke përdorur burime alternative informacioni. Gjithsesi, kjo gjë nxori në pah të metat e veta për sa i përket cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit. Mediat sociale u shërbyen autoriteteve publike për të përhapur edhe më shumë mesazhet dhe informacionin zyrtar, duke plotësuar kështu dhe ndonjëherë duke vepruar më shpejt sesa vetë mediat kryesore. Për mbledhjen e donacioneve, inkurajimin e vullnetarizmit dhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese u përdor kryesisht Facebook, i cili ishte vendimtar. Mediat sociale shërbyen edhe për të përçuar mesazhet për rilidhjen e familjeve dhe komuniteteve dhe për rikthimin e jetës në komunitete dhe të aktiviteteve të biznesit. Dhomat e ekos (grupimet ideologjike) dhe “karremat e klikimeve” mbetën, gjithsesi, shqetësimet kryesore në lidhje me përhapjen dhe cilësinë e informacionit në hapësirën virtuale.

COVID-19 më shumë se një krizë e shëndet publik

▶ Tiparet kryesore të rolit të shoqërisë civile

Ndikimi i COVID-19 në sektorin e shoqërisë civile ishte shumë më i madh sesa në rastin e tërmetit. Pandemia dhe masat e mëpasshme që u morën ndikuan drejtpërdrejtë në punën e OSHC-ve në nivel kombëtar. Edhe pse me vështirësi, sektori ia doli ta zhvendoste online pjesën më të madhe të punës dhe të përshtatej me formën e “punës nga shtëpia”. Projektet vazhduan online dhe donatorët në përgjithësi i pranuan ndryshimet financiare. OSHC-të kanë përdorur forma alternative të bashkëpunimit dhe të punës me grupet e synuara dhe aktorët kryesorë duke shfrytëzuar mundësitë që ofrohen nga mjetet dixhitale.

Gjithsesi, pas konfuzionit fillestar dhe disa ri-orientimeve, OSHC-të ofruan mbështetje në shtëpi, në komunitete dhe online dhe ndërmorën nisma të reja për të ofruar shërbime të kujdesit shëndetësor për pacientë me sëmundje kronike, në kujdesin paliativ dhe të tjera. Organizatat humanitare ofruan mbështetje emergjence dhe në zbatimin e programeve të periudhës së pas-rimëkëmbjes. U vunë re forma të ndryshme aktivizmi, veçanërisht në lidhje me shembjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar.

Nga ana tjetër, vazhdojnë ende disa kufizime kryesore. OSHC-të në nivel vendor kanë më pak mundësi për të siguruar mjetet online dhe në fillim u përballën me sfida për sa i përket aftësive në përdorimin e teknologjisë. Ndikimi i projektit

nuk ishte ai që ishte parashikuar, pasi disa nga grupet e synuara nuk mund të arriheshin dot dhe nuk kishin të njëjtin nivel efekti, si operacione fizike apo ato në terren. Kjo u vu re më së shumti për OSHC-të vendore dhe të vogla që veprojnë kryesisht me projekte të financuara nga donatorë, ndonëse ato ia dolën të mobilizonin vullnetarë në ndihmë të komunitetit të tyre (me mbështetje online apo me shpërndarje maskash). Në zonat e prekura nga tërmeti (Durrës dhe Lezhë), Covid-19 u mbulua nga OSHC-të me ndihma të drejtpërdrejta, duke qenë se këshillat bashkiakë kanë ende në planin e tyre të punës rindërtimin duke lënë mënjanë sektorët e tjerë. Një çështje tjetër e ngritur është mungesa e një zyre të vetme për menaxhimin e emergjencave dhe për informim për të ofruar informacion të saktë dhe për të qenë burimi kryesor i informacionit që koordinon, kontrollon dhe ofron informacione dhe të dhëna të sakta. Në tre muajt e parë pas shpërthimit të pandemisë vihet re një rënie e konsiderueshme për sa i përket proceseve demokratike gjatë periudhës së Covid-19, me një rol të kufizuar të OSHC-ve për t'i kërkuar llogari organeve të qeverisjes. Ndërkohë që pandemia u instrumentalizua edhe më shumë nga Qeveria për të zgjeruar kompetencat e saj ekzekutive, aktorët e shoqërisë civile u antagonizuan nga procesi i vendimmarrjes pa asnjë konsultë efektive gjatë pandemisë. Duke marrë parasysh krizën e përhershme politike, kriza Covid-19 ka nxjerrë në pah edhe më tej brishtësinë e proceseve demokratike shqiptare dhe sistemi i kontrolleve dhe ekuilibrave mbetet në një situatë të pasigurt.

► Tiparet kryesore të rolit të medias

Mediat përballen me sfida serioze gjatë krizës së Covid-19 për sa i përket lirisë dhe sigurisë, si rreziqet për shëndetin dhe sigurinë me të cilat përballen gazetarët dhe stafi i medias gjatë raportimit nga terreni me njohuri, infrastrukturë dhe procedura të pamjaftueshme të raportimit në kohë pandemie për të mbrojtur vetveten, për të mbrojtur të tjerët dhe në mungesë të udhëzimeve për etikën. Raporte të ndryshme konfirmojnë se vazhdon ende një klimë pasigurie, frikësimi dhe presionesh ndaj gazetarëve me një trend të qartë të rënies së lirisë së medias dhe tkurrjes së hapësirës së mediave kritike dhe të pavarura. Covid-19 vuri në vështirësi punën e medias, veçanërisht për sa i përket burimeve financiare, me rënie të reklamave dhe media që nuk dalin më në shtyp ose që falimentojnë. Ndërkohë që rritej nevoja nga media për informacion të saktë dhe të besueshëm gjatë krizës, media u përball me mungesë të aksesit në informacion dhe mungesë transparence ku qeveria kishte monopolizuar informacionin publik. Analiza e përmbajtjes tregon se aspektet kryesore të mbulimit nga mediat të Covid-19 ishin frika nga “armiku i padukshëm” interesi njerëzor, shëndeti dhe siguria publike, rritja e ndërgjegjësimit, ndikimi dhe e ardhmja. Pak media e kanë përdorur Qeverinë si dritare shpëtimi, veçanërisht në fazat e hershme të shpërthimit të pandemisë. Si për krahasim, media të tjera u përqendruan më shumë te kritikant ndaj qeverisë për përgjigjen dhe menaxhimin e krizës.

Roli i mediave sociale gjatë pandemisë Covid-19 është i ngjashëm si në rastin e tërmetit. Edhe pse media raportoi shpërthimin e virusit në Kinë dhe më pas

në Evropë, veçanërisht në Itali, nuk ka qëndresë të dukshme të komunitetit që mbështeten te mediat sociale para mesit të marsit 2020. Media sociale ishte jetike me raportimin e lajmeve për shpërthimin e pandemisë Covid-19. Postimet, ripostimet dhe rindarja e analizave, komenteve, paralajmërimeve dhe përmbajtjeve të tjera ishin masive. Po ashtu, ishin të pranishme edhe komentet, postimet dhe njoftimet me përmbajtje të pavërtetë që nxisnin panik, ku lajmet e rreme u bënë virale. Mediat sociale u përdorën edhe nga OSHC-të për rritjen e ndërgjegjësimit, për koordinimin dhe sigurimin e mbështetjes për grupe të ndryshme. Gjithsesi, lajmet e rreme, disinformimi dhe teoritë e konspiracionit ishin edhe më dominuese sesa gjatë tërmetit. Dhomat e ekos (grupimet ideologjike) dhe “karremat e klikimeve” mbetën, gjithsesi, shqetësimet kryesore në lidhje me përhapjen dhe cilësinë e informacionit në hapësirën virtuale. Pavarësisht kësaj, mediat sociale luajtën një rol jetik në komunikimin, mirëqenien psikologjike, qëndresën e komunitetit, thirrjen për ndihmë, mbledhjen e donacioneve dhe denoncimin e abuzimeve.

Në përgjithësi, studimi nxjerr në pah për rolin thelbësor të medias si një ofrues i rëndësishëm informacioni mes frikës dhe mungesës së informacionit. Media dha informacione shumë të rëndësishme me fushata ndërgjegjësimi dhe ofroi hapësirë të bollshme për ekspertët, mjekët dhe zyrtarët e shëndetit publik. Raportimet e vazhdueshme nga terreni, veçanërisht nga spitalet, treguan mangësi në menaxhimin e krizave, të cilat publiku nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për t'i mësuar, duke marrë parasysh mungesën e informacionit nga burimet qeveritare. Media shfrytëzoi teknologjinë e përparuar dhe arriti të ndërthurë raportimin profesional me përmbajtjen e krijuar nga qytetarët. Programimi u përshtat me masat e mbylljes përmes përdorimit të platformave online.

Nga ana tjetër, media evidenton mungesën e aksesit tek informacioni me izolimin, mungesën e transparencës, monopolizimin e informacionit, informacione kontradiktore dhe çoroditëse si probleme kryesore që bëhen pengesë për rolin e tyre. Politizimi i medias shqiptare vazhdoi. Gjatë javëve të para të pandemisë, pati një ton përgjithësisht pozitiv ndaj qeverisë dhe u kryen fare pak funksione monitorimi. Megjithatë, teksa pandemia u bë “normaliteti i ri”, media rimori nuancat e saj të zakonshme të kornizimit së bashku me interesat politike dhe të tjera. Disa media të krijuara kohët e fundit dhe disa portale online mbeten profesionale.

REKOMANDIMET KRYESORE

Të ngrihen kapacitetet e OSHC-ve në Shqipëri për përgatitjen për krizat, me plane të hartuara për emergjenca, si për organizimin e brendshëm dhe operacionet ditore ashtu edhe për komunitetin dhe punën e tyre me grupet përkatëse të synuara. Planet e emergjencës duhet të shoqërohen me informimin dhe trajnimin e stafit për menaxhimin e krizave. Siç treguan krizat, OSHC-të vendore duhet të jenë të përgatitura dhe të trajnuara për t'u përshtatur me ndryshimin e kushteve në mënyrë që ato të vazhdojnë të ofrojnë shërbime dhe të përmbushin objektin

e tyre të punës edhe në kohë krize. Prandaj, është me rëndësi të madhe të hartohen programe për ngritjen e kapaciteteve për organizmin e brendshëm të punës në kohë krize.

Qeveria duhet të përfshirë aktivisht OSHC-të në mënyrë të zyrtarizuar për çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e krizave në nivel qendror dhe vendor, për shembull, duke caktuar një pikë kontakti për shoqërinë civile në bashki për të shkurtuar distancën mes OSHC-ve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore jo vetëm gjatë krizave por edhe në situata normale. Të rivihet në punë Komiteti Kombëtar i Shoqërisë Civile me një seksion të veçantë për menaxhimin e krizave. Të jetë më e pranishme në komunitetet vendore me informacione për parandalimin e fatkeqësive duke komunikuar me ta me anë të mediave vendore dhe në veprimtari të ndryshme me vetë komunitetet. Po ashtu, është e nevojshme që OSHC-të të përfshihen dhe të marrin pjesë realisht në strukturat kombëtare të emergjencave civile.

Duhet të përmirësohen koordinimi dhe kapacitetet e rrjetëzimit të OSHC-ve si së brendshmi ashtu edhe në sektor. Rrjetet aktuale të ngritura nga projekte të ndryshme mund të shërbejnë për përmirësimin e koordinimit sektorial.

Komuniteti i donatorëve duhet të mbështesë zhvillimin e një burimi vullnetarësh dhe platforme koordinimi me rakordim mundësish, oraresh, vendesh dhe nevojash të grupeve të synuara me OSHC-të, institucionet publike, biznesin, mediat dhe të tjerët për të mobilizuar vullnetarët.

Bashkëpunimi ndërsektorial, veçanërisht me mediat, biznesin dhe autoritetet vendore, për t'iu përgjigjur nevojave vendore në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë, të përqendrohet domosdoshmërisht në angazhimin e komunitetit dhe në programet e shkrim-këndimit për forcimin e ndërgjegjësimit dhe rritjen e njohurive në lidhje me menaxhimin dhe reagimin ndaj krizave.

OSHC-të duhet të jenë më aktive në sinjalizimin e hapave prapa të demokracisë dhe në hartimin e një qasjeje për të drejtat e njeriut në menaxhimin e fatkeqësive, për transparencën fondeve dhe dhurimeve, kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë për punën e saj, për të drejtat e njeriut, për lirinë e medias, për anti korrupsionin dhe për të tjera.

Mbështetje për verifikimin e fakteve dhe gazetarinë investigative dhe prezantimin e historive të thelluara, me anë të të cilave qytetarët të kuptojnë proceset dhe marrëdhëniet dhe jo të japin thjesht fakte të thata.

Mbështetje me nën-grante (grante bazë) për median profesionale dhe të pavarura që luftojnë për mbijetesën e tyre gjatë krizave ose krijimi i një fondi për të ofruar mbështetje institucionale për mediat dhe gazetarët si dhe për organizatat e mediave me gazetari cilësore.

Ofrimi i mbështetjes për prodhimin e përmbajtjeve specifike (tema pak të raportuara, tema interaktive me elementë pamorë dhe multimedialë, çështje angazhimi, pjesëmarrje e publikut, monitorime).

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE	3
PËRMbledhje EKZEKUTIVE	4
SHKURTIME	10
LISTA E KUTIVE	11
LISTA E FIGURAVE	11
LISTA E TABELAVE	11
1 - HYRJE	15
2 - METODOLOGJIA	17
3 – KUADRI KONCEPTUAL: OSHC-TË DHE MEDIA NË KOHË KRIZASH	25
3.1 OSHC-TË DHE KRIZA: NGA REAGIMI NË RASTET E EMERGJENCËS TE ZVOGËLIMI I . RREZIKUT NGA KATASTROFAT	25
3.2 MEDIA NË KOHË KRIZASH.....	27
4 – KONTEKSTI DHE KRIZAT E MËDHA TË KOHËVE TË FUNDIT NË SHQIPËRI	40
4.1 TËRMETI I NËNTORIT 2019	41
4.2 PANDEMIA COVID-19	43
4.3 SHOQËRIA CIVILE DHE MEDIA NË SHQIPËRI	44
4.4 OSHC DHE MEDIA NË LIGJIN PËR MBROJTJEN CIVILE.....	51
5 – STUDIME DHE ANALIZA E RASTEVE	53
5.1 OSHC-TË DHE MEDIA GJATË TËRMETIT SHKATËRRIMTAR TË NËNTORIT 2019.....	53
5.1.1 SHOQËRIA CIVILE MBUSH BOSHLLËKUN: PËRGJIGJA DHE RIMËKËMBJA NËPËRMJET SOLIDARITETIT DHE QËNDRESËS	53
5.1.2 ROLI I MEDIAS NË KRIZËN E TËRMETIT	62
5.2 SHOQËRIA CIVILE DHE MEDIA GJATË PANDEMISË COVID-19	70
5.2.1 SHOQËRIA CIVILE DHE COVID-19.....	70
5.2.2 MEDIA DHE COVID-19	80
6 – PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	90
6.1 PËRFUNDIMET	91
6.2 REKOMANDIMET KRYESORE.....	92
6.2.1 REKOMANDIME KRYESORE PËR ROLIN E SHOQËRISË CIVILE NË KOHË KRIZASH.....	92
6.2.2 REKOMANDIME KRYESORE PËR ROLIN E SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIA NË KOHË KRIZASH.....	94
7 – SHTOJCAT	97
SHTOJCA 1 – REFERENCA.....	97
SHTOJCA 2 – PROGRESI I PAKETAVE TË NDIHMËS TË QEVERISË SË SHQIPËRISË PËR TË ADRESUAR ÇËSHTJET E SHKAKTUARA NGA COVID-19	105
SHTOJCA 3 – SHEMAJ TË PËRGJIGJEVE TË SHOQËRISË CIVILE NDAJ COVID-19	107

LISTA E KUTIVE

KUTIA 1: KEY FUNCTIONS OF CSOS IN DISASTER MANAGEMENT	25
KUTIA 2: ROLI I OSHC-VE NË REDUKTIMIN E RREZIKUT TË FATKEQËSIVE.....	27
KUTIA 3: FAZAT E KOMUNIKIMIT TË RREZIKUTN	28
KUTIA 4: COVID-19 DHE SFIDAT E KËSHILLAVE ME BAZË SHKENCORE NË SHBA DHE VENDE TË TJERA	29
KUTIA 5: SHEMBUJ TË MBULIMIT NGA MEDIA DHE ROLIT TË SAJ NË FATKEQËSI.....	31
KUTIA 6: LUFTA E MEDIAS NË RASTIN E NEPALIT: TËRMETI I 25 PRILLIT 2015	32
KUTIA 7: COVID-19 DHE TWITTER.....	33
KUTIA 8: KONSUMIMI I LAJMEVE DHE COVID-19 NË BRITANINË E MADHE	37
KUTIA 9: KËNDVËSHTRIMI I MEDIAVE TË LAJMEVE ONLINE PËR PANDEMINË COVID-19	39
KUTIA 10: DËMET NGA TËRMETI I NËNTORIT 2019	40
KUTIA 11: PARIMET E RINDËRTIMIT	42
KUTIA 12: MBËSHTETJA E QEVERISË PËR ARSIMIN	44
KUTIA 13: PAKETA ANTISHPIFJE DHE PËRPPJEKJET PËR TË RREGULLUAR MEDIAN ONLINE.....	49
KUTIA 14: SHOQËRIA CIVILE I PËRGJIGJET TËRMETIN - SHEMBUJ.....	55
KUTIA 15: KOORDINIMI DHE RASTI I KOMITETIT TË RINDËRTIMIT.....	59
KUTIA 16: SHEMBUJ TË MONITORIMIT TË OSHC-VE TË MENAXHIMIT TË KRIZËS SË TËRMETIT	61
KUTIA 17: PLATFORMA TË NDIHMËS ONLINE GJATË COVID-19.....	74
KUTIA 18: SHEMBUJ TË FONDEVE TË ANGAZHUARA PËR TË TRAJTUAR KRIZËN E COVID-19	75
KUTIA 19: SFIDAT NDAJ LIRISË SË MEDIAS GJATË PERIUDHËS SË COVID-19	80
KUTIA 20: SHEMBUJ TË FUSHATAVE TË MEDIAS PËR RITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT.....	81
KUTIA 21: KRYEMINISTRI DHE LAJMET E RREME	82

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1: LLOJI I PËRGJIGJES SË OSHC-VE NË KRIZËN E TËRMETIT	58
FIGURA 2: PËRGJIGJET E OSHC-VE GJATË COVID-19	73

LISTA E TABELAVE

TABELA 1: KAMPIONI I INTERVISTAVE TË THELLUARA.....	19
TABELA 2: SHEMBULL I TË INTERVISTUARVE NGA SEKTORI I SHOQËRISË CIVILE.....	19
TABELA 3: SHEMBULL I TË INTERVISTUARVE NË SEKTORIN E MEDIAS.....	20
TABELA 4: PËRKUFIZIMI OPERACIONAL PËR ANALIZËN E PËRMBAJTJES.....	21
TABELA 5: SHEMBULL I ANALIZËS SË PËRMBAJTJES (NUMRI I ARTIKUJVE).....	22
TABELA 6: CIVIL SOCIETY FOCUS GROUP PARTICIPANTS.....	22
TABELA 7: PJESËMARRËS FOKUS GRUP NGA MEDIA.....	23
TABELA 8: PJESËMARRËS NË WORKSHOPIN VALIDUES.....	23
TABELA 9: ROLI I MEDIAVE SOCIALE NË MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE.....	35
TABELA 10: TË DHËNA PËR OSHC E VETË-DEKLARUARA NË FAQEN E AMSHC.....	46
TABELA 11: PANORAMA E MEDIAS NË SHIFRA.....	48
TABELA 12: PËRFITUESIT E DONACIONEVE.....	56
TABELA 13: TIPARET KRYESORE TË ROLIT TË SHOQËRISË CIVILE NË KRIZËN E TËRMETIT.....	62
TABELA 15: ROLI I MEDIAS SOCIALE NË MENAXHIMIN E KRIZËS TË SHKAKTUAR NGA TËRMETI.....	67
TABELA 16: TIPARET KRYESORE TË ROLIT TË MEDIAS- TËRMETI SHKATËRRIMTAR I 26 NËNTORIT 2019.....	69
TABELA 17: KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË ROLIT TË SHOQËRISË CIVILE NË PANDEMINË COVID-19 NË SHQIPËRI.....	79
TABELA 18: RAPORTIMI NGA MEDIA I PANDEMISË COVID-19.....	85
TABELA 19: ROLI I MEDIAS SOCIALE GATË PANDEMISË COVID-19.....	86
TABELA 20: TIPARET KRYESORE TË ROLIT TË MEDIAS NË PANDEMINË COVID-19 NË SHQIPËRI.....	89

Shoqëria civile aktive dhe pjesëmarrëse është me rëndësi të jashtëzakonshme për Shqipërinë në përballimin me sukses të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në zbatimin e reformave të rëndësishme, në trajtimin e shqetësimeve aktuale në lidhje me nivelin dhe cilësinë e demokracisë dhe kapërcimin e vështirësive dhe forcimin e qëndrësës në dritën e krizave të fundit: tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19. Raporti Vjetor i Komisionit Evropian 2020 për Shqipërinë thekson edhe një herë se *“shoqëria civile e fuqizuar është një përbërës thelbësor i çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet e trajtohet si e tillë nga institucionet shtetërore.”*¹ Me hapjen e negociatave të pranimit të Shqipërisë në pranverën e vitit 2020, del në pah nevoja e qartë për bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë mes qeverisë dhe shoqërisë civile.

Në Shqipëri, të dy krizat e njëpasnjëshme, tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19, tregojnë se asnjë sektor nuk mund të zgjidhë i vetëm sfidat e mëdha shoqërore, ekonomike dhe shëndetësore. Për këtë kërkohet angazhim në partneritete dhe bashkëpunim mes aktorëve të shoqërisë civile, mediave, institucioneve publike, bizneseve dhe aktorëve të tjerë. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm edhe në dritën e përhapjes së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe rrjeteve sociale e mediave online që kanë krijuar hapësira për konfigurime të reja të aktorëve, duke çuar në rritje të konsiderueshme të aktivitetit online të shoqërisë civile dhe duke mundësuar që të krijohen rrjete me ndikim e menjëherë të mobilizueshme sipas ndarjeve gjeografike, sociale dhe fizike brenda Shqipërisë, rajonit dhe më gjerë. Kështu, është me rëndësi të madhe të hulumtohet roli aktual i OSHC-ve në menaxhimin e dy krizave të mëdha në Shqipëri, që janë tërmeti dhe pandemia Covid-19.

Edhe roli i medias në kohë krizash ka rëndësi të madhe. Mediat shqiptare kanë përjetuar transformime të jashtëzakonshme për t’iu përgjigjur ndryshimeve social-kulturore, politike dhe ekonomike në vend dhe përhapjes së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe tendencave globale të medias. Për sa i përket medias, kriza e Covid-19 duket se po i intensifikon edhe më shumë sfidat e mëdha me të cilat përballlet media sot.² Kjo situatë përkeqësohet më tej nga një kombinim

1 Komisioni Evropian, Raporti Vjetor 2020, Shqipëri, p. 14 gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (aksesuar më 22 tetor 2020).

2 Sittig, H., & Fabijanić, D., “State of Emergency: Corona, the Media and new Rules in South East Europe”, Country Reports, Konrad Adenauer Stiftung, 2020, <https://www.kas.de/en/web/medienn-europa/laenderberichte/detail/-/content/state-of-emergency-corona-the-media-and-new-rules-in-south-east-europe> (aksesuar më 4 tetor, 2020).

i faktorëve të tjerë, si cilësia e dobët dhe profesionalizmi i gazetarisë, marrëdhëniet simbiotike mes medias, politikës dhe biznesit, niveli i ulët i besimit tek institucionet publike, njohuritë e pakta mediatike, dhe mungesa e qëndrueshmërisë financiare që i shtojnë mediat të gjuhëzohen para lajmit sensacional, interesave politike dhe të biznesit³. Në këtë kontekst, është e domosdoshme të bëjmë një vlerësim tërësor të rolit i OSHC-ve dhe medias në menaxhimin e dy krizave të paprecedenta në Shqipëri dhe të jepen rekomandime se si të përmirësohet më tej roli i tyre.

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është të bëjë një analizë të thelluar të angazhimit të OSHC-ve dhe medias në menaxhimin e dy krizave të fundit në Shqipëri duke vlerësuar me kujdes rolin e OSHC-ve dhe medias gjatë tërmetit shkatërrimtar të nëntorit 2019 dhe pandemisë Covid-19. Objektivat specifike të këtij studimi janë:

- ▶ Të bëjë një analizë të thelluar të rolit të OSHC-ve dhe medias gjatë tërmetit shkatërrimtar të nëntorit 2019;
- ▶ Të bëjë një analizë të thelluar të rolit të OSHC-ve dhe medias gjatë pandemisë Covid-19;
- ▶ Të japë përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të angazhimit të OSHC-ve dhe medias në ngjarje të tilla të pazakonta.

Për këtë studim është aplikuar një qasje e hulumtimit cilësor me një kuadër të konsoliduar analitik dhe shpjegues. Qasja e hulumtimit cilësor bën të mundur të shqyrtohet më në thellësi dhe në mënyrë të gjithanshme tema nëpërmjet aplikimit të metodologjisë sistematike cilësore. Interpretimi i gjetjeve të kërkimit bazuar në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave do të mbushin boshllëkun në lidhje me situatën aktuale dhe do të ofrojë mendime për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Prandaj, tipari kryesor i këtij hulumtimi është veçantia e tij dhe shqyrtimi në thellësi i objektivave të veçanta të përzgjedhura të hulumtimit, ndryshe nga metoda sasiore që përpiqet të përgjithësojë gjetjet dhe të konfirmojë lidhjet shkak-pasojë. Metodologjia shtjellohet në pjesën e mëposhtme të këtij studimi.

Kështu, raporti është i strukturuar në tre pjesë kryesore: kuadri konceptual, analiza e studimeve të rastit, dhe përfundimet e rekomandimet.

3 Bino, B. & Marko, D. (2020) Assessment of media developments in Albania and Western Balkans and donor funding in time of COVID-19, in light of the project Supporting Greater Media Independence in Western Balkans.

2 METODOLOGJIA

Hulumtimi vijoi me tre hapa apo faza kryesore: në fazën e parë, u finalizuan metoda kërkimore dhe metodologjia duke u mbështetur në shqyrtimin e literaturës dhe konsultimin me ekipin WFD. Kjo fazë shërbeu për të hartuar të gjitha instrumentet kërkimore, si udhëzime për intervista të thelluara, fokus grupe, analizë të përmbajtjes së medias, përpilimin e listave të kampionit, dhe lista e burimeve dytësore. Faza e dytë kishte të bënte me punën në terren, që u realizua në muajt shtator dhe tetor 2020, ku u mblodhën të dhëna parësore nëpërmjet intervistave të thelluara dhe diskutimeve në fokus grupe me median dhe shoqërinë civile. Në tetor 2020 u organizua në seminar vlefësimi, që u pasua nga faza e fundit e analizës dhe interpretimit të të dhënave dhe hartimit të raportit përfundimtar të hulumtimit, përfshirë këtu edhe komentet që u morën gjatë prezantimit të gjetjeve në seminarin e vlefësimi.

Në këtë hulumtim u respektuan kodi i sjelljes dhe rregullat e etikës në kërkimet cilësore. Të intervistuarit u kontaktuan në mënyrë zyrtare me komunikim me telefon/email apo takim fizik për të marrë pëlqimin e tyre të informuar për pjesëmarrjen në këtë projekt kërkimor. U përgatit një formular pëlqimi që iu paraqit të intervistuarve, ku shpjegohej qëllimi i projektit dhe si do të përdoreshin dhe publikoheshin të dhënat. Të intervistuarve iu garantua konfidencialiteti i të dhënave dhe për citimet në tekst u përdoren kodet duke iu referuar “i/e intervistuar nga shoqëria civile” dhe “i/e intervistuar nga media”.⁴ Për intervistat ballë për ballë, hulumtuesit zbatuan me rreptësi kufizimet dhe protokollet e miratuara për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Në këtë studim përdoret trikëndëzimi (triangulimi): të dhënat vlefësohen nëpërmjet përdorimit të intervistave të thelluara, fokus grupe dhe seminar vlefësimi dhe analizë të përmbajtjes së raportimeve nga media. Këto të dhëna parësore mbështeten nga shqyrtimi i literaturës dhe i burimeve dytësore nëpërmjet kërkimit në zyrë.

Janë intervistuar në total 13 vetë: 6 nga sektori i shoqërisë civile dhe 7 nga sektori i medias. Të gjithë këta të intervistuar kanë përvojën në fushën përkatëse dhe me njohuri të përshtatshme për temën në fjalë.

⁴ Ky draft përfshin emrat e të intervistuarve dhe pjesëmarrësve sipas grupeve të fokusit dhe seminarit të vlefësimi vetëm për referencën e WFD. Emrat do të hiqen në botim përfundimtar.

Tabela 1: Kampioni i intervistave të thelluara

Sektori	Profili	Total
Shoqërisë civile	Themelues	2
	Drejtor	3
	Drejtor programi	1
Media	Gazetar	3
	Drejtor i redaksisë së lajmeve	1
	Producent ekzekutiv	1
	Drejtor ekzekutiv	1
	Shoqatë e pavarur e mediave	1

Në tabelën e mëposhtme jepet kampioni për secilin sektor, ku jepen me detaje emri dhe lloji i organizatës, fusha e veprimtarisë, personi i intervistuar, dhe roli i tyre në shoqërinë civile dhe në media. Intervistat u bënë ballë për ballë ose online dhe zgjatën rreth 30-45 minuta. Pyetjet për intervistat e thelluara u organizuan në dy grupe kryesore, ku secili grup trajtonte tërmetin dhe pandeminë Covid-19. Të intervistuarit ishin individë që punojnë në shoqërinë civile në qytete të ndryshme përveç Tiranës, si Durrësi, Fieri, Kruja dhe Lezha. Gjithashtu, u përfshinë dy media vendore- një nga Durrësi, epiqendra e tërmetit dhe një nga Shkodra, e prekur kryesisht nga pandemia.

Tabela 2: Shembull i të intervistuarve nga sektori i shoqërisë civile

#	OSHC	Lloji i OSHC
1	NPF/Help for Children	Ofrimi i Shërbimit OJF / Punon me komunitetet e marginalizuara/degët në Fieri, Lezha dhe Kruja
2	Partners Albania	OJF Kombëtare / e themeluar mirë / menaxhon Qendrën e Burimeve për Shoqërinë Civile
3	World Vision Albania	Ndërkombëtare / dega lokale / punon me të rinj / fëmijë / familje në nevojë / Lezhë / Durrës
4	Më mirë së bashku	Mbështetje dhe ndihmë online / offline dhe ndihmë për COVID-19 /
5	Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC)	OJF Lokale Durrës
6	Youth in Charge	Org lokale rinore Lezha

Tabela 3: Shembull i të intervistuarve në sektorin e medias

#	Media	Type of media
1	Reporter.al	Publikimi / analiza / investigim/rrjeti BIRN
2	Faktoje.al	Media / OJF/Factchecker / FactoMeter
3	Durrësilajm	Media online / Durres
4	Star News TV	TV Lokal/ Shkodra
5	RTSH	Transmetim Publik Kombëtar
6	TV	Kombëtar
7	Union of Albanian Journalists	Shoqata e pavarur e gazetarëve

Analiza e përmbajtjes është një teknikë hulumtimi për përshkrimin sistematik dhe sasior të përmbajtjes së shfaqur të komunikimit. Analiza e përmbajtjes na ofron pikëpamje të tendencave dhe modeleve të përgjithshëm të portretizimit nga media të krizave aktorëve kryesorë, si qeveria. Për analizimin e përmbajtjes janë formuluar pyetjet e mëposhtme nën-kërkimore bazuar në objektivat e kësaj detyre::

APP1 – Në lidhje me volumin dhe shpeshtësinë e flukseve të lajmeve:

- ▶ A pati valë intensive lajmesh (skup mediatik), të shkaktuara nga (cilat) ngjarje kryesore?
- ▶ Sa artikuj?
- ▶ Cila ishte tema kryesore?

APP2 – Në lidhje me kuptimin dhe këndvështrimin

- ▶ Cili ishte mesazhi kryesor (këndvështrimi) në media për tërmetin/pandeminë gjatë fazave të mëpasshme?
- ▶ Sa ishte përqindja e deklaratave alarmuese, siguroese apo neutrale në lajme gjatë periudhës së tërmetit/pandemisë?
- ▶ Kush zinte pjesën më të madhe të lajmeve: burimet nga qeveria, Kryeministria, ISHP, MSHMS apo ekspertët? Cilat burime dominonin?

Këto detajohen edhe më shumë sipas përkufizimit operacional dhe kodeve për CA. Qëllimi këtu nuk është thjesht të kuptojnë mbulimin nga media të tërmetit dhe pandemisë, por nëpërmjet mbulimit mediatik të shqyrtojmë më mirë rolin e medias dhe ndërveprimin me aktorë të tjerë në menaxhimin e krizës. Njësia e analizës është çdo artikull që trajton tërmetin/Covid-19 gjatë periudhës së monitorimit (siç shpjegohet edhe më poshtë).

Tabela 4: Përkufizimi operacional për analizën e përmbajtjes

Përkufizimi operacional dhe fjalët kyçe për tërmetin	Përkufizimi operacional dhe fjalët kyçe për pandeminë Covid-19
1. Tërmet	1. Covid-19
2. Shpëtimi dhe emergjenca	2. Koronavirus
3. Rimëkëmbja pas fatkeqësisë	3. Epidemi/Pandemi
4. Viktimat e tërmetit dhe familjet	4. Gjurmimi i kontaktit
5. Ndikimi i tërmetit: social, ekonomik, politik	5. Tampon / numri i të infektuarve / viktime / të shëruar
6. Rindërtimi	6. Ndërgjegjësim për Covid-19
7. Financimi dhe konferenca e donatorëve	7. Thashetheme/ keqkonceptim/ teori konspirative/ disinformim / të rreme / të sajura
8. Të tjera: mbështetja ndërkombëtare: BE, Greqia, Italia, Gjermania, Zvicra, Izraeli	8. Gjendja e emergjencës dhe masat kufizuese
	9. Masat e shpëtimit dhe mbështetja
	10. Ndëshkimi
	11. Karantina dhe vetë-izolimi
	12. Financim dhe burime
	13. Ndikimi në ekonomi, arsim, shoqëri
	14. Lajme nga vende të tjera: Kina, Italia, SHBA, BE
	15. Komentet dhe opinione
	16. Reagimi dhe pjesëmarrja e lexuesve/shikuesve / ndjekësve

Në analizën e përmbajtjes u përfshinë tre periudha kohore:

1. 26 nëntor - 31 dhjetor 2019, periudha menjëherë pas tërmetit
2. 15- 20 shkurt 2020, që lidhet me konferencën e donatorëve
3. 11 mars - 23 qershor 2020, që lidhet me gjendjen e emergjencës Covid-19 në Shqipëri.

Në kampionin tonë përfshihen katër kanale TV, dy gazeta dhe katër organe të medias online ku ndërthuren një larmi mediash– media lajmesh, media të përgjithshme, media tejet profesionale, media të lajmeve të çastit, media ekonomike, media investigative dhe kritike, media e shërbimit publik.

Tabela 5: Shembull i analizës së përmbajtjes (numri i artikujve)

		Tërmeti		COVID-19
		26 Nëntor - 31 Dhje-tor 2019	15- 20 Shkurt 2020	11 Mars - 23 Qeshor 2020
TV Channels				
TV				
1	ABC News	256	47	630
2	A2CNN	204	30	532
3	RTSH	300	40	650
4	Top Channel	310	45	600
.Nr Gazeta				
1	shqiptarja.com	78	14	320
2	Panorama	89	15	310
.Nr Portale Online				
1	Balkanweb	125	20	700
2	Exit.al	34	5	200
3	Reporter.al	17	1	178
4	Monitor.al	20	2	120

Në diskutimet në fokus grupe për rolin e shoqërisë civile në kohë krizash morën pjesë nëntë përfaqësues dhe ekspertë të shoqërisë civile, siç tregohet më poshtë, ndërsa në diskutimet për rolin e medias në kohë krizash morën pjesë pesë ekspertë të medias dhe gazetarë, siç tregohet më poshtë.

Table 6: Civil society focus group participants

Nr	Pjesëmarrës	Profili	Organizata
1	Abi Dodbiba	Ekspert i Sistemeve të Njohurive	Freelance
2	Armanda Kodra Hysa	Antropolog	Freelance
3	Albiona Mucoimaj	Punonjës dhe Aktivist Social	EcoVolis
4	Silva Arapi	Aktivist i të Drejtave Dixhitale	CVDR Steering Group
5	Besjana Hysa	Menaxher i Projektit	Instituti Shqiptar i Shkencave
6	Alba Brojka	Zyrtari i projektit	European Endowment for Democracy
7	Edlira Pajuni	Drejtor	Albcontact Centre Durrës
8	Irena Laska	Drejtor	Palliative Care Centre Korça
9	Redion Qirjazi	Studiues	IDM Albania

Pesë ekspertë dhe gazetarë të mediave morën pjesë në fokus grupin për rolin e medias në kohë krize siç tregohet më poshtë..

Tabela 7: Pjesëmarrës fokus grup nga media

Nr	Pjesëmarrës	Profili	Organizata
1	Celik Rrupli	Analist media	Europe House
2	Erbllin Vukaj	Gazetar	Euronews Albania
3	Ivana Dervishi	Drejtori i Programit të Seksionit Dixhital	Euronews Albania
4	Florenc Stafa	Gazetar	Freelance
5	Vladimir Thanu	Gazetar	TVSH

Diskutimet në fokus grupe dhe seminari i vlefësimit u bënë online dhe për regjistrimin e diskutimeve u mor miratimi paraprak i pjesëmarrësve. .

Tabela 8: Pjesëmarrës në workshopin validues

Pjesëmarrës	Profili	Organizata
Ardi Hoti	Drejtor Informacioni	StarNews TV
Indrit Yzeiraj	Aktivist	Aleanca per Mbrojtjen e Teatrit
Erisa Lame	Menaxher Programi	SDC
Vasilika Laci	Menaxher Programi	Ambasada UK
Megi Recic	Menaxher Programi	Civil Rights Defenders
Nevila Xhindi	Profesor	CCIS
Robert Gajda	Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit	Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit
Erjona Canaj	Komisioner, Avokati i Popullit	Avokati i Popullit
Mariola Qesaraku	Menaxher Programi	FES
Bledar Tahu	Drejtor	IRCA
Shpresa Spahiu	Drejtor	NPF
Blerina Balla	Menaxher Programi	Ambasada UK
Sokol Haxhiu	Përfaqësues në Shqipëri i WFD	WFD
Orjada Tare	Menaxher Programi	WFD
Erida Curraj	Menaxher Programi	+Erasmus

Qasja e përzgjedhur bën të mundur një analizë të thelluar të rolit të shoqërisë civile dhe mediave në kohë krizash, ndërkohë që analiza sasiore e mbulimit nga media të tërmetit dhe pandemisë mund të na ofronte mundësi për të përgjithësuar gjetjet. Studimet e mëtejshme që mund të ndërmerren duhet të marrin parasysh ndërthurjen e metodave cilësore dhe sasiore kur të trajtojnë rolin e medias, në mënyrë të veçantë, në kohë krizash..

3 KUADRI KONCEPTUAL: OSHC-TË DHE MEDIA NË KOHË KRIZASH

Në këtë kapitull përshkruhen njohuritë kryesore nga shqyrtimi i literaturës dhe burimeve dytësore në lidhje me OSHC-të dhe rolin e medias në kohë krizash..

3.1 OSHC-TË DHE KRIZA: NGA REAGIMI NË RASTET E EMERGJENCËS TE ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA KATASTROFAT

Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizave dhe fatkeqësive, veçanërisht në reagimin ndaj emergjencave, në operacionet e ndihmës dhe shpëtimit, dhe në periudhën e rimëkëmbjes. Krizat, të tilla si tërmetet e mëdha, pandemitë apo fatkeqësi të tjera, prirjen të nxjerrin në pah dhe të përkeqësojnë problematika si pabarazitë e ngulitura dhe strukturore, diskriminimi, mungesa apo kufizime në aksesin të shërbimeve shëndetësore, arsimore, dhe sociale, cenueshmëria e grupeve të ndryshme në shoqëri, dobësia e sektorit privat, korrupsioni i zyrtarëve publikë, dhuna në familje me bazë gjinore dhe të tjera. OSHC-të punojnë në vijën e parë të frontit në shumë prej këtyre çështjeve duke ofruar shërbime të rëndësishme, duke advokuar për ndryshime të politikave, ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin si dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Kështu, roli i tyre është vendimtar dhe jo pa sfida.

Organizata të ndryshme të shoqërisë civile kanë luajtur një rol aktiv në menaxhimin e fatkeqësive për një kohë të gjatë. Këto ndërhyrje të OSHC-ve mund të grupohen si më poshtë.

Kutia1: Key functions of CSOs in disaster management

- ▶ Mobilizimi i vullnetarëve në operacione shpëtimi
- ▶ Vlerësimi i dëmeve në nivelin vendor
- ▶ Mobilizimi i fondeve për ndihmë
- ▶ Sigurimi i mbështetjes dhe ndihmës
- ▶ Mobilizimi dhe kanalizimi i fondeve për rehabilitimin
- ▶ Puna e drejtpërdrejtë me komunitetet e prekura dhe ato në nevojë
- ▶ Plotësimi i boshllëkut nga mungesa e autoriteteve shtetërore
- ▶ Koordinimi me aktorë të tjerë të shoqërisë civile
- ▶ Pjesëmarrja në procesin e rindërtimit: konsultimi, monitorimi, vlerësimi
- ▶ Advokim dhe ndërgjegjësim

*Burimi: Autorët bazuar në shqyrtimin e literaturës

Është pranuar gjerësisht se kompetencat unike të OSHC-ve që veprojnë në nivelin më bazë mund t'u përgjigjen prioriteteve të banorëve vendas dhe të bazohen në kapacitetet vendore në kohë krizash. Po ashtu, OSHC-të janë më të zhdërvjellëta dhe relativisht të lira nga strukturat dhe sistemet burokratike. Përgjithësisht, ato janë në gjendje të trajtojnë nevojat e grupeve më të marginalizuara me më shumë efikasitet.⁵ Në krahasim me aktorët shtetërorë, OSHC-të kanë një pozicion më të mirë për të zbatuar qasje gjithëpërfshirëse, konsensuale dhe me pjesëmarrje në menaxhimin e krizave, planifikimin e punës për raste katastrofash dhe mundësimin ringritjes.⁶ Për shembull, CIVICUS, një aleancë globale e organizatave të shoqërisë civile, thotë se përveç punës që bën në sfidat e ngutshme globale, si varfëria, pabarazia dhe ndryshimet klimatike, shoqëria civile e gjen veten edhe në vijën e parë të përgjigjes kur bëhet fjalë për emergjenca humanitare, përfshirë këtu edhe ato të shkaktuara nga konfliktet dhe katastrofat.⁷

Kuadri Sendai për Uljen e Rrezikut të Katastrofave 2030⁸, një kuadër lider në nivel global, njeht rolin potencial të OSHC-ve në përgjigjen ndaj emergjencave dhe shpëtimit dhe ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe në reduktimin e rrezikut të katastrofave në mbarë botën.⁹ Prandaj, nisur që nga qasja tradicionale e përgjigjes ndaj katastrofave dhe me operacione shpëtimi, theksi u zhvendos gradualisht tek reduktimi i rrezikut të fatkeqësive, duke kuptuar rëndësinë dhe nevojën e reduktimit të rrezikut në komunitet me vendosjen e lidhjeve me aktorët e politikës. Megjithatë, OSHC-të hasin sfida të mëdha për sa i përket burimeve njerëzore, financiare dhe problemeve teknike.

Rrjeti Global i Organizatave të Shoqërisë Civile për Reduktimin e Fatkeqësive ka identifikuar gjashtë role bazë të OSHC-ve për sa i përket reduktimit të rrezikut të fatkeqësive, siç tregohet më poshtë.

5 UNISDR. (2006). NGOs & disaster risk reduction: A preliminary review of initiatives and progress made. Geneva: UN, gjendet në adresën https://www.unisdr.org/2008/partner-netw/NPOs/meeting1-october-2006/NGOs_and_DRR_Background_Paper.pdf (aksesuar më 4 tetor 2020).

6 Po aty.

7 "Raporti i Gjendjes së Shoqërisë Civile 2015 - Shoqëria civile në pararojë të përgjigjes ndaj emergjencave por përballet me kërcënime të tmerrshme dhe krizë financimi", (2015). Gjendet në adresën <https://www.civ-icus.org/index.php/media-resources/media-releases/2384-civil-society-at-forefront-of-emergency-response-but-faces-dire-threats-and-funding-crisis-says-new-report> (aksesuar më August 20, 2020).

8 Kuadri Sendai për Uljen e Rrezikut të Katastrofave 2030, gjendet në adresën <https://www.undrr.org/implementing-sendai-framework/what-sendai-framework> (aksesuar më 23 gusht 2020).

9 van Wessel, M., Naz, F. & Sahoo, S. (2020). "Complementarities in CSO Collaborations: How Working with Diversity Produces Advantages." Voluntas, <https://doi.org/10.1007/s11266-020-00227-4> aksesuar më 23 gusht 2020).

Kutia 2: Roli i OSHC-ve në reduktimin e rrezikut të fatkeqësive

1. **Zbatues** – Veprimi në nivel vendor në partneritet me aktorët shtetërorë dhe grupet e tjera
2. **Ndërtues kapacitetesh** – Forcimi i kapaciteteve në nivel vendor
3. **Transferues njohurish** – Identifikimi, zhvillimi dhe ndarja e njohurive, ekspertizës dhe praktikave novatore
4. **Lidhës** – Krijimi i urave mes grupeve dhe aktorëve të ndryshëm për të forcuar angazhimin në nivel vendor
5. **Monitorues** – Sigurimi i një llogaridhënieje më të madhe nëpërmjet monitorimit dhe raportimit të progresit në nivel vendor
6. **Advokues** – Mobilizimi dhe mbrojtja e nevojave dhe përparësive të njerëzve të marginalizuar

**Burimi: Rrjeti Global i Organizatave të Shoqërisë Civile për Reduktimin e Fatkeqësive*

Roli i OSHC-ve në një kuadër të tillë është më i gjerë dhe më i thellë se përgjigja ndaj emergjencave dhe ndihmës humanitare. Në këtë rol përfshihet promovimi i vlerësimit gjithëpërfshirës bazë të rrezikut, edukimin për katastrofat, rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe medias dixhitale, përpilimin dhe mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore, ngritjen e kapaciteteve vendore, forcimin e koordinimit me aktorë të tjerë, promovimin e përgjegjësisë së sektorit privat në reduktimin e katastrofave, puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të tillë si media dhe ofrimi i shërbimeve dhe ndërtimi i kapaciteteve.

Po ashtu, OSHC-të janë me rëndësi tejte të madhe për të siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në kohë katastrofash. Në disa raste, qeveritë përdorin fatkeqësitë për të mbytur edhe më shumë zërat e pavarur. Miratimi i ligjeve për emergjencat zgjeron pushtetin e qeverisë dhe të aktorëve të tjerë shtetërorë dhe shpesh kjo shoqërohet me censurimin, arrestimin dhe frikësimin e gazetarëve, punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe individëve të tjerë për kritikën ndaj punës së qeverisë. OSHC-të kanë rëndësi themelore në krijimin e një qasjeje të bazuar te të drejtat e njeriut për menaxhimin e katastrofave, duke i kërkuar llogari qeverisë dhe duke u bërë zëri i grupeve të ndryshme shoqërore.

3.2 MEDIA NË KOHË KRIZASH

Komunikimi është një element thelbësor në kohë krizash, si tërmete të mëdha, pandemi dhe fatkeqësi të tjera. Gjithsesi, duke qenë se këto janë ngjarje të pazakonta, parimet standarde dhe praktikat e komunikimit nuk mund të zbatohen lehtësisht. Këto janë situata që karakterizohen nga nivele të larta pasigurie dhe publiku pret informacione dhe mesazhe sigurie që komunikohen përmes mediave, qoftë media audiovizive dhe shtypi ashtu edhe ajo online. Kështu, mediat janë mënyra kryesore për t'u dhënë zë ekspertëve për të shpjeguar kërcënimin dhe

situatën dhe për autoritetet për të ofruar informacione se si t'i përgjigjen rreziqeve të tilla nga situatat e fatkeqësive. Vendosja e balancave mes ekspertëve dhe autoriteteve publike dhe mundësimi i diskutimeve mes shkencëtarëve dhe autoriteteve publike është sfidues për profesionistët e medias dhe me rëndësi të madhe. Supozohet se media është e ngarkuar me mundësinë e ekzagjerimit, keqkuptimit, rirregullimit dhe reagimit të ashpër.¹⁰ Sipas kritikës, media priret të ulë rëndësinë, të thjeshtojë, ta ekzagjerojë apo ta bëjë sensacional lajmin, prandaj sa herë që shkenca (si ajo për sizmologjinë, epidemiologjinë, apo shëndetin publik) futet në sferën e medias, nuancat dhe saktësia, sipas raporteve, humbasin.¹¹ Në sfond të këtyre vështirësive është tendenca e medias për të theksuar sa më shumë ngjarjet dramatike.¹²

Kutia 3: Fazat e komunikimit të rrezikut

1. *Merrini shifrat të sakta;*
2. *Tregojuni publikut kryesor se çfarë kuptimi kanë shifrat;*
3. *Shpjegoni se çfarë nënkuptojnë shifrat;*
4. *Tregoni publikut se kanë përballuar rreziqe të ngjashme më parë;*
5. *Shpjegojini se si përfitimet e rrezikut janë më të mëdha se kostot e tij;*
6. *Trajtojeni publikun me respekt;*
7. *Bëni që publiku të bëhet partnerë me komunikuesit e rrezikut;*
8. *Bëni të gjitha sa më sipër.*

**Burimi: Sheppard, 2012¹³*

Përveç kufizimeve të qenësishme të mediave për sa i përket komunikimit të shkencës, veçanërisht në kohë krizash, po arrihet gjithnjë e më shumë konsensus në literaturën e hulumtimeve se gjendja e ekspertizës shkencore ka pësuar një ndryshim dramatik në dekadat e fundit. Ky ndryshim është ende në vazhdim e sipër, si në shqetësimet aktuale për “politikën e pas së vërtetës” dhe “shoqërinë e pas fakteve”.¹⁴ Rrjedhimisht, ka shqetësime se komunikimi i krizave nga qeveria, si në rastin e tërmeteve serioze, pandemive dhe katastrofave, është bërë i paqëndrueshëm nga fakti se këshillat e bazuar në shkencë “nuk

10 Carlsen, B., & Riese, H. (2016) "High Stakes: An Interview Study of Researchers' Motivations for and Experiences of being Interviewed by Journalists," NORDICOM REVIEW, Vol. 37. Issue 1.

11 McCartney, M. (2016). "Who gains from the media's misrepresentation of science?" British Medical Journal, 352.

12 Nacos, B. L., Bloch-Elkon, Y., Shapiro, R. Y. (2011). Selling Fear: Counterterrorism, the media, and public opinion. Chicago, IL: University of Chicago Press.

13 . Sheppard, B. (2012). "Understanding Risk Communication Theory: A Guide for Emergency Managers and Communicators," gjendet në adresën <https://www.start.umd.edu/sites/default/files/files/publications/UnderstandingRiskCommunicationTheory.pdf> (aksesuar më 10 shtator 2020).

14 Thompson, B. (2016, shtator 10). The post-truth world: Yes, I would lie to you. The Economist. Retrieved from <http://www.economist.com/news/briefing/21706498-dishonesty-politics-nothing-new-manner-which-some-politicians-now-lie-and> (aksesuar më 4 tetor 2020).

imponon më respekt në mënyrë automatike.”¹⁵ Kjo është veçanërisht çështje urgjente në rast katastrofash, sepse jeta e njerëzve dhe shëndeti publik ndikohen nga niveli i besimit tek këshillat e ekspertëve dhe tek zgjidhjet shkencore të autoriteteve publike. Kështu, media është ndërmjetësues i besimit mes publikut dhe autoriteteve dhe, rrjedhimisht, i ngarkohet misioni për të ruajtur balancat mes kërkesës së llogarisë ndaj autoriteteve dhe ofrimit të informacionit të saktë të publiku.

Kutia 4: Covid-19 dhe sfidat e këshillave me bazë shkencore në ShBA dhe vende të tjera

Buletinet e të dhënave në Singapor, Kore të Jugut dhe Zelandën e Re ofrojnë dritare informimi gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara rregullisht, të shpejta dhe të sakta për mënyrën e përhapjes së koronavirusit. Ofrimi i të dhënave cilësore dhe të besueshme mbështet aktorët e politikës në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë ndihmon edhe qytetarët të shmangin rrezikun dhe të vendosin se si të përshtatin jetën e përditshme në kohë pandemie. Për më tepër, këto buletine u japin studiuesve një sërë të dhënash për të bërë hulumtime dhe shkencë si dhe u ofrojnë vendimmarrësve këshilla të bazuara në fakte. Si për kontrast, kritikët argumentojnë se “Shtetet e Bashkuara ofrojnë përherë e më pak detaje për mënyrën se si po përhapet sëmundja, edhe kur njerëzit socializohen dhe udhëtojnë gjithnjë e më shumë dhe kur autoritetet rihapin shkolla dhe biznese.”^{**} Ata tregojnë se Shtetet e Bashkuara kanë krizë të dhënash për koronavirusin për shkak të ndërhyrjes së politikës, çorganizimit dhe viteve të neglizhimit të administrimit të të dhënave për shëndetin publik.^{***} Përveç kësaj, besimi i publikut të qeveria federale ka rënë në nivele gati rekord, teksa Shtetet e Bashkuara po luftojnë me pandeminë dhe recesionin ekonomik. Mosbesimi të qeveria po pengon mbikëqyrjen e përhapjes së Covid-19 si dhe marrjen e vaksinës kur kjo e fundit të jetë gati.

Një tjetër shqetësim që lidhet me rënien e autoritetit të këshillave shkencore është se shkencëtarët dhe ekspertët janë bërë viktime të fushatave shpifëse të medias dhe politikanëve kur këshillat e tyre bien ndesh me interesa specifike ose ideologji politike. Gjatë pandemisë Covid-19, gjërat po ndryshojnë shumë shpejt dhe qeveria, shkencëtarët, ekspertët dhe media po veprojnë kundër një armiku për të cilin dihet shumë pak. Vëmendja kryesore e mediave është aq intensive saqë figurat shkencore në të gjithë botën, si Chris Whitty dhe Patrick Vallance në Britani të Madhe, Didier Raoult në Francë, Anthony Fauci në ShBA, janë bërë emra të njohur për familjet. ^{***} Megjithatë, ka divergjenca edhe mes shkencëtarëve në lidhje me të dhënat dhe provat për Covid-19. Për shembull, David King, një ish këshilltar kryesor shkencor i Tony Blair dhe Gordon Brown, ka ngritur një grup alternativ ekspertësh për të dhënë gjykimin e tyre për provat që ofrohen dhe për të ofruar një formë të re interpretimi dhe këshillimi përkundrejt

15 Hilgartner, S. (2000). Shkenca në skenë: Këshilla e ekspertëve si dramë publike. Stanford, CA: Stanford University Press, p. 4.

asaj zyrtare që jepet në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo po ndodh edhe në Gjermani dhe vende të tjera. Kjo divergjencë do të thotë që politikanët, bizneset dhe veçanërisht komentuesit e medias mund të përdorin cilëndo punim shkencor që preferojnë. Si pasojë, krijohet konfuzioni, gjë që çon në çorientim dhe mosbesim të publikut dhe e bën më të lehtë përhapjen e teorisë së konspiracionit dhe disinformimit.

* Maxmen, A., (2020) "Why the United States is having a coronavirus data crisis", available at <https://www.nature.com/articles/d41586-020-02478-z> (Aksesuar në 4 tetor 2020).

***"Americans' Views of Government: Low Trust, but Some Positive Performance Ratings", (2020). Pew Research Center, available at <https://www.pewresearch.org/politics/2020/09/14/americans-views-of-government-low-trust-but-some-positive-performance-ratings/> (Aksesuar në 4 tetor 2020).

*** Black, R., (2020). "Scientists get a politics lesson from COVID-19", Politico, available at <https://www.politico.eu/article/coronavirus-what-covid-19-scientists-can-learn-from-their-climate-change-colleagues/> (Aksesuar në 1 tetor 2020).

Roli i medias në komunikimin e rrezikut diskutohet edhe nga McLean dhe Power (2014), studimi i të cilëve i vë theksin dy gjetjeve kryesore: së pari, "kishte nevojë për të dhënë përkufizime të përbashkëta të besimit dhe artikullimit të qëllimeve të përbashkëta", dhe së dyti, që "ndërtimi i bazave të vullnetit të mirë para një katastrofe dhe të dy palët si të kontribuojnë në qëllimin e përbashkët".¹⁶ Edhe organizata monitoruese të gazetarisë kanë botuar hulumtime të rëndësishme për raportimin e katastrofave dhe rolin e mediave, siç është Projekti i Gazetarisë i Qendrës Kërkimore Pew.¹⁷ Këto raporte theksojnë rëndësinë e gazetarisë shkencore dhe edukimit të gazetarëve për raportimin e katastrofave, të tilla si tërmetet dhe pandemitë.

Me zhvillimin e mediave dixhitale, mediave sociale dhe raportimit nga qytetarët dhe me një rol në rritje të publikut në media në sajë të përparimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ka një transformim të dukshëm në mjedisin e gazetarisë shkencore në këto vitet e fundit. Në disa studime i është vënë theksi ndryshimeve dramatike të funksioneve dhe praktikave të reporterëve të shkencës për shkak të ndryshimeve të mëdha në ekonomi, në proceset organizative dhe disiplinat profesionale në gazetari. Ata po kalojnë nga thjesht transmetimi i informacionit drejt funksionimit në një kontekst më social-kulturor, duke u bërë kritikë, duke raportuar procesin e shkencës dhe jo thjesht fakte dhe konstatime, por duke bërë gazetari "dialoguese" në bashkëpunim me shikuesit e tyre.¹⁸ Media shpesh i përshtat këndvështrimet që mund të ofrojnë burimet e tyre, si autoritetet publike, shkencëtarët, ekspertët dhe publiku, por edhe gazetarët përshtatin dhe zhvillojnë këndvështrimet e tyre në mbulimin e lajmeve në lidhje me katastrofat dhe në trajtimin e burimeve. Ky këndvështrim, i cili përcaktohet si rezultat i

16 McLean, H., & Power, MR., (2014). When minutes count: Tension and trust in the relationship between emergency managers and the media. *Journalism*, 15(3):307-325.

17 "Reporting Katrina" (2015). Pew Research Center, gjendet në adresën <https://www.journalism.org/2005/09/11/reporting-katrina/> (aksesuar më shtator 8, 2020).

18 Fahy, D., & Nisbet, MC., (2011) "The science journalist online: Shifting roles and emerging practices." *Journalism* 12(7): 778–793.

proceseve të negociatave mes mediave dhe burimeve të tyre¹⁹ është një nga bazat e rëndësishme për mënyrë se si media mbulon një katastrofë të madhe dhe rolin e saj në këtë krizë.

Kutia 5: Shembuj të mbulimit nga media dhe rolit të saj në fatkeqësi

Mbulimi nga media i epidemive mund të jetë mjaft alarmues. Mbulimi i gripit të shpendëve dhe SARS shpesh ishte për sensacion që përqendrohej në skenarë të rastit më të keq dhe gjuhë të ngarkuar emocionalisht (Berry et al., 2007; Dudo et al., 2007; Washer, 2004).

Gjithsesi, studimet për pandeminë A/H1N1 dhe median tregojnë rezultate të përziera. Studimi i një programi lajmesh i një TV në Brazil tregon se ky TV kontribuoi në “skenarin e panikut” (Da Silva Medeiros dhe Massarani, 2010).

Nga një analizë e gazetave britanike u arrit në përfundimin se ka shumë pak fakte të “ekzagjerimit dhe fryrjes” nga media të pandemisë (Hilton dhe Hunt, 2010). Ndonëse toni në përgjithësi ishte neutral dhe jo “alarmues”, media i kushtoi shumë vëmendje gripit.

Kjo konfirmohet nga një studim i lajmeve të TV australiane për epideminë: mbulimi ishte në përgjithësi “jo-alarmues”, por 63.4% e të gjitha edicioneve të lajmeve televizive lidhur me rrezikun e madh të A/H1N1, duke krijuar përshtypjen e një kërcënimi serioz (Fogarty et al., 2011). Nga ana tjetër, nga një analizë e mbulimit nga gazeta të gripit të dërrit në Australi u vu re se mbizotëroi mesazhi i “gripit vdekjeprurës të dërrit” me një kombinim të mesazheve që jepnin si alarm ashtu edhe siguri (Holland dhe Blood, 2010).

Zhvillimet në mbulimin e mediave mund të lidhen me fazat e njëpasnjëshme të fatkeqësisë, si pandemia. Studimet e mëparshme për Ebolan, SARS-in dhe gripin e shpendëve përcaktonin tre faza në mbulimin e një virusi të ri, secila me një diskurs të ndryshëm: “dhënia e alarmit”, “mesazhe të përziera” dhe “kriza e nxehtë dhe frenimi”²⁰. Lajmet e përditshme zakonisht kanë raportime të rregullta të çështjeve aktuale. Gjithsesi, këto katastrofa shkaktojnë flukse të mëdha dhe të shpejta lajmesh që zhvillohen vazhdimisht në të cilat marrin pjesë të gjitha mediat, që njihen si “bujë mediatike” dhe bazohen në fluksin vetë-referues dhe ndërveprues të medias duke krijuar cikle përforcuese informacioni në prodhimin e lajmeve.²¹ Sistemi mediatik është mjaft vetë-referues: një media priret të ndjekë media të tjera, duke ushqyer kështu fluksin e lajmeve. Kjo përforcohet nga ndërveprimi

19 Vasterman, PLM., & Ruigrok, N., (2013) “Pandemic alarm in the Dutch media: Media coverage of the 2009 influenza A (H1N1) pandemic and the role of the expert sources”, *European Journal of Communication*, Vol. 28, Issue 4., 436-453.

20 Vasterman, PLM., & Ruigrok, N., (2013) “Pandemic alarm in the Dutch media: Media coverage of the 2009 influenza A (H1N1) pandemic and the role of the expert sources”, *European Journal of Communication*, Vol. 28, Issue 4., 436-453.

21 Po aty. p. 440.

me përgjigjen ndaj aktorëve socialë. Një këndvështrim i caktuar shpesh bëhet dominues në mbulimin mediatik, sepse media tenton të kërkojë informacione dhe burime që konfirmojnë këndvështrimin e saj.²² Mënyra e komunikimit dhe interpretimit të një fatkeqësie nga media gjatë një “bujë mediatike” është shumë e rëndësishme, sepse ky mbulim nga media krijon, riprodhon ose zmadhon rreziqet dhe perceptimet që lidhen me rreziqet. Nëpërmjet “bujës mediatike” mund t’i bëhet presion qeverisë që kjo e fundit të ndërmarrë hapa në mënyrë që të trajtojë kërcënimin e pretenduar.

Kutia 6: Lufta e medias në rastin e Nepalit: Tërmeti i 25 prillit 2015

Një studim për mbulimin nga media të tërmetit me magnitudë 7.8 që goditi Nepal-in në 25 prill 2015 tregon se mediat, veçanërisht radiot komunitare dhe mediat sociale, ishin të dobishme për informimin dhe rivendosjen e lidhjeve e njerëzve. Fillimisht, media lokale u përpoq të reagoje ndaj tërmetit, sepse lëkundjet janë të zakonshme në Nepal ndërkohë që shkalla e katastrofës ishte e ende paqartë. Në zonat e goditura më shumë nga tërmeti, media lokale pësoi dëme dhe nuk mund të raportonte për ngjarjen. Po ashtu, mediat nepaleze i kategorizojnë katastrofat si çështje aktuale, pa përgjegjësi specifike për raportimin e fatkeqësive. Studimi nxjerr në pah se fokusi kryesor i vëmendjes së medias ishte në fazën e përgjigjes ndaj katastrofave dhe aspektin e interesit njerëzor.

Për më tepër, pasojat e menjëhershme të katastrofës sollën si rezultat çorientim të medias dhe mungesë koordinimi me qeverinë. Edhe pse Nepali është pionier i radios komunitare në Azinë Jugore, këtij vendi i mungojnë përgatitja për raste katastrofash dhe protokollat e zbutjes së tyre. Raportimi ishte i kufizuar dhe kjo nxitte zhvillimi e infrastrukturës e ringritjes pas katastrofave në Nepal. Mediat sociale vërtetuan se ishin të padiskutueshme në sigurimin e komunikimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe solidaritetit, veçanërisht për reporterët e huaj që informonin mediat ndërkombëtare dhe publikun nëpërmjet Facebook dhe Twitter.

*Poudel, Bharat Raj, FitzGerald, Gerry, Clark, Michele J., Mehta, Amisha, & Poudyal Chhetri, Meen B. (2014) How does Nepal Television (NTV) frame natural disasters? A qualitative content analysis of news scripts using news frames and PPRR cycle. In 5th International Disaster and Risk Conference (IDRC 2014), 2014-08-24 - 2014-08-28.

**“Përpjekjet e medias në operacionet e shpëtimit nga tërmeti në Nepal,” gjendet në <https://theconversation.com/how-the-media-struggled-in-nepals-earthquake-rescue-40970> (Aksesuar në 17 tetor 2020).

Roli i internetit dhe mediave sociale së bashku me ato të shtypit nuk mund të nënvlerësohen, sepse mekanizmat ndërkombëtarë të mbikëqyrjes të rregulluara nga OBSH janë të hapura për të marrë njoftime nga këto media, së bashku me komunikimin që sigurohet nga kanalet zyrtare.²³ Në një studim të vitit 2020 për

22 Vasterman, PLM, Yzermans, JC, Dirkzwager, AJE (2005) “The role of the media and media hypes in the aftermath of disasters.” *Epidemiologic Reviews*, Vol. 27: 107–114.

23 Dry, S. (2010). “New rules for health? Epidemics and the International Health Regulations”. In: Dry, S, Leach, M (eds) *Epidemics: Science, Governance, and Social Justice*. London: Earthscan, pp. 23–42.

Covid-19 dhe mediat argumentohet se *“tepria e madhe me të dhëna dhe njohuri është një nga karakteristikat e shoqërisë së informacionit. Pushteti tani nuk qëndron më tek aksesimi ndaj informacionit por tek administrimi i tij. Në fakt, interneti dhe mediat sociale kanë lehtësuar në mënyrë të pamohueshme qarkullimin dhe marrjen e informacionit, duke hapur kështu mundësitë që përdoruesit të aksesojnë, të ndërveprojnë dhe të prodhonë përmbajtje.*²⁴” Mosbesimi tek mediat sociale ndikon në përhapjen e informacionit për fatkeqësitë, sepse kjo lidhet edhe me ndryshimin e perceptimit dhe pjesëmarrjes së medias dhe ndryshon mënyrën sipas të cilët individët dhe institucionet kuptojnë informacionin në situata kritike. Edhe mediat sociale dhe faqet në internet janë bërë platforma kryesore për përhapjen e informacionit të rremë dhe çorientues, pasi ato bëjnë të mundur ndarjen e shpejtë dhe në shkallë të gjerë të informacionit dhe u mungojnë mekanizmat tradicionalë të kontrollit të cilësisë dhe filtrimit të tij.²⁵ Rritja e informacionit të rremë po nxit mohimin e provave shkencore dhe potencialisht mund të jetë një kërcënim për demokracinë dhe qytetarët.²⁶ Përhapja e përmbajtjeve të tilla është vërtetuar se nxit cinizmin, apatinë dhe ekstremizmin, ndoshta duke keqorientuar vendime që prekin politikën publike dhe jetën e njerëzve.²⁷

Kutia 7: Covid-19 dhe Twitter

Studimet sistematike për rolin e medias dhe Covid-19 janë ende në zhvillim e sipër. Janë kryer disa vlerësime të shpejta, por ka ende shumë vend për hulumtime të tjera. Për shembull, në një studim të fundit* ofrohen të dhëna të reja se si qarkulluan në Twitter në fazën e hershme të shpërthimit të pandemisë informacione të rreme dhe informacione të bazuar në prova rreth emergjencës Covid-19. Studimi zbulon se informacioni i rremë kishte më shumë të ngjarë të postohet në Twitter, por kishte më pak të ngjarë të ripostohet se sa provat me bazë shkencore apo postimet e verifikimit të fakteve. Gjetjet e këtij studimi përkojnë më shumë me kërkimet mbi shpërthimin e virusit Ebola në 2014**, të cilat nxjerrin në pah se pas deklarimit të emergjencës, informacioni i saktë qarkulloi më shumë sesa informacioni i rremë, gjë që tregon se informacioni shëndetësor ose rasti i një emergjence u shpërnda ndryshe. Megjithatë, në këtë drejtim kërkohen hulumtime të mëtejshme. Interneti dhe Web 2.0. kanë demokratizuar mënyrën sesi qytetarët aksesojnë, prodhojnë dhe ndërveprojnë me përmbajtjen. Gjithsesi, nuk është thjesht çështje aksesimi tek njohuri shkencore, por ka të bëjë me vlerësimin kritik të informacionit dhe ndarjes së përmbajtjes së saktë nga ato

24 Pulido, C., Villarejo-Carballido, B., Redondo-Sama, G., Gomes, A. (2020). "COVID-19 infodemic: More retweets for science-based information on coronavirus than for false information", *International Sociology*, Vol. 35(4), pp. 377-392.

25 Mirbabaie, M., Bunker, D., Stieglitz, S., Marx, J., & Ehnis, C., (2020). "Social media in times of crisis: Learning from Hurricane Harvey for the coronavirus disease 2019 pandemic response", *Journal of Information Technology*, Vol. 35, Issue 3, 195-213.

26 Pulido, C., Villarejo-Carballido, B., Redondo-Sama, G., Gomes, A., (2020). "COVID-19 infodemic: More retweets for science-based information on coronavirus than for false information", *International Sociology*, Vol. 35(4), pp. 377-392.

27 Lazer, DMJ, Baum, MA, Benkler, Y, et al. (2018). "The science of fake news," *science*,359(6380): 1094–1096.

të gënjeshtërt. Në këtë drejtim, nevojiten programe arsimore parandaluese që t'u japin qytetarëve aftësitë e nevojshme për të marrë informacione të bazuara në prova dhe njohuri shkencore dhe për të refuzuar lajmet e rreme. Në këto programe mund të përfshihen trajnime për të demaskuar informacionin e rremë përmes argumentimit shkencor dhe interpretimit mediatik, që mund të përmirësohet në mjedisin familjar, të mësuarit gjatë gjithë jetës, në shkolla, universitete dhe lëvizjet e organizatave vendore. Për të matur ndikimin e nismave aktuale dhe për të hartuar ndërhyrje të përshtatshme nevojiten hulumtime të mëtejshme.

*Pulido, C., Villarejo-Carballido, B., Redondo-Sama, G., Gomes, A. (2020). "COVID-19 infodemic: More retweets for science-based information on coronavirus than for false information", *International Sociology*, Vol. 35(4), pp. 377-392.
** Fung IC-H, Fu K-W, Chan C-H et al. (2016) Social media's initial reaction to information and misinformation on Ebola, August 2014: Facts and rumors. *Public Health Reports* 131(3): 461-473.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) i referohet këtij problemi në kontekstin e sëmundjes së koronavirusit 2019 (Covid-19) si "infodemik" i mediave sociale, domethënë, "një bollëk të tepruar informacioni - disa të sakta dhe disa të pasakta - që e bën të vështirë për njerëzit të gjejnë burime të besueshme dhe udhëzime të besueshme kur u nevojiten."²⁸ Shpërthimi i Covid-19, në veçanti, ka theksuar domosdoshmërinë për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse komunikimi të mediave sociale për të rritur dhe mbështetur përgjigjen ndaj krizave. Keqinformimi, frikësimi ose banalizimi i një ngjarjeje krize mund të krijojë sfida për autoritetet shtetërore teksa këto të fundit hartojnë strategjinë e tyre të komunikimit për krizat. Në këtë kontekst, qarkullimi i informacionit të rremë për shpërthimin e Covid-19 po rritet me shpejtësi të madhe.²⁹ Për më tepër, këtu përfshihen, ndër të tjera, referenca për kura të pretenduara, si shpëlarja e gojës me ujë të kripur, ngrënia e rignonit apo edhe pirja e zbardhuesve të rrobave.³⁰

Sidoqoftë, mediat sociale janë ende thelbësore për komunikimin në lidhje me katastrofat dhe besimin mes mediave, autoriteteve dhe publikut. Kuadri për rolin e mediave sociale në menaxhimin e fatkeqësive³¹ mund të përmblihet në tabelën e mëposhtme.

28 "Immunizing the public against misinformation," World Health Organisation, Gjetet në adresën <https://www.who.int/news-room/feature-stories/detail/immunizing-the-public-against-misinformation> (aksesuar më 4 tetor 2020).

29 Chakravorti B (2020). As coronavirus spreads, so do fake news. *Bloomberg Opinion*, February 5. Gjetet në adresën www.bloomberg.com/opinion/articles/2020-02-05/as-coronavirus-spreads-so-does-fake-news (aksesuar më shtator 8, 2020).

30 Mirbabaie, M., Bunker, D., Stieglitz, S., Marx, J., & Ehnis, C., (2020). "Social media in times of crisis: Learning from Hurricane Harvey for the coronavirus disease 2019 pandemic response", *Journal of Information Technology*, Vol. 35, Issue 3, 195-213.

31 Mueez, A., Mardiana, O., & Rosliza, A.M., (2019). "Role of social media in disaster management," *International Journal of Public Health and Clinical Sciences*, Vol.6, No.2, 1-23.

Tabela 9: Roli i mediave sociale në menaxhimin e fatkeqësive

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi në praktikë
Para katastrofës	Zbutja	Përfshirja e aktiviteteve për reduktimin e rrezikut dhe aktivitetet parandaluese	Ulja e rrezikut
Para katastrofës	Përgatitja	Dhënia e paralajmërimeve për katastrofën dhe zbatimin e aktiviteteve të komunikimit për krizën Sinjalizimi dhe zbulimi i katastrofave	Ulja e rrezikut Paralajmërimet e para
Katastrofa	Përgjigja	Dhënia dhe analizi i mbulimit me lajme të katastrofës Ofrimi dhe marrja e informacionit për përgjigjen ndaj katastrofës Dërgimi dhe marrja e kërkesave për ndihmë apo asistencë (Ri)lidhja e anëtarëve të komunitetit	Përhapja e informacionit
Pas katastrofës	Rimëkëmbja	Mbledhja e donacioneve, inkurajimi i vullnetarizmit dhe rritja e ndërgjegjësimit për një ngjarje Ofrimi dhe marrja e informacionit (dhe diskutimi) i rimëkëmbjes dhe rindërtimit	Fuqizimi i komunitetit

Ky këndvështrim vërtetoi se media sociale luan një rol me shumë funksione në të gjitha fazat e menaxhimit të katastrofës, veçanërisht në komunikimin masiv dhe ndarjen e informacionit. Spektri i kanaleve të mediave sociale bëri të mundur që informacioni të përhapet dhe të ndahet pa pengesa dhe të anashkalojë problemet burokratike, veçanërisht në kohë katastrofash. Përdorimi i teknologjisë së dixhitalizimit për përmirësimin e menaxhimit të katastrofës dhe për promovimin e qëndresës dhe ringritjes së komunitetit ishin në përputhje me planin e Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut të Katastrofës, promovimin e aksesit në kohë reale tek të dhënat e besueshme dhe përdorimin e risive të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar instrumentet e matjes, mbledhjes, analizës dhe përhapjes së të dhënave. Kështu, kjo kornizë e miratuar u siguron aktorëve mundësinë për të zhvilluar dhe shfrytëzuar potencialin e plotë të mediave sociale si një platformë për mbledhjen, zhvillimin dhe përhapjen e të dhënave në të gjithë fazat e menaxhimit të katastrofës. Gjithsesi, duke pasur parasysh evolucionin e vazhdueshëm dhe të shpejtë të mediave sociale, në të ardhmen kjo kornizë mund të përmirësohet sipas nevojës.

Media fiton rëndësi me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm gjatë katastrofave, duke rritur shpëtimin dhe mbështetjen për viktimat dhe duke krijuar besim tek të prekurit. Kjo do të thotë që media është mjeti më i rëndësishëm i zbutjes që mund të kenë në dispozicion autoriteteve gjatë një katastrofe. Veprimi i medias krijon perceptimet publike për rreziqet e ngjarjes. Në këtë kuptim, roli i medias në fatkeqësi nuk mund të kuptohet vetëm si një mjet për të përcjellë dhe përshkruar atë që ka ndodhur dhe për të informuar publikun vazhdimisht. Media si një nga mjetet më të rëndësishme për përhapjen e informacionit tek njerëzit për rreziqe specifike dhe të përgjithshme po përdoret gjerësisht gjatë fazave të ndryshme të një katastrofe. Media duhet të kontribuojë edhe në përgatitjen e njerëzve dhe të komunitetit, të ndihmojë në identifikimin e kërcënimeve të mundshme, t'u bëjë të mundur komuniteteve të shfrytëzojnë potencialin dhe përvojat vendore për t'u përshtatur me krizat, katastrofat dhe sfida të tjera, dhe të sigurojë një forum për planifikimin e komunitetit për rindërtimin pas katastrofës³². Kështu, është e nevojshme të përfshihen mediat në hartimin e planeve kombëtare/vendore për parandalimin e katastrofave dhe reduktimin e rrezikut dhe jo thjesht vetëm në punën për përgjigjen ndaj katastrofave.

Grupi i Kërkimeve për Mediat e Reja dhe Inteligjencën Artificiale i Universitetit të Bostonit po kryen një studim kërkimor në lidhje me mbulimin nga media të pandemisë Covid-19. Studimi krahason sesi media në të mbarë botën bën lajmet për koronavirusin duke përdorur të mësuarit me pajisje kompjuterike për të analizuar tendencat në zhvillimin e lajmeve në vendet e goditura rëndë nga pandemia, si Kina, Koreja e Jugut, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar.³³ Algoritmi i tyre ka konfirmuar se në fillim të shpërthimit të pandemisë, gjatë muajit janar dhe fillimit të muajit marsit 2020, vëmendja e mediave globale ishte e përqendruar kryesisht në përhapjen e virusit në Kinë. Fillimisht, edicionet e lajmeve në këto vende u përqendruan te kërkimet shkencore, punonjësit e kujdesit shëndetësor në vijën e parë të shërbimit dhe te shpërthimi i pandemisë në vend dhe në nivel global. Gjithsesi, shumë shpejt fokusi i medias në të katër këto vende u zhvendos te pasojat ekonomike në vend dhe në nivel ndërkombëtare dhe pasojat financiare - një temë që kryesisht ka mbetur në fokus në shumicën e vendeve të analizuara në këtë studim. Nga ana tjetër, të dhënat e tyre kanë nxjerrë në pah se lajmet për ndërmarrjen e veprimeve personale parandaluese, si distancimi social dhe zbatimi i urdhrave për qëndrimin në shtëpi, kanë qenë vazhdimisht fokusi i kryesor i mediave në SHBA³⁴. Kjo prirje mund të shpjegohet nga kultura amerikane që çmon lirinë e individit, e kombinuar me një qeveri të decentralizuar, që me shumë mundësi bën që veprimet parandaluese të

32 Reis, Clóvis, Mattedi, Marcos, & Barrios, Yanet Reimondo. (2017). Media and disasters: an overview of international scientific production from 1996 to 2016. Intercom: Revista Brasileira de Ciências da Comunicação, 40(2), 77-92.

33 Colarossi, J., (2020). "Comparing How Media around the World Frames Coronavirus News", gjendet në adresën <http://www.bu.edu/articles/2020/comparing-how-media-around-the-world-frames-coronavirus-news/> (aksesuar më 2 tetor 2020).

34 Po aty,

detyrueshme të bëhen më të vështira për t'u zbatuar³⁵. Megjithatë, shqyrtimi i korrelacionit mes mbulimit të lajmeve të Covid-19 dhe rasteve të vërtetuara dhe vdekjeve është ende në proces e sipër dhe pritet që rezultatet të hedhin dritë mbi rolin që mediat e lajmeve luajtën në këtë pandemi globale.

Kutia 8: Konsumimi i lajmeve dhe Covid-19 në Britaninë e Madhe

Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë në Universitetin e Oksfordit ka mbledhur të dhëna * nëpërmjet një sërë sondazhesh se si i marrin njerëzit lajmet dhe informacionet gjatë pandemisë Covid-19. Studimi zbulon se pjesa më e madhe e publikut vazhdon të mbështetet te agjencitë e lajmeve për informacione në lidhje me koronavirusin. BBC News (si radio/tv ashtu edhe faqja në internet), ITV (kryesisht radio/tv) dhe The Guardian (kryesisht faqja në internet) janë tre markat më të përdorura. Megjithatë, si përdorimi i lajmeve, ashtu edhe besimi në lajme dhe perceptimi i përgjithshëm nëse agjencitë e lajmeve i ndihmon njerëzit të kuptojnë dhe t'i përgjigjen krizës kanë rënë ndjeshëm që në fazat e hershme të krizës. Për më tepër, një e treta (35%) thonë se sipas mendimit të tyre situata e koronavirusit në Mbretërinë e Bashkuar është përkeqësuar nga mënyra se si e ka trajtuar media atë, pavarësisht shembujve të shumtë të raportimit të mirëfilltë hulumtues nga media të caktuara informative dhe pavarësisht nga studimet e mëparshme që tregojnë se njerëzit që ndjekin lajmet dinë dukshëm shumë tepër për sëmundjen. Ka pasur një rënie të ndjeshme të besimit që në fazat e hershme të krizës. Përqindja e njerëzve që i vlerësojnë agjencitë e lajmeve si burime relativisht të besueshme informimi për Covid-19 ka rënë nga një shumicë e konsiderueshme (57%) në prill në më pak se gjysma (45%) në gusht. Rënia e besimit të qeveria britanike ka qenë edhe më e madhe, besim që ka rënë nga 67% në prill në 44% në gusht. Është e rëndësishme të theksohet se kjo rënie dyshifrore e besimit të lajmet dhe veçanërisht të qeveria dhe politikanët e Mbretërisë së Bashkuar është shumë më e madhe se gjëryerja e lehtë e besimit tek informacionet në lidhje me Covid-19 nga burime të tjera, qofshin burime shumë të besueshme si NHS dhe shkencëtarët, mjekët dhe ekspertët apo burime shumë më pak të besuara si njerëzit e zakonshëm. **

*Fletcher, R., Kalogeropoulos, A., Nielsen R. K. 2020a. *News Media Broadly Trusted, Views of UK Government Response to Covid-19 Highly Polarised*. Oxford: Reuters Institute for the Study of Journalism.

**Fletcher, R., Kalogeropoulos, A., Nielsen, R. K. 2020b. *Trust in UK Government and News Media Covid-19 Information down, Concerns over Misinformation from Government and Politicians Up*. Oxford: Reuters Institute for the Study of Journalism.

Organizatat e mediave dhe aktivistët e të drejtave të njeriut pretendojnë se kundërmasat Covid-19 të Kinës përfshijnë kufizimin e lirisë së medias dhe përdorimin e instrumenteve të propagandës për të mbyllur mesazhet alternative

në lidhje me pandeminë. Kur shpërtheu koronavirusi, u vu re një liri e shkurtër e medias ku u botuan shumë artikuj kritikë për reagimin e qeverisë kineze ndaj Covid-19. Megjithatë, qeveria kineze nisi menjëherë të ushtronte presione censurimi, duke i detyruar agjencitë e lajmeve të hiqnin artikujt kritikë dhe të botonin informacionet e qeverisë për sukseset e kësaj të fundit në luftën kundër virusit, duke i mbyllur gazetarët e pavarur në karantinë të detyruar, madje edhe duke burgosur qytetarë që raportnin për situatën. Për shembull, tre aktivistë nga Pekini, që kishin hapur një faqe ueb për të mbledhur artikujt e censuruar dhe postimet e mediave sociale për Covid-19 u ndaluan dhe dy qytetarë raportues u zhdukën në mënyrë të dhunshme në Wuhan në muajin shkurt 2020 për raportimin e pavarur për pandeminë. Organizata Human Rights Watch dhe organizata të tjera kanë reaguuar duke i kërkuar qeverisë kineze t'i lirojë menjëherë dhe pa asnjë kusht qytetarët raportues për raportimin publik të shpërthimit të Covid-19.³⁶

Po ashtu, gjatë gjithë pandemisë, informacioni për Covid-19 është kontrolluar rreptësisht në mediat sociale kineze. Në një studim evidentohet se temat e përmbajtjes së censuruar përfshijnë mënyrën e kontrollit të virusit në Kinë, diplomacinë ndërkombëtare dhe tensionet e vazhdueshme midis SHBA dhe Kinës dhe numrin e rasteve të konfirmuara të Covid-19 dhe vdekjeve, si dhe referencat për pajisjet e mbrojtjes personale dhe institucionet mjekësore³⁷. Propaganda e shtetit dhe mediat e kontrolluara që veprojnë si zëdhënës të qeverisë bëhen pengesë për parandalimin dhe ndërgjegjësimin për sëmundjen.

Mbulimi i Covid-19 nga media nuk është pa të metat e saj, madje edhe në shoqëritë demokratike që gëzojnë lirinë e shtypit. Disa raportime të medias për Covid-19 kanë qenë tejet të dëmshme duke e etiketuar virusin si “çrregullimi i virusit kinez”, duke e lidhur përfundimisht Covid-19 me racën.³⁸ Edhe disa udhëheqës kryesorë të botës kanë përsëritur në mënyrë të vazhdueshme një sensacionalizëm të tillë, si Presidenti Donald Trump që e quajti Covid-19 “virus kinez”.³⁹ Në një studim të fundit konstatohet se ky etiketim diskriminues ka rezultuar në sulme të dhunshme ndaj udhëtarëve dhe studentëve ndërkombëtarë kinezë. Raportet çorientuese dhe diskriminuese të mediave mund të ndikojnë në mirëqenien mendore të banorëve etnikë kinezë ose të udhëtarëve gjatë pandemisë globale Covid-19. Ky rast tregon rëndësinë e përgjegjshmërisë së medias dhe raportimit të saj, veçanërisht në kohë krizash. Nevojitet një mbulim më i ekuilibruar dhe i saktë. Hulumtimet e ardhshme duhet të analizojnë ndikimin e raportimit të mediave të shëndeti dhe mirëqenia e qytetarëve.

36 "China: Free Covid-19 Activists, 'Citizen Journalists'", Human Rights Watch, gjendet në adresën <https://www.hrw.org/news/2020/04/27/china-free-covid-19-activists-citizen-journalists> aksesuar më 1 tetor 2020).

37 "Censored contagion in a time of information control on Chinese social media during COVID-19", gjendet në adresën <https://citizenlab.ca/2020/08/censored-contagion-ii-a-timeline-of-information-control-on-chinese-social-media-during-covid-19/> (aksesuar më 1 tetor 2020).

38 Yi Zheng, Edmund Goh & Jun Wen (2020) The effects of misleading media reports about COVID-19 on Chinese tourists' mental health: a perspective article, *Anatolia*, 31:2, 337-340, DOI: [10.1080/13032917.2020.1747208](https://doi.org/10.1080/13032917.2020.1747208)

39 Po aty.

Kutia 9: Këndvështrimi i mediave të lajmeve online për pandeminë Covid-19

uke përdorur analizën e përmbajtjes, inkuadrimit dhe kampionimit e ditës pasuese, në këtë studim fokusi ishte te shqyrtimi i mbulimit nga media të dy muajve të parë të pandemisë Covid-19 nga katër agjenci ndërkombëtare lajmesh, që janë BBC, CNN, Al-Jazeera, dhe the People's Daily (f. 1). Në studim konstatohet se temat kryesore të dy muajve të para ishin sinofobia, krimi, gjeopolitika, marrëdhëniet ndërkombëtare, disinformimi dhe lajmet e rreme. Fillimisht mbizotëronte edhe përdorimi i toneve alarmante, si “sëmundje vdekjeprurëse”, “tmerruese” dhe “niveli i lartë i vdekshmërisë” që përdoreshin rëndom nga agjencitë e lajmeve. Agjencitë ndërkombëtare të lajmeve e ulën tonin pesimist dhe tjetërsimin e sëmundjes kineze dhe të kinezëve në shkurt. U përdor një ton më neutral në raportime. Duke bërë thirrje për masa parandaluese, u vu re se udhëheqësit politikë bënë thirrje për bashkëpunim në trajtimin e kësaj pandemie dhe agjencitë e lajmeve mbështeteshin tek OBSH për udhëzime. Rezultatet e këtij studimi nxjerrin në hap se është e nevojshme të punohet më shumë në drejtim të ndalimit të përsëritjes së tematikave dhe mesazheve që lidhen me diskriminimin dhe stigmatizimin e atyre të infektuar apo të prekur nga pandemia.

*Mutua, S. N., & Ong'ong' a, D. O. (2020). Online News Media Framing of COVID-19 Pandemic: Probing the Initial Phases of the Disease Outbreak in International Media. *European Journal of Interactive Multimedia and Education*, 1(2), e02006. <https://doi.org/10.30935/ejimed/8402>

Duke analizuar raportimin mediatik dhe inkuadrimit e krizës Ebola në Britaninë e Madhe në 2014-2015, Pieri (2019) identifikon disa mësimë që mund të jenë të dobishme në skenarë të tjerë pandemikë: Së pari, roli i raportimit të medias tradicionale vazhdon të ketë rëndësi dhe duhet të shqyrtohet me kujdes më të madh dhe më nga afër, duke pasur parasysh që lindja dhe riprodhimi i tematikave të caktuara ka të ngjarë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në kuptimin e rrezikut në fjalë si në debatet publike ashtu edhe në ato politike⁴⁰. Këndvështrimi i medias për krizën mund të ndryshojnë nga kriza në krizë dhe madje të zhvendoset edhe gjatë zhvillimit të së njëjtës krizë. Prandaj, është me rëndësi të madhe të shqyrtohen me kujdes linjat editoriale të mediave dhe roli i tyre në planifikimin e përgatitjes për të qenë gati, përgatitje që i paraprin një situatë pandemie, përgjigjes ndaj saj dhe përfshirjes në të ardhmen.

⁴⁰ Pieri, E., (2019). “Media Framing and the Threat of Global Pandemics: The Ebola Crisis in UK Media and Policy Response”, *Sociological Research Online*, Vol. 24(1) 73– 92, p. 92.

4 KONTEKSTI DHE KRIZAT E MËDHA TË KOHËVE TË FUNDIT NË SHQIPËRI

Gjatë vitit të kaluar, Shqipëria u përball me një sërë emergjencash, fillimit me tërmetin shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019, pasuar nga shpërthimi i Covid-19 dhe mbylljen e plotë të vendit në 12 mars 2020. Në këtë kapitull prezantohet shkurtimisht në përmbledhje e tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë Covid-19 në Shqipëri. Më pas, jepet një panoramë e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile dhe e medias në Shqipëri për të ofruar kontekstin për studimet e rastit.

4.1 TËRMETI I NËNTORIT 2019

Në nëntor të vitit 2019, Shqipëria u godit nga një tërmet me magnitudë të madhe, që shkaktoi dëme në infrastrukturën fizike dhe në aktivitetin ekonomik dhe jetën e njerëzve. Tërmeti i 26 nëntorit ishte tronditja më e fuqishme e një shkallë të tillë që nuk ishte përjetuar që nga viti 1979. Ai shkaktoi dëme të mëdha në 11 bashki, përfshirë dy bashkitë më të populluara, të urbanizuara dhe të zhvilluara (Tirana dhe Durrësi). Bashkitë të goditura më rëndë ishin Shijaku, Durrësi, Kruja, Tirana, Kamza, Kavaja, Kurbini dhe Lezha. Pas pasojave të rënda, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë"⁴¹. Shumë grupe humanitare dhe vullnetare iu përgjigjën kësaj situate dhe bashkësisë ndërkombëtare ofroi mbështetje dhe donacione.⁴²

Kutia 10: Dëmet nga tërmeti i nëntorit 2019

Si rezultat i fatkeqësisë natyrore, në vend u prekën 202,291 njerëz në vend, 47,263 në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe 155,029 në mënyrë të tërthortë. Tërmeti shkaktoi 51 viktima dhe lëndoi të paktën 913 të tjerë. Për më tepër, u zhvendosën nga vendbanimi i tyre deri në 17,000 vetë për shkak të shkatërrimit të shtëpive të tyre.

PDNA Report, UNDP 2020⁴³

41 Kriza Covid-19 në Shqipëri, raporti i OECD, gjendet në adresën <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf> (aksesuar më 4 tetor 2020).

42 Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës Natyrore në Shqipëri (VNPk), (2020), gjendet në adresën https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/albania_post-disaster_recovery_a_v9.0.pdf (aksesuar më 4 tetor 2020).

43 Ibid._

Si pasojë e tërmetit, Qeveria krijoi Komitetin Kombëtar të Rindërtimit. Edhe pse jozyrtar, ky Komitet supozohej të shërbente si ndërmjetës për fondet e mbledhura privatisht për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti. Pjesë e këtij Komiteti ishin edhe mbledhësit kryesorë të fondeve si Elvis Naçi, Arbër Hajdari, Marin Mema, bankat tregtare ose përfaqësues të biznesit që kanë dhënë ndihma emergjente për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti i 26 nëntorit⁴⁴. Qëllimi ishte që të gjithë anëtarët e komitetit të binin dakord për një plan veprimi për të përdorur fondet e mbledhura për banorët e zonave të dëmtuara nga tërmetit. Mendohej se do të sigurohej transparencë për investimet e ardhshme, kryesisht në strehim, por për të vlerësuar funksionimin dhe transparencën e Komitetit nevojiten hulumtime të mëtejshme. Qeveria më pas krijoi Komisionin Shtetëror të Rindërtimit, si një organ publik kompetent për rindërtimet dhe për të mbikëqyrur rindërtimin u emërua një Ministër i Shtetit.⁴⁵

Qeveria shqiptare, Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore përgatitën së bashku një raport Vlerësimi të Nevojave pas Katastrofës në Shqipëri që u bë publik në 5 shkurt 2020 për të mobilizuar komunitetin e donatorëve. Raporti evidenton se dëmi i përgjithshëm i fatkeqësisë në 11 bashkitë e prekura arrin në mbi 980 milion €, dhe do të duhen rreth 1,08 miliardë për rimëkëmbjen në të gjithë sektorët. Pjesa më e madhe e dëmeve të regjistruara janë në sektorin e strehimit, pasuar nga sektori i prodhimit (si biznesi dhe turizmi, bujqësia dhe trashëgimia kulturore) dhe sektori i arsimit.⁴⁶

Konferenca ndërkombëtare e donatorëve “Së bashku për Shqipërinë”, organizuar nga Bashkimi Evropian, u mbajt në 17 shkurt në Bruksel në mbështetje të përpjekjeve për rindërtim. Rreth 100 delegacione nga Bashkimi Evropian, Shtetet Anëtare dhe partnerët e tij, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, u mblodhën në Bruksel dhe u angazhuan plot 1.15 miliardë euro⁴⁷. Kjo shumë tejkalon faturën totale të rindërtimit prej 1.08 miliardë € të vlerësuar nga raporti i vlerësimit të nevojave.⁴⁸

Transparenca dhe llogaridhënia mbeten çështje me rëndësi tejet të madhe për procesin e rindërtimit. Për të orientuar rindërtimin e sektorit të strehimit, qeveria shqiptare, Banka e Zhvillimit e Këshillit të Evropës, Banka Evropiane e Investimeve, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore kanë miratuar një sërë parimesh

44 Artikuj lajmesh të lidhura me Komitetin Kombëtar të Rindërtimit, gjendet në adresën <https://rindertimi.gov.al/> (aksesuar më 4 tetor 2020).

45 Artikuj lajmesh që lidhen me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit, gjendet në adresën <https://rindertimi.gov.al/> (aksesuar më 4 tetor 2020).

46 “EU and international donors pledge €1.15 billion for reconstruction after the earthquake in Albania” European Commission, gjendet në adresën https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_249 (aksesuar më 4 tetor 2020).

47 “EU and international donors pledge €1.15 billion for reconstruction after the earthquake in Albania” European Commission, gjendet në adresën https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_249 (aksesuar më 4 tetor 2020).

48 Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës Natyrore në Shqipëri (VNPk), (2020), gjendet në adresën https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/albania_post-disaster_recovery_a_v9.0.pdf (aksesuar më 4 tetor 2020).

bazë përmes një Deklarate Qëllimi.⁴⁹ Këto parime përcaktojnë parametrat për mekanizmat e financimit për të siguruar që rindërtimi të jetë i saktë, efikas, me pjesëmarrje dhe transparent, duke bërë të mundur llogaridhënien dhe koordinimin për fondet e kanalizuar dhe përmirësimin e kontrollit për cilësinë e ndërtimit.⁵⁰

Kutia 11: Parimet e rindërtimit

Në këto parime bëjnë pjesë transparenca, llogaridhënia, konsistenca, qartësia, efikasiteti, pjesëmarrja, barazia, qëndresa/ringritja dhe qëndrueshmëria.

Transparenca: Monitorimi i treguesve të ecurisë, afatet kohore dhe lëvrimi i të gjitha fondeve duhet të publikohen rregullisht në internet.

Llogaridhënia: Pjesë përbërëse e hartimit të programit duhet të jenë strategjia e qartë e komunikimit dhe mekanizmi për zgjidhjen e ankesave. Ndikimet e mundshme negative sociale dhe mjedisore të prishjes, ndërtimeve të reja dhe/ose planeve të reja të vendbanimeve duhet të menaxhohen në mënyrë proaktive.

Pjesëmarrja: Programi kombëtar i rindërtimit të shtëpive duhet të orientohet nga pronari, me mekanizma të mjaftueshëm pjesëmarrjeje dhe konsultimi.

Zbatimi në praktikë mbetet për t'u vlerësuar në kohën e vet. Për të trajtuar shqetësimet dhe problematikën e transparencës, Shtetet e Bashkuara dhanë 5.5 milion dollarë në formë asistence për krijimin e Akademisë së Transparencës SHBA-Shqipëri (USATA). USATA do të kontribuojë në drejtim të rritjes së transparencës dhe integritetit të qeverisë, institucioneve publike dhe private dhe do të mbështesë reformën në drejtësi.⁵¹

Në këtë kontekst, roli aktiv i mediave dhe OSHC-ve është me rëndësi tejet të madhe për t'i kërkuar llogari qeverisë duke monitoruar dhe shqyrtuar ecurinë, duke u bërë zëri i shqetësimeve të qytetarëve të prekur nga tërmeti dhe duke u mundësuar atyre e duke i mbështetur ata të jenë pjesë e procesit të konsultimit. Gjithsesi, deri më tani, kjo katastrofë natyrore zbuloi një ndjenjë të jashtëzakonshme solidariteti dhe nxori në pah aspektin karakteristik të vullnetarizmit të shqiptarët,⁵² ku OSHC-të u angazhuan në mënyrë aktive në përpjekje shpëtimi duke ofruar ushqime e veshmbathje në një mënyrë të koordinuar si dhe shërbime mbështetëse psikologjike dhe aktivitete argëtimi për fëmijë, gra dhe të moshuar.⁵³

49 "International Aid for earthquake reconstruction comes with terms of engagement," gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/02/19/international-aid-for-earthquake-reconstruction-comes-with-terms-of-engagement/> (aksesuar më shtator 4, 2020).

50 "EU and international donors pledge €1.15 billion for reconstruction after the earthquake in Albania" European Commission, gjendet në adresën https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_249 (aksesuar më 4 tetor 2020).

51 Sipas postimit të Ambasadës së ShBA-ve në faqen e saj Facebook në 4 qershor 2020. Deri në tetor 2020 nuk kishte informacione të tjera publike.

52 "Vështirësi mbi filantropinë: Tragjedia e 26 nëntor 2019, Raporti i Partnerëve Shqipëri, gjendet në adresën <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/October-December-2019.pdf> (aksesuar më 4 tetor 2020).

53 Po aty.

4.2 PANDEMIA COVID-19

Ndërkohë që po rikuperohej nga tërmeti me shumë familje të pastreha dhe me ndërtesa që vlerësohen si jo-funksionale, Shqipëria u përball me një tjetër emergjencë në fillim të vitit 2020, këtë herë shpërthimi i Covid-19, që në 11 mars 2020 u shpall pandemi botërore nga Organizata Botërore e Shëndetësisë⁵⁴. Qeveria shqiptare reagoi ndaj kësaj situatë duke vendosur masa të rrepta ndalim qarkullimi dhe duke e mbyllur të gjithë vendin. Në 24 mars, Këshilli i Ministrave deklaroi 'Gjendje e Katastrofës Natyrore' nëpërmjet VKM Nr. 243, me kohëzgjatje prej 30 ditësh.⁵⁵ Me shumicë votash, Kuvendi e shtyu gjendjen e katastrofës deri në 23 qershor (Vendimi 18/2020).⁵⁶ Më herët, në 31 janar 2020 ishte ngritur një komitet i përkohshëm ekspertësh për infeksionin Covid-19, që përgjigjet para Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i kryesuar nga Zv. Ministri dhe me 11 anëtarë të tjerë, si mjekë, zyrtarë të shëndetit publik dhe drejtues të agjencive të tjera.

Në fillim të muajit maj vendi filloi të hapet gradualisht. Qeveria nisi procesin e rihapjes për të hapur ekonominë hap pas hapi, duke përfshirë rihapjen e aktiviteteve turistike duke respektuar protokollet e shëndetit dhe sigurisë dhe heqjen plotësisht të ndalim qarkullimit. Në javën e dytë të qershorit, numri i rasteve të reja filloi të rritej me shpejtësi, duke vënë në pikëpyetje procesin e rihapjes. Numri i rasteve në Shqipëri u rrit vazhdimisht me ardhjen e turistëve të verës dhe masat e ngadalta të rihapjes⁵⁷. Qeveria theksoi se një kthimi i mbylljes totale nuk është opsion për momentin dhe u kërkoi qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve të tjera të respektojnë distancën fizike dhe masat e tjera të nevojshme.

Për të lehtësuar situatën, qeveria instaloi një sërë masash⁵⁸:

- ▶ Asistencë sociale dhe mbështetje të tjera për individët, përfshirë pagesat për sëmundje, transferata parash, pagesë për strehim
- ▶ Mbrojtje për shtresat në nevojë në rrezik abuzimi
- ▶ Mbështetje/garanci financiare për bizneset
- ▶ Mbështetje për arsimim nga shtëpia.
- ▶ Qeveria ka dhënë mbështetje financiare në shumën 12.9 miliardë lekë.⁵⁹

54 "Pandemia e koronavirusit (COVID-19)", OBSH, gjendet në adresën <https://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19#:~:text=WHO%20announced%20COVID%2D19,on%2011%20March%202020>, (aksesuar më 20 shtator 2020).

55 Vendimi 243, gjendet në adresën <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx.pdf> (aksesuar më 20 shtator 2020).

56 Vendimi 18/2020 gjendet në adresën <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx.pdf> aksesuar më 20 shtator 2020).

57 Kriza Covid-19 në Shqipëri, Raport i OECD, gjendet në adresën <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf> (aksesuar më 4 tetor 2020).

58 UN Albania COVID-19 Socio Economic Recovery and Response Plan, 10 korrik 2020, gjendet në adresën https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/crisis_prevention_and_recovery/un-albania-covid-19-socio-economic-recovery---response-plan.html (aksesuar më 4 tetor 2020).

59 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 19 tetor 2020, gjendet në adresën <http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/> (aksesuar më 19 tetor 2020)

Kutia 12: Mbështetja e qeverisë për arsimin

Shqipëria ka realizuar një sërë orësh mësimi televizive për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në kanalet televizive kombëtare. Edhe mësimi në distancë u ofrua përmes platformave në internet si Google Classroom, Zoom dhe u organizua në nivel shkolle. Gjithsesi, mësuesit përdorën kryesisht grupet WhatsApp për mësimdhënie. Leksionet në internet vazhduan deri në fund të muajit maj.

Viti shkollor filloi në 14 Shtator 2020, duke ndjekur tre skenarë në varësi të shkollës. Nxënësit kthehen në shkollë dhe i) duke ndjekur të gjitha mësimet fizikisht, ii) duke alternuar mes një javë orësh në shkollë dhe një javë orësh në internet, ose së fundi, nëse situata përkeqësohet, iii) do të bëjnë vetëm mësim në internet. Për më tepër, Ministria e Shëndetësisë shpërndau udhëzime të miratuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, udhëzime që do të respektohen gjatë vitit shkollor, të tilla si detyrimi për të mbajtur maska për nxënësit e shkollave të mesme dhe masa të tjera të sigurisë. Megjithatë, institucionet e arsimit të lartë do të fillojnë vitin e ri akademik online.

* The COVID-19 Crisis in Albania, OECD Report, available at <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf> (Accessed October 4, 2020).

Në vjeshtën e vitit 2019, rritja e parashikuar e PBB-së për vitin 2020 ishte 3.4%, ndërsa në prill 2020 kjo rritje u parashikua të ishte -5% për shkak të krizave të shumta.⁶⁰ Kështu, pandemia e koronavirusit pritet të shkaktojë një recesion të konsiderueshëm në ekonomi, duke pasur parasysh se ekonomia shqiptare mbështetet shumë tek tregtia dhe investimet nga BE, veçanërisht nga Italia. Në tregun e brendshëm, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), sektorët e prodhimit dhe turizmit do të jenë ndër më të prekurit. Papunësia mund të rritet përsëri dhe kushtet e tregut të punës mund të përkeqësohen më tej, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore jeton jashtë vendit (rreth 30% e popullsisë). Gjatë periudhës së krizës, Komisioni Evropian vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë. Gjithsesi, gjatë këtyre muajve, u ngritën shumë kritika në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe funksionimin e shtetit ligjor. Pothuajse të gjitha aktivitetet kaluan online, veçanërisht në sektorin e organizatave të shoqërisë civile.

4.3 SHOQËRIA CIVILE DHE MEDIA NË SHQIPËRI

Shoqëria civile e fortë dhe media e lirë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sistemeve moderne demokratike. Në këtë studim organizatat e shoqërisë civile janë organizatat jofitimprurëse, organizatat kërkimore, shoqatat dhe fondacionet

⁶⁰ Kriza Covid-19 në Shqipëri, Raport i OECD, gjendet në adresën <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf> (aksesuar më 4 tetor 2020).

që veprojnë në Shqipëri. Komponenti i dytë i studimit janë mediat, përfshirë këtu ato radiotelevizive, shtypi dhe media online në nivel vendor dhe qendror.

Studimi fokusohet në Shqipëri dhe tek OSHC-të dhe reagimi i mediave ndaj tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë aktuale globale Covid-19. Në të dy rastet, qeveria ka përdorur të drejtën për të shpallur “Gjendjen e Katastrofës Natyrore”. Sipas udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara, katastrofa përkufizohet si ndërprerja e rëndë e funksionimit të një komuniteti ose një shoqërie, ndërprerje që shkakton humbje të gjithanshme njerëzore, materiale, ekonomike ose mjedisore që tejkalojnë aftësinë e komunitetit ose shoqërisë së prekur për t’i përballuar ato⁶¹. Për sa i përket ciklit të katastrofës, *parandalimi dhe gatishmëria janë elemente të para-ngjarjes, përgjigja (shpëtimi dhe ndihma) ndodh menjëherë pas ngjarjes, dhe rindërtimi dhe rehabilitimi ndodhin në procesin e rimëkëmbjes afatgjatë pas ngjarjes*⁶². Këtu luajnë rol OSHC-të. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e OSHC-ve ishin aktive dhe u angazhuan në fazën e “përgjigjes” si për tërmetin ashtu edhe për pandeminë Covid-19.

Aktualisht nuk ka një regjistër zyrtar për OSHC-të në Shqipëri. Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në fund të vitit 2019, në Shqipëri ishin të regjistruar 11,739 OSHC, ku vetëm në vitin 2019 u regjistruan 313 OSHC të reja.⁶³ Megjithatë, numri i OSHC-ve të regjistruara në organet tatimore, që na jep një vlerësim më të mirë të numrit të OSHC-ve aktive, është vetëm 4,503, duke qenë se mbyllja e një shoqate është proces që zgjat shumë dhe kushton.⁶⁴ Gjithsesi, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile ofron një përmbledhje në bazë të vetë-deklarimit të OSHC-ve. Këto të dhëna janë dhënë në nivel qarku, siç tregohet në Tabelën 10.

61 UN Disaster Risk Reduction Terminology, gjendet në adresën <https://www.undrr.org/publication/2009-unis-dr-terminology-disaster-risk-reduction> (aksesuar më 30 shtator 2020).

62 Rajib, S., & Oikawa, Y. (2014). Education for Sustainable Development and Disaster Risk Reduction, e-book Springer, p. 9.

63 “Matrix on enabling environment for civil society development report” (2019). Partners Albania, gjendet në adresën <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Matrix-on-Enabling-Environment-for-Civil-Society-Development-Report-2019.pdf> (aksesuar më 30 shtator 2020).

64 2018 Civil Society Organizations Sustainability Index, gjendet në adresën <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/resource-csosi-2018-report-europe-eurasia.pdf> (aksesuar më 30 shtator 2020).

Tabela 10: Të dhëna për OSHC e vetë-deklaruara në faqen e AMSHC

Qarku	Numri i OSHC-ve
Shkodra	33
Kukës	12
Lezha	9
Dibra	10
Tiranë	432
Elbasan	26
Fier	13
Korçë	38
Berat	9
Durrës	16
Vlorë	34
Gjirokastër	15
TOTAL	647

Burimi: AMSHC⁶⁵

Roli i organizatave të shoqërisë civile në kohë krizash evidentohet si mbushës i boshllëqeve kur qeveria nuk arrin të ofrojë shërbime në kohën e duhur. Pas tërmetit të nëntorit 2019, OSHC-të në Shqipëri e përshtatën veprimtarinë e tyre me situatën dhe nevojat pas tërmetit. Ato hartuan plane veprimi dhe organizuan fushata për mbledhjen e fondeve që synonin, nga njëra anë, të siguronin shërbime për grupet e synuara, si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe, nga ana tjetër, për t’iu përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme, nevoja që lindnin si pasojë e tërmetit, si shërbimet psikosociale për anëtarët e familjes dhe shërbimet pas shkollës për fëmijët që kanë pushime shkollore.⁶⁶

Në rastin aktual të Covid-19, “aktorët e shoqërisë civile në shumë vende, demokratike dhe jodemokratike, po i dalin zot sfidës së pandemisë në mijëra mënyra të vogla e të mëdha. Ato mbushin boshllëqet e lëna nga qeveria duke ofruar shërbimet bazë, duke përhapur informacione për virusin dhe duke mbrojtur grupet e marginalizuara. Në disa vende, shoqëria civile bashkëpunon me bizneset dhe autoritetet publike për të mbështetur komunitetet e varfra vendore

⁶⁵ Registered CSOs in Albania, available at <http://www.amshc.gov.al/web/ojfi/> (accessed August 24, 2020, website last updated on October 24, 2019).

⁶⁶ Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës Natyrore në Shqipëri (VNPk), (2020), gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_post-disaster_recovery_report_b_v1.7.1.pdf, p. 87, (aksesuar më 24 gusht 2020).

duke u dhënë ndihmë ekonomike.”⁶⁷

Po ashtu, komunitetet që janë më aktive dhe më të integruara politikisht mund t'i paraqesin më mirë kërkesat e tyre dhe të marrin burime nga autoritetet.⁶⁸ Fatkeqësitë krijojnë situata ku marrëdhëniet dhe marrëveshjet e pushtetit mund të perceptohen dhe të ballafaqohen më qartazi, gjë që transformon ndërgjegjen politike, formëson veprimet individuale dhe si dhe forcon apo shpërbën marrëveshjet institucionale të pushtetit.⁶⁹ Roli i shoqërisë civile është po aq i rëndësishëm për krijimin dhe rritjen e besimit të qytetarëve tek masat e qeverisë. Një nga mësimet e nxjerra nga SARS është se “*shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm për të siguruar që përgjigja i drejtohet grupit më të marginalizuar dhe që kjo përgjigje të vazhdojë edhe në fazën e rimëkëmbjes.*”⁷⁰ Në Vlerësimin e Nevojave pas Katastrofës Natyrore rekomandohet e njëjta gjë për OSHC-të në Shqipëri. Siç theksohet edhe në raport, “*është me rëndësi parësore që aktorët vendorë, përfshirë këtu njësitë e vetëqeverisjes vendore, sektorin privat, OJQ-të, organizatat komunitare dhe përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara, të marrin pjesë në procesin e rimëkëmbjes.*”⁷¹

Megjithatë, sipas një studimi të kohëve të fundit, vihet re një zhvendosje e misionit të OSHC-ve për shkak të qëndrueshmërisë së kufizuar me ndikimin të kufizuar në transformimin aktual social, politik dhe ekonomik në Shqipëri. Sektori i shoqërisë civile është zgjeruar për sa i përket numrit të OSHC-ve jashtë Tiranës gjatë pesë viteve të fundit. Gjithsesi, kjo nuk ka çuar në konsolidimin e një shoqërie civile të gjallë dhe të vërtetë.⁷² Ekziston një boshllëk i madh mes qendrës kundrejt periferisë kur bëhet fjalë për kapacitetet e OSHC-ve dhe angazhimin e tyre me vendimmarrësit. Lidhja e dobët me komunitetet dhe përcjellja e kufizuar e shqetësimeve dhe interesave të tyre ndikojnë në potencialin e OSHC-ve për të vepruar si ndërmjetës demokratik, duke përcjellë nevojat dhe interesat e grupeve shoqërore për vendimmarrje tek institucionet publike. Nga ana tjetër, pa ndërtimin, rrjetëzimin dhe koordinimin e koalicionit strategjik mes OSHC-ve, ndikimi i tyre në

67 “Civil society and coronavirus dynamism despite disruption” Raporti gjendet në adresën <https://carnegieendowment.org/2020/04/21/civil-society-and-coronavirus-dynamism-despite-disruption-pub-81592> (aksesuar më 24 gusht 2020).

68 Aldrich, S.P., (2008) Site Fights: Divisive Facilities and Civil Society in Japan and the West, Purdue University, p. 6.

69 Oliver-Smith, A., (1996). “Anthropological Research on Hazards and Disasters,” Annual Review of Anthropology, Vol. 25, 303 -325.

70 “Civil society has a crucial role to play in response to the coronavirus pandemic,” gjendet në adresën <https://www.globalpartnership.org/blog/civil-society-has-crucial-role-play-response-coronavirus-pandemic> (aksesuar më 2 tetor 2020).

71 Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës Natyrore në Shqipëri (VNPk), (2020), gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_post-disaster_recovery_report_b_v1.7.1.pdf, p. 107, (aksesuar më 24 gusht 2020).

72 Bino, B., & Qirjazi, R., Dafa, A., (2020) “Pjesëmarrja e OSHC-ve në Vendimmarrjen në Shqipëri”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, mbështetur nga Westminster Foundation for Development, gjendet në adresën <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania.pdf> (aksesuar më 24 gusht 2020).

jetën politike, ekonomike dhe shoqërore është i kufizuar.⁷³

Kur vjen puna te mediat shqiptare, këto të fundit kanë pësuar transformime të mëdha për t'iu përgjigjur ndryshimeve social-kulturore, politike dhe ekonomike në vend dhe përhapjes së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe tendencave globale të medias. Aktualisht, në Shqipëri ka vetëm një operator publik, Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH). Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në vend veprojnë 5 operatorë kombëtarë privatë dhe 46 operatorë vendorë apo rajonalë.⁷⁴

Është e vështirë të vlerësohet panorama e saktë në vend për sa i përket mediave të shkruara dhe ato online, pasi për to nuk ka të dhëna të hollësishme. Numri i gazetave dhe revistave të botuara në të gjithë vendin vlerësohet të jetë më shumë se 200. Nuk ka të dhëna zyrtare dhe të certifikuara për qarkullimin dhe shitjet e gazetave në Shqipëri. Instituti Shqiptar i Medias numëronte 22 gazeta të përditshme që nga viti 2017. Mediat e shkruara nuk janë të detyruara të botojnë tirazhin dhe shitjet e tyre.⁷⁵

Tabela 11: Panorama e medias në shifra

LLOJI I MEDIAS	NUMRI
AUDIOVIZIVE	
▶ Publike	▶ 1 (RTSH)
▶ Private	▶ 51
▶ Kombëtare	▶ 6
▶ Vendorë	▶ 46
Print media	
▶ Publike	Vlerësohet të jenë 200 por nuk ka statistika për ndarjen sipas nivelit
▶ Private	
▶ Kombëtare	
▶ Vendorë	
Media online	Nuk ka statistika, por vlerësohet të jenë rreth 800, ku 70 prej tyre janë më të njohura

Burimi: AMA dhe KAS Media Programme

73 Po aty.

74 Autoriteti i Mediave Audiovizive, gjendet në adresën <http://ama.gov.al/subjekte-audiovizive/> (aksesuar më 24 gusht 2020).

75 Organet e medias në Shqipëri, gjendet në adresën <https://www.kas.de/en/web/balkanmedia/media-outlets> (aksesuar më 24 gusht 2020).

Si tërmeti ashtu edhe pandemia Covid-19 përmbushin kriteret e lajmeve, ndërkohë që tendenca është të raportohet sipas skenarëve të rastit më të keq. Nga ana tjetër, gjatë një krize (qoftë pandemi apo tërmet), autoritetet dhe ekspertët shkencorë luajnë një rol parësor si burime lajmesh. Ekspertët kanë njohuritë shkencore, ndërkohë që autoritetet janë përgjegjëse për politikën publike. Gjatë tërmetit, por veçanërisht gjatë mbylljes së vendit, u vu re kontroll mbi mediat informative për lajmet që vinin nga burimet zyrtare të qeverisë, shoqëruar nga mjekët, inxhinierët civilë që zinin hapësirën më të madhe të përcaktuar për intervistat nga media.

Liria e medias në Shqipëri ka rënë gjatë vitit 2020, duke e renditur në vendin e 84 sipas Indeksit të Lirisë së Shtypit në Botë për vitin 2020 duke rënë me dy vende në krahasim me 2019 (që renditej e 82).⁷⁶ Në Platformën e Këshillit të Evropës për të promovuar mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, Shqipëria ka regjistruar 15 raste aktive të lirisë së medias ku vetëm pesë janë zgjidhur, brenda pesë viteve (2015-2020).⁷⁷ Siç thonë edhe ekspertët, 'pandemia i dha një mundësi për propagandë Kryeministrit Edi Rama, i cili mori drejtimin e komunikimit me një prani të vazhdueshme në mediat sociale dhe transmetuesin online ERTV. Është raportuar se vetëm në muajin e parë të mbylljes, kryeministri nxori 407 postime në Facebook (13 postime në ditë) dhe 47 orë video, duke krijuar kështu përvojën e parë të qeverisjes së Shqipërisë përmes mediave sociale.'⁷⁸

Kutia 13: Paketa antishpifje dhe përpjekjet për të rregulluar median online

"Ligji për mediat online", i njohur ndryshe edhe si paketa anti-shpifje, përfshin ndryshime të 30 neneve të Ligjit aktual të Mediave Audiovizive, veçanërisht në lidhje me kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe 4 neneve të Ligjit "Për komunikimet elektronike" (AKEP). Ky ligj u aprovua nga Kuvendi në dhjetor 2019 pavarësisht se kundërshtohet gjerësisht nga BE, KiE, OSBE, gazetarët, organizatat vendase dhe ndërkombëtare të mediave dhe nga deputetë të Parlamentit Evropian. Presidenti e ktheu ligjin në Kuvend për rishqyrtim në janar 2020 me arsyetimin se ai shkel lirinë e shprehjes. Në fund të janarit, qeveria u tërhoq nga rivotimi i nismës dhe deklaroi se do të presë mendimin e Komisionit të Venecias.

Në opinionin e tij të shpallur në qershor, Komisioni i Venecias shprehet se dhënia e kompetencave të zgjeruara për AMA shkel lirinë e medias. Po ashtu, Komisioni tha se mediat online duhet të kenë një proces të drejtë ligjor për çdo vendim

76 Raporti për Shqipëri, Liria e Medias, (2020). Reporterët pa kufi, gjendet në adresën <https://rsf.org/en/albania> (aksesuar më 24 gusht 2020).

77 Liria e Medias, Këshilli i Evropës, gjendet në adresën https://www.coe.int/en/web/media-freedom/all-alerts?p_p_id=sojdashboard_WAR_coesoportlet&p_p_lifecycle=0&p_p_col_id=column-4&p_p_col_count=1&sojdashboard_WAR_coesoportlet_keywords=&sojdashboard_WAR_coesoportlet_selected-StringFilters=resolution.activealerts_year.2015_year.2017_year.2019_year.2016_year.2018_year.2020&sojdashboard_WAR_coesoportlet_selectedCategories=11709474 (aksesuar më 24 gusht 2020).

78 Madhi, G., (2020) "Informimi publik në Shqipëri bëhet viktimë e COVID-19", Observatore Balcanico, gjendet në adresën <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-public-information-becomes-a-casualty-of-COVID-19-202724> (aksesuar më 24 gusht 2020).

administrativ para gjykatës dhe sanksionet duhet të jenë në përpjesëtim me shkëlqen. Komisioni deklaroi se “është e nevojshme të sigurohet që masat ligjore dhe gjyqësore janë efektive në luftën kundër shpifjes dhe gjuhës së urrejtjes”. Si përfundim, Komisioni i Venecias mbështeti idenë e “funksionimit me vetë-rregullim dhe respekt për sistemin e përgjegjshmërisë së mediave online”.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë theksoi se ndryshimet nuk përbushin standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias dhe ngrenë shqetësime për rritjen e censurës dhe vetë-censurës dhe hapa mbrapa për lirinë e shprehjes në vend (f. 31). Raporti thekson se “Shqipëria duhet të sigurojë që të respektohen standardet evropiane të lirisë së shprehjes dhe medias.” (f. 31). Që nga tetori i vitit 2020, projektligji për mediat po rishikohet në dritën e opinionit të Komisionit të Venecias dhe përfaqësuesit e qeverisë janë zotuar publikisht të ndjekin udhëzimet e opinionit të Komisionit të Venecias. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, Këshilli Shqiptar i Medias ka krijuar Aleancën për Median Etike në shkurt të vitit 2020, duke synuar të bëhet një mekanizëm funksional për vetë-rregullimin. Shoqatat e medias në Shqipëri, OSHC-të që punojnë në fushën e medias, ekspertët dhe organizatat ndërkombëtare të medias kanë argumentuar vazhdimisht nevojën e konsolidimit të mekanizmave të vetë-rregullimit, veçanërisht për mediat në internet.

“Aleanca Shqiptare për Median Etike krijon mekanizmat për vetë-rregullim”, gjendet në adresën <https://www.coe.int/en/web/tirana/-/albanian-alliance-for-ethical-media-establishes-self-regulation-mechanisms> (Aksesuar në 30 shtator 2020).

“Shqipëri - Opinioni për projekt amendimet në Ligjin Nr. 97/2013 “Për shërbimin e mediave audiovizive”, miratuar nga Komisioni i Venecias në 19 qershor me procedura me shkrim që zëvendëson Seancën Plenare të 123”, Komisioni i Venecias, gjendet në <https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?opinion=980&year=all> (Aksesuar në 30 shtator 2020).

“Planet e qeverisë shqiptare për të miratuar ligjin e shumëpërfolur në përpjekje për të kontrolluar median online”, SafeJournalista Network in Western Balkans, gjendet në <https://safejournalists.net/portfolios/albanian-government-plans-to-enact-highly-disputed-law-attempting-to-control-online-media/> (Aksesuar në 30 shtator 2020).

Komisioni Evropian, Raporti Vjetor 2020, Shqipëria, fq. 14 gjendet në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (Aksesuar në 22 tetor 2020).

“Ligji për median, pengesë e mundshme për Shqipërinë drejt rrugës për BE, kushtëzton nevojën për t’u përmbyshur para Konferencës së Parë Ndërqeveritare”, EXIT, gjendet në <https://exit.al/en/2020/08/11/media-law-potential-obstacle-to-albanias-eu-path-conditions-need-to-be-met-before-first-intergovernmental-conference/> (Aksesuar në 30 shtator 2020).

Përveç lirisë së medias, kriza Covid-19 i intensifikoi edhe më shumë sfidat ende ekzistuese të mediave në Shqipëri. Mediat e shkruara aktualisht po vuajnë më shumë nga kufizimet. Gjatë marsit dhe prillit të vitit 2020, kishte një ngrirje totale të shtypit dhe të gjitha gazetat dhe revistat u botuan vetëm online. Edhe spektaklet në TV u anuluan për shkak të rregullave të reja që nuk lejonin më shumë se dy persona në një sallë, duke i bërë të pamundura prodhimet e drejtpërdrejta apo edhe ato të regjistruara. Raportimi nga terreni po bëhet edhe më i vështirë. Gazetarëve u mungojnë njohuritë dhe procedurat transparente për të raportuar gjatë pandemisë dhe për të mbrojtur veten dhe njerëzit me të cilët punojnë dhe takohen kur raportojnë nga terreni për Covid-19. Edhe reklamat kanë rënë dhe gazetarët ankohen se marrin gjysmën e pagës ose nuk marrin pagë fare. Mediat online duket se po ecin më mirë në këtë drejtim, por është e vështirë të vlerësohet,

sepse është shumë e parregulluar.⁷⁹

Në një raport të kohëve të fundit të Fondacionit Thomson evidentohet se në rastin e Shqipërisë ka fonde të kufizuara për OSHC-të, organizatat e mediave, platformat mediatike, grupet informale, rrjetet që punojnë në fushën e lirisë së shprehjes, medias dhe fusha të ngjashme. Në dritën e pandemisë Covid-19, u dhanë fonde, veçanërisht për ngritjen e kapaciteteve për gazetarinë investigative dhe luftën kundër disinformimit dhe lajmeve të rreme. Gjithsesi, ka mungesë të dhënash të besueshme, sistematike, transparente dhe periodike në lidhje me mbështetjen financiare dhe donacionet për organet e medias, organizatat e medias dhe organizatat përkatëse në Shqipëri. Mbështetja jepet kryesisht sipas projekteve dhe ka (financim bazë) institucional dhe strukturor të kufizuara, duke penguar kështu qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve.

4.4 OSHC DHE MEDIA NË LIGJIN PËR MBROJTJEN CIVILE

Ligji i miratuar në korrik 2019 “Për Mbrojtjen Civile”⁸⁰ ka qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Ligji ka dispozita që prekin rolin e medias dhe të shoqërisë civile gjatë një emergjence civile, kryesisht në lidhje me bashkëpunimin me institucionet publike. Ai përcakton (Neni 8) intensifikimin e bashkëpunimit të të gjitha institucioneve e strukturave në nivel qendror dhe vendor, të partneritetit me subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe shtetasit, të cilët mund të kontribuojnë në uljen e riskut nga fatkeqësitë. Është detyrë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të hyjë në marrëveshje me organizata jofitimprurëse, ose subjekte të tjerë, vendas ose të huaj, në lidhje me mbrojtjen civile. Ligji njih të drejtën e shoqatave dhe organizatave të shoqërisë civile për t’u informuar për fatkeqësitë, për të kryer studime për çështje që kanë të bëjnë me zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe për mbrojtjen civile; për të paraqitur konkluzione pranë institucioneve dhe strukturave të mbrojtjes civile, në nivelin qendror dhe vendor, mbi studimet e kryera nga ato mbi zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ligji njih të drejtën e shoqatave dhe OSHC-ve të tjera për të marrë pjesë vullnetarisht në zbatimin e masave dhe aktiviteteve për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe përbalimin e fatkeqësive, pas miratimit të autoritetit përgjegjës.

79 Bino, B., (2020) “Midis dy zjarreve: Media në kohën e COVID19”, gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/05/10/caught-between-two-fires-albanian-media-in-time-of-coronavirus/> (aksesuar më 25 shtator 2020).

80 Ligji “Për Mbrojtjen Civile”, gjendet në adresën <https://www.parlament.al/Files/Akte/20190724173027liqj%20nr.%2045.%20dt.%2018.7.2019.pdf> aksesuar më 21 tetor 2020).

Neni 49 i ligjit ka të bëjë me informimin e publikut, dhe pika 5 përcakton se subjektet publike e private radiotelevizive, kombëtare e lokale, janë të detyruara që të bashkëveprojnë ndërmjet tyre me institucionet shtetërore, si dhe me organizatat jofitimprurëse për përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike, për përballimin e fatkeqësive duke vendosur pajisje të komunikimit tokësor e satelitor, duke shpërndarë njoftime për fatkeqësitë, veçanërisht te komuniteti që rrezikohet më tepër dhe duke ndërprerë programet e tyre për të dhënë mesazhe të rëndësishme për mbrojtjen civile nga autoritetet e përcaktuara në ligj. Për më tepër, në pikën 8 të të njëjtin nen, theksohet se në rastet e fatkeqësive, mediat dhe organet e tjera të informimit publik, të përcaktuara me ligj, janë të detyruara t'u referohen burimeve zyrtare për njoftime lidhur me numrin e viktimave, listën e emrave dhe të parashikimeve të mëtejshme për mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të tjera, duke shmangur transmetimin e informacioneve sensitive, si dhe duke mos krijuar panik te publiku, në asnjë rast.

Ligji i vitit 2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"⁸¹ përcakton se strukturat shëndetësore janë të detyruara të bashkëpunojnë me organizmat mediatikë dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse për promovimin e përmirësimin e kushteve higjieno-shëndetësore të mjedisit familjar e atij komunitar dhe për ngritjen e nivelit të njohurive shëndetësore të popullatës.

Nga sa më sipër, mund të shihet qartë se institucionet përkatëse, qendrore dhe vendore, të ngarkuar me drejtimin e procesit të menaxhimit të krizave duhet të bashkëpunojnë me OSHC-të dhe organizmat e mediave. PNUD në Shqipëri dhe Co-Plan hartuan një plan për reduktimin e riskut të fatkeqësive në Bashkinë Lezhë⁸², plan që parashikon përfshirjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Komisionin për Mbrojtjen Civile. Projekti do të shërbejë edhe për hartimin e një modeli metodologjik dhe praktik për t'u përdorur për bashkitë e tjera.

81 Ligji i vitit 2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", gjendet në adresën <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj-nr.-15-dt.-10.3.2016-1.pdf> (aksesuar më 21 tetor 2020).

82 Përgatitjet për Planin Vendor të Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive për Bashkinë Lezhë, gjendet në adresën https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/environment_energy/preparation-of-the-local-disaster-risk-reduction-plan-for-the-mu.html (aksesuar më 30 tetor 2020).

Në këtë kapitull analizohet roli i OSHC-ve dhe medias në tërmetin shkatërrimtar të vitit të kaluar dhe shpërthimin e pandemisë Covid-19 në Shqipëri. Pjesët e këtij kapitulli janë të strukturuar në të njëjtën mënyrë, duke filluar me rolin e shoqërisë civile dhe duke vazhduar me rolin e medias. Më pas, në pjesën e fundit, “Përfundimet”, bëhen disa krahasime aty ku është e mundur.

5.1 OSHC-TË DHE MEDIA GJATË TËRMETIT SHKATËRRIMTAR TË NËNTORIT 2019

Roli i shoqërisë civile në përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga kriza e tërmetit shtjellohet më poshtë bazuar në të dhënat nga intervistat e thelluara dhe shqyrtimi i burimeve dytësore.

5.1.1 SHOQËRIA CIVILE MBUSH BOSHLLËKUN: PËRGJIGJA DHE RIMËKËMBJA NËPËRMJET SOLIDARITETIT DHE QËNDRESËS

Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit 2019 shkaktoi dëme të mëdha në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, strehim, turizëm, biznes, trashëgimi kulturore, mbrojtje sociale dhe në mirëqenien e familjeve dhe komuniteteve në 11 bashkitë më të dëmtuara. Ndikimi i tërmetit në zhvillimin makro-ekonomik dhe njerëzor të vendit e vendosi qeverisjen, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, në epiqendrën e një krize të pazakontë, krizë për të cilën ajo ishte fare pak e përgatitur. Strukturat Kombëtare të Mbrojtjes Civile në nivel qendror në Ministrinë e Mbrojtjes shfaqën kufizime jashtëzakonisht të mëdha në menaxhimin e krizës me mungesë pajisjesh dhe burime të tjera. Nga ana tjetër, edhe bashkitë patën kufizime të konsiderueshme në gatishmërinë e tyre për t’u marrë me emergjencën për sa i përket burimeve dhe kompetencave. Bashkitë nuk kishin as plane emergjence, as struktura dhe as burime të përshtatshme.⁸³

Tërmeti nxori më shumë në pah se strukturat përkatëse përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social në nivel vendor kanë mangësi në staf dhe burime, ndërkohë që nuk është bërë ende Vlerësimi i Nevojave dhe nuk janë krijuar Njësitë e Referimit dhe mekanizmat financiarë për të trajtuar nevojat për shërbime të kujdesit social.⁸⁴ Shërbimet e ofruara nga sektori jo-publik, i financuar kryesisht nga OSHC dhe shoqata ndërkombëtare bamirësie, janë përpjekur të mbushin boshllëqet në ofrimin e shërbimeve sociale. Janë pikërisht këto organizata dhe OSHC-të shqiptare që ishin të parat që iu përgjigjën krizës. Ndërkohë që autoritetet publike po bënin përpjekje për të menaxhuar fatkeqësinë në fazën fillestare të emergjencës, aktorët e shoqërisë civile, si OJP, organizatat kërkimore, organizatat vendore, grupet informale, aktivistët, vullnetarët dhe të

83 Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës Natyrore në Shqipëri (VNPK), (2020), gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_post-disaster_recovery_report_b_v1.7.1.pdf, p. 107, (aksesuar më 24 gusht 2020).

84 Po aty.

tjerë iu përgjigjen menjëherë dhe në mënyrën e duhur për të plotësuar nevojave të familjeve dhe komuniteteve të prekura duke ofruar ndihmë dhe shpëtim.

Një gazetar vuri në dukje në fillim të dhjetorit se *“heronjtë e vërtetë të kësaj ngjarjeje katastrofike janë ata vullnetarë që kanë dhënë kohën, energjinë, paratë, dashurinë dhe çdo ons njerëzimi që kanë për të marrë copat.”*⁸⁵ Organizatat e shoqërisë civile arritën të siguronin ndihmë të drejtpërdrejtë emergjente për komunitetet e dëmtuara, si ushqime dhe pajisje të tjera, batanije dhe çadra, organizimin e aktiviteteve për fëmijët e prekur nga tërmeti, materiale shkollore, lodra dhe pajisje të tjera. Një përfaqësues nga sektori i shoqërisë civile që punon me komunitetet rrome dhe egjiptiane në Krujë dhe Lezhë, theksoi se *“ne [OSHC-të] treguam kapacitete të shkëlqyera për menaxhimin e krizave duke qenë të shkathët dhe fleksibël dhe gjatë gjithë kohës duke iu përmbajtur misionit tonë dhe duke përmbushur nevojat e më të marginalizuara gjatë krizës”*⁸⁶. Për më tepër, Raporti i fundit i Freedom House për Shqipërinë thekson se OSHC-të u treguan shumë të organizuara dhe efikase në angazhimin e vullnetarëve dhe ofrimin e ndihmave për qytetarët e prekur nga tërmeti shkatërrimtar që goditi qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës më 26 nëntor.⁸⁷

Në kutizat e mëposhtme evidentohen disa shembuj të përgjigjes konkrete të OSHC-ve menjëherë pas tërmetit. Kjo listë nuk është shteruese.

85 Taylor, A. dhjetor 2020, gjendet në adresën <https://exit.al/en/2019/12/02/the-heroes-of-the-albanian-earth-quake-are-civil-society/> (aksesuar më 28 shtator 2020).

86 Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, shtator 2020.

87 Vurmo, Gj., (2020). Raporti i Freedom House: Shqipëria, gjendet në adresën https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020#footnote23_j9qsf3f (aksesuar më 28 shtator 2020).

Kutia 14: Shoqëria civile i përgjigjet tërmetin - Shembuj

- ▶ **Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar**
Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar na vjen në mendje si një nga ofruesit kryesorë të ndihmave humanitare gjatë këtyre ditëve të fundit. Një ekip prej rreth 200 vullnetarësh kanë punuar gjatë gjithë kohës, duke mbledhur, organizuar dhe shpërndarë 40 tonë ndihma, dhuruar nga 9,000 donatorë. Por më shumë se kaq, me paratë që kanë mbledhur nga donatorë zemërgjerë ata do të fillojnë të ndërtojnë streha të përkohshme për ata, shtëpitë e të cilëve janë shumë të dëmtuara për t'u kthyer në to. Ata do t'i ngrejë këto struktura pranë pronave të tyre të dëmtuara, duke u bërë të mundur njerëzve të vazhdojnë disi me normalitetin në jetën e tyre, pa pasur nevojë të largohen nga vendi ku jetojnë.
- ▶ **Fondacioni “Ndhimë për Fëmijët” dhe Programi “Askush të Mos Mbetet Pas”**
Janë ndihmuar 240 familje të prekura nga tërmeti i nëntorit 2019 me paketa ndihme materiale. Plot 100 familje u mbështetën në Lezhë, 78 në Fushë-Krujë dhe 78 familje në Tiranë.
- ▶ **Mbështetje psikologjike**
Nëpërmjet “Urdhrit të Psikologut” u bë e mundur të mobilizoheshin rreth 260 psikologë dhe t'u atashohen OSHC-ve të ndryshme që punonin në zonat e prekura. Përmes OSHC-ve u angazhuan edhe 274 punonjësish socialë dhe psikologësh (534 gjithsej) dhe mbi 300 vullnetarë.
- ▶ **Hapësira miqësore për fëmijët**
Që në orët e para pas tërmetit, organizata World Vision Shqipëri u përgjigj nevojave më urgjente (me ushqime dhe veshmbathje) popullatës së prekur në Thumanë, Durrës, Kurbin, Lezhë, dhe Kamëz. Në koordinim edhe me qeverinë qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore World Vision hapi dy qendrat e para për fëmijët në kampet në Thumanë dhe Durrës dhe më pas edhe në Shëngjin dhe Kamëz.

Raporti i Filantropisë i vitit 2019 për Shqipërinë, bazuar në monitorimin e përditshëm të donacioneve, fushatave dhe ngjarjeve të botuara në media të ndryshme, media sociale, faqet e internetit të institucioneve publike dhe jopublike gjatë vitit 2019, konfirmon një mobilizim masiv që regjistroi një sasi mbresëlënëse të donacioneve pas tërmetit. Janë kryer fushata të shumta përmes platformës Facebook dhe platformave të mbledhjes së fondeve si GoFundMe, JustGiving, Go Get Funding, Giving Balkans, Fundly dhe të tjera. Diaspora shqiptare u bë nismëtare e mbi 89% të fushatave të dhurimit.⁸⁸

Qeveritë e huaja renditen si kontribuuesi më i madh për donacionet deri tani, por edhe njerëzit kanë kontribuar përmes përpjekjeve të tyre të ndryshme, veçanërisht nëpërmjet platformave për mbledhjen e fondeve. Sipas të dhënave të përpiluara

88 “Vështrim mbi filantropinë: Tragjedia e 26 nëntor 2019, Raporti i Partnerëve Shqipëri, gjendet në adresën <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/October-December-2019.pdf> (aksuesuar më 4 tetor 2020).

nga Giving Balkans, pjesa më e madhe e fondeve të mbledhura shkuan direkt te Qeveria Shqiptare, por edhe te një numër organizatash jo-fitimprurës. Gjithsesi, rreth 11,000,000 Euro u shkuan drejtpërsëdrejti familjeve, përfutuesve fundorë dhe subjekteve të panjohura.⁸⁹

Tabela 12: Përfituesit e donacioneve

Qeveria shqiptare	€ 1,954,783,600.00
Fondacioni Firdeus	€ 8,729,600.00
I panjohur	€ 8,797,600.00
Fondacioni "Fundjave Ndryshe"	€ 4,717,800.00
Familje të caktuara	€ 2,128,000.00
Fondi i Shpëtimit i Tërmetit në Shqipëri	€ 1,968,200.00
Kryqi i Kuq Shqiptar	€ 1,510,300.00
Shoqatën "Rrënjët Shqiptare"	€ 1,425,800.00
World Vision Shqipëri	€ 1,000,000.00
Caritas Albania	€ 750,000.00
joq.al	€ 158,800.00
Strukturat e Emergjencave Civile Shqipëri	€ 11,400.00

*Burimi: Giving Balkans, 2020.⁹⁰

Solidariteti dhe mbështetja nga Kosova

Shqipëria mori mbështetje financiare nga shumë qeveri, donatorë dhe institucione ndërkombëtare financiare, me gjithë fondet e mbledhura përmes dhurimeve të njerëzve dhe të diasporës. Pjesa më e madhe e mbështetjes financiare u siguroi veçanërisht përmes Konferencës "Së bashku për Shqipërinë". Kosova premtoi 200,000 Euro në formë grantesh për qeverinë shqiptare⁹¹. Pavarësisht nga angazhimi zyrtar, aktivistët dhe qytetarët nga Kosova mobilizuan donacione me materiale, si ushqime dhe veshmbathje, dhe i dërguan ato në zonat më të prekura në Shqipëri.⁹² Një akt tjetër solidariteti ishte edhe pritja e familjeve shqiptare në Kosovë dhe ofrimi i strehimit për të prekurit. Sipas artikujve të medias, 420

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Ibid.

⁹¹ Together for Albania, Pledge Statement https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/heard/files/pledge_statement_final_0.pdf, (aksesuar më 21 tetor 2020).

⁹² Lajmet, gjendet në adresën <https://www.evropaelire.org/a/30295125.html>, (aksesuar më 21 tetor 2020).

*shtetas shqiptarë raportohet të kenë hyrë në Kosovë më 27 nëntor 2019.*⁹³

Mungesa e përfshirjes aktive të OSHC-ve që veprojnë në sektorin e digjitalizimit dhe risive

Edhe pse sektori i digjitalizimit dhe novacioneve në Shqipëri po zhvillohet me hap të qëndrueshëm e të shpejtë, u vu re një mungesë e përfshirjes aktive të OSHC-ve apo grupeve jo-formale që veprojnë në sektorin e digjitalizimit dhe risive. Papritshmëria e krizës si dhe ndikimi tek e gjithë popullata, përfshirë këtu edhe ata të angazhuar në këtë sektor, mund të kenë qenë arsyt kryesore e mungesës së këtij angazhimi.

Gjatë kësaj periudhe u vunë re dy angazhime kryesore:

- ▶ Studentët e Departamentit të Gjeografisë në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës krijuan një hartë online për vetë-deklarimin e dëmeve⁹⁴. Në faqen hyrëse të platformës thuhet se të dhënat do t'i dërgoheshin zyrave të emergjencave. Megjithatë, nuk u dhanë shpjegime të tjera për mënyrën se si u përdorën të dhënat e mbledhura.
- ▶ Me anë të një projekti online për Hartat e Rrugëve Humanitare, të koordinuar nga Open Street Map Albania, një grup kontribuesish për hartën e rrugëve të hapura në vend, bënë një hartëzim të ndërtesave dhe zonave të banimit "për të mbështetur organizatat vendore dhe ndihmësit"⁹⁵, siç deklarohen në faqen ueb të projektit Humanitarian Open Street Map website. Nuk ka informacione për mënyrën e përdorimit të të dhënave dhe nëse të dhëna u përdorën nga projekti.

93 Lajmet, gjendet në adresën <https://abcnews.al/kosova-hap-dyert-per-shqiptaret-e-prekur-nga-termeti/> (aksesuar më 21 tetor 2020).

94 Maptionnaire. 2020. Raporto Situatën. [online] Gjendet në adresën: <<https://app.maptionnaire.com/en/7503/>> [aksesuar më 1 nëntor 2020].

95 "HOT Tasking Manager". 2020. HOT Tasking Manager. <https://tasks.hotosm.org/projects/7382#description>.

Mobilizimi i burimeve

Nga ana e donatorëve, nuk pati “fonde emergjence” të destinuar nëpërmjet thirrjeve për aplikime. Megjithatë, aplikimet që kishin të bënin me çështje të tërmetit u pranuan brenda thirrjeve aktuale për aplikime. Po ashtu, u inkurajuan edhe riorientimi i vëmendjes dhe nismave të OJP-ve drejt pasojave të tërmetit dhe hartimit të masave dhe protokolleve për menaxhimin e krizës, për fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit dhe masave për reduktimin e riskut. Për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore, faza e pas-rimëkëmbjes mbeti sfidë për OSHC-të në Shqipëri.

Gjatë menaxhimit të krizës të shkaktuar nga tërmeti i nëntorit 2019, OSHC-të mobilizuan burime për të mbështetur dhe mbushur boshllëkun. Përgjigjet ndaj krizave mund të kategorizohen bazuar në llojin e OSHC-ve dhe të mbështetjes së tyre. Format e veprimit në lidhje me tërmetin përfshijnë përgjigjen dhe reagimin e shpejtë për mbështetje në zonat më të prekura. Për sa i përket mbështetjes financiare, OSHC-të vendore dhe ato kombëtare arritën të përdorin burimet e tyre, rrjetet dhe solidaritetin e qytetarëve për të mobilizuar vullnetarët, por edhe për mbledhjen e fondeve. Në figurat e mëposhtme paraqitet një klasifikim i shembujve të spikatur të OSHC-ve dhe i kontributit të tyre në përgjigjen ndaj krizës.

Figura 1: Lloji i përgjigjes së OSHC-ve në krizën e tërmetit

Mbështetja e dhënë nga organizatat vendore dhe ato komunitare	Mbështetja nga organizatat humanitare	Mbështetja nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare
<ul style="list-style-type: none">• Mobilizimi i vullnetarëve brenda kampeve• Përhapja e informacionit për nevojat nga terreni• Mbledhja dhe shpërndarja e ushqimeve dhe veshmbathjeve (aktori më i madh në mbledhjen dhe shpërndarjen nga qytetarët dhe donatorët ka qenë Aleanca për Teatrin)• Mbështetje psikologjike për më të prekurit, veçanërisht fëmijët	<ul style="list-style-type: none">• Mbledhje fondesh nëpërmjet kanaleve të ndryshme (p.sh., Fundjave Ndryshe, Fondacioni Firdeus)• Bamirësi (p.sh., Fundjave Ndryshe, Fondacioni Firdeus)• Ushqime dhe veshmbathje	<ul style="list-style-type: none">• Ndërmjetësim për informim dhe shpërndarje• Mobilizimi i stafit dhe vullnetarëve për të dhuruar• Programe për ndihmë rindërtimi (p.sh., World Vision Shqipëri, Dega në Durrës)• Mbështetje për fëmijët (Terre des Hommes, World Vision, Save the Children)• Impact assessment (UNDP)

Edhe vetë OSHC-të u përballën me sfida në sigurimin e ndihmës, shpëtimit dhe më pas mbështetjes për rimëkëmbje për komunitetet. Organizatat komunitare, në mënyrë të veçantë, kanë mungesa të burimeve financiare dhe njerëzore. OSHC-ve në përgjithësi u mungojnë kompetencat dhe njohuritë për mënyrën e menaxhimit të krizave. Siç argumenton edhe një përfaqësues i shoqërisë civile: “*nuk dinin si të ofronim ndihmë; nuk kishim informacion për dëmet e tërmetit. Nuk*

kishte masa sigurie dhe as nuk regjistrohej asgjë.” Megjithatë, ishte “fleksibiliteti, solidariteti dhe qëndresa jonë ato që ia dolën.”⁹⁶ Në të ardhmen, është me rëndësi të madhe të mbështeten OSHC-të në përgjigjen dhe menaxhimin e krizave, si të koordinohen me aktorët e tjerë dhe si të kontribuojnë në reduktimin e krizës së fatkeqësisë. Për më tepër, është po aq e rëndësishme “të krijohet një bazë të dhënash ku të ofrohen informacione GIS për njerëzit e prekur në një fatkeqësi dhe të jetë një fond për vullnetarët në terren dhe për krijimin e grupeve të vullnetarëve për emergjencat civile.”⁹⁷ Menaxhimi dhe koordinimi i vullnetarëve janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për ndihmën dhe shpëtimin si dhe për rimëkëmbjen pas fatkeqësive dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të luajnë një rol kyç në këtë koordinim. Në këtë aspekt, një tjetër aktor i shoqërisë civile theksoi nevojën “e përgatitjes së autoriteteve vendore për reduktimin e riskut të fatkeqësisë dhe menaxhimin e krizave dhe për të marrë me seriozitet mundësinë e miratimit të planeve të emergjencës dhe krijimit të buxhetit për të.”⁹⁸

Kutia 15: Koordinimi dhe rasti i Komitetit të Rindërtimit

Komiteti Kombëtar i Rindërtimit

Në 1 dhjetor 2019, Kryeministri i Shqipërisë prezantoi Komitetin Kombëtar të Rindërtimit, një organ jo-fitimprurës, që do të shërbente si urë lidhëse për të orientuar fondet e mbledhura privatisht drejt atyre të prekur nga tërmeti. Në takimin e parë të këtij komiteti (informacioni i marrë nga burime të ndryshme lajmesh) morën pjesë disa drejtues të OSHC/fondacioneve dhe filantropistë, si Arbër Hajdari nga Fundjavë Ndryshe, Elvis Naçi nga Fondacioni Firdeus, apo Marin Mema, gazetar. Pjesëmarrës të tjerë nga organizata jo-qeveritare në këtë takim ishin inxhinierë, komuniteti i biznesit, dhomat e tregtisë, shoqata të ndërtueseve, etj. Përfaqësuesit e OSHC-ve bënë thirrje për më shumë transparencë gjatë procesit të rindërtimit.

Gjatë takimit, Kryeministri bëri thirrje që fondet e qeverisë qeveritare dhe fondet e mbledhura privatisht t'i shërbenin procesit të rindërtimit. Gjithsesi, organizata me ndikim, si Fundjavë Ndryshe, apo individë që mundësuan mbledhje të shumave të konsiderueshme të fondeve, p.sh., Marin Mema, vazhduan me përpjekjet e tyre private të rindërtimit.

Gjatë takimit të 3-të të Komitetit, Kryeministri propozoi Ilir Hoxhollin, një përfaqësues i organizatave solidare, Fondacioni Firdeus, si Sekretar të Komitetit, për të siguruar përfaqësimin, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në procesin e koordinimit dhe për transparencë.

96 Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, shtator 2020.

97 Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, shtator 2020.

98 Intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile, shtator 2020.

Në muajin shkurt 2020 u mbajt një takim i katërt i Komitetit me pjesëmarrjen aktive të organizatave të shoqërisë civile, ata të përfshirë drejtpërdrejt në mbledhjen e fondeve dhe në ndërtim/rindërtim.

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është autoritet shtetëror përgjegjës për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Ky komision u mbledh në dhjetor 2019. Vendimi Nr. 878, datë 24.12.2019, "Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit", Kreu II, pika 2:

Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, me kërkesë të kryetarit, marrin pjesë pa të drejtë vote dhe përfaqësues të organeve të ndryshme publike, të biznesit, ekspertë/profesionistë të fushës së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose drejtues të OJF-ve, me objekt veprimtarie mbrojtjen civile dhe ndihmën humanitare.

Duket se Komiteti Kombëtar i Rindërtimit u institucionalizua si Komisioni Shtetëror i Rindërtimit. Do të duhen studime të tjera për të parë se si u përfshinë OSHC-të në këtë komision. Po ashtu, studime të tjera duhen edhe në lidhje me ndërveprimin mes komisionit dhe mediave.

Në fazën e rimëkëmbjes, Qeveria dhe shoqëria civile koordinuan përpjekjet e tyre duke ofruar shërbime të mbështetjes psikologjike dhe aktivitete argëtuese për fëmijët, gratë dhe të moshuarit në qendra të ndryshme strehimi. OSHC-të i përshtatën aktivitetet e tyre sipas situatës dhe nevojave të periudhës së pas tërmetit ndërkohë që ofronin shërbime specifike për grupet e synuara: fëmijë, gra, persona me aftësi të kufizuara dhe të rinj. Në këto aktivitete përfshiheshin shërbime psikosociale, aktivitete pas shkollës për fëmijë si dhe donacione në natyrë.⁹⁹ Ekipet e angazhuara raportojnë çdo javë dhe koordinoheshin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke diskutuar për nevojat dhe duke planifikuar ndërhyrjet dhe aspektet e punës për të siguruar një mbulim më të mirë me shërbime dhe për të shmangur duplikimin e shërbimeve. Vëmendje e veçantë iu kushtua personave të zhvendosur, personave me sëmundje kronike, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara¹⁰⁰. Gjithsesi, personeli i mobilizuar nuk u shpërblye për punën jashtë orarit.

99 Albania Post Disaster Needs Assessment (PDNA), (2020), gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_post-disaster_recovery_report_b_v1.7.1.pdf, p. 107, (aksesuar më 24 gusht 2020).

100 Albania Post Disaster Needs Assessment (PDNA), (2020), gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_post-disaster_recovery_report_b_v1.7.1.pdf, p. 107, (aksesuar më 24 gusht 2020).

Monitorimi i shpenzimeve dhe transparenca nga ana e OSHC-ve janë të kufizuara dhe sporadike.

Nisma më e fundit e nisur nga Ambasada Amerikane në Tiranë parashikon krijimin e Akademisë së Transparencës Shqiptaro-Amerikane (USATA), me një fond të planifikuar prej 5.5 milion USD. Akademia do të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë në rritjen e transparencës në lidhje edhe me fondet për rindërtimin pas tërmetit.¹⁰¹

Kutia 16: Shembuj të monitorimit të OSHC-ve të menaxhimit të krizës së tërmetit

Në Durrës, Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC), një nga aktorët më aktivë vendorë, me mbështetjen e programit ReLoad të UNDP po punon për ngritjen e një platforme online komunikimi mes qytetarëve dhe bashkive. Një nga përbërësit kryesorë është monitorimi nga qytetarët i shpenzimeve që bëjnë bashkia për rindërtim.

Raporti Vjetor i KE për Shqipërinë (2020) nxjerr në pah rolin e shoqërisë civile gjatë emergjencës së pas tërmetit të nëntorit 2019, rol që bëri të mundur përgjigjen e shpejtë, duke shkuar tek qytetarët më të marginalizuar dhe në zonat e largëta, duke mbështetur dhe plotësuar ndërhyrjet e shtetit¹⁰². Megjithatë raporti vëren edhe mungesën e progresit në lidhje me mjedisin mundësues për shoqërinë civile në Shqipëri dhe veçanërisht në lidhje me objektin dhe vazhdimin e mekanizmave të ligjit për konsultimet publike për të siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. OSHC-të do të vazhdojnë të përballen me sfida të tilla gjatë pandemisë Covid-19.

Organizatat ndërkombëtare rekomandojnë zgjerimin e mëtejshëm dhe promovimin e partneriteteve dhe përpjekjeve të përbashkëta mes autoriteteve në nivel vendor dhe qendror, në sektorin privat, me ofruesit e shërbimeve financiare, organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve, organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë ndërkombëtare. Një bashkëpunim i tillë ndërsektorial do të ishte shumë i domosdoshëm edhe gjatë pandemisë Covid-19.

101 Lajmet, gjendet në adresën <https://euronews.al/al/aktualitet/2020/06/04/shba-5-5-milione-dollare-shqiperise-per-ngritjen-e-akademie-se-transparences>, (aksesuar më 21 tetor 2020).

102 Komisioni Evropian, Raporti Vjetor 2020, Shqipëria, p. 14 gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (aksesuar më 22 tetor 2020), p. 14.

Tabela 13: Tiparet kryesore të rolit të shoqërisë civile në krizën e tërmetit

Arritjet	Sfidat
1. OSHC si në nivel vendor dhe qendror mobilizuan burimet e tyre për të ofruar mbështetje emergjence.	1. Sipas perceptimeve të të anketuarve, reagimi i sektorit për sa i përket tërmetit ishte përgjithësisht i dobishëm. Gjithsesi, mungesa e koordinimit ishte dobësia kryesore. Ka pasur raste ku shfaqet mungesa e koordinimit dhe shpërndarja e donacioneve vetëm në një destinacion duke lënë zonat e tjera të prekura të pambuluara.
2. OSHC-të ofruan mbështetje të drejtpërdrejtë duke mbledhur fonde mes anëtarëve dhe donacioneve. Ato shërbyen si pika ndërmjetëse informimi mes familjeve të prekura dhe atyre që ofronin ushqime dhe gjëra të tjera të nevojshme.	2. Trajtimi i frikës personale gjatë punës në terren ishte një nga sfidat.
3. Puna e brendshme dhe praktikat e zakonshme të punës së OSHC-ve në përgjithësi nuk u prekën drejtpërdrejt dhe përgjigja nga sektori ishte e menjëhershme.	3. Kontaktet dhe rrjeti i OSHC-ve shërbyen si kanal komunikimi për koordinim me pothuajse asnjë përditësim nga bashkitë. Për OJF-të vendore, siç deklarojnë ato “zyrat boshe të bashkive” ishin problemi kryesor.
4. Pjesa më madhe e organizatave ia dolën të mblidhnin donacione me ushqime dhe veshmbathje, ndërsa ato kombëtare punonin kryesisht në fushën humanitare, duke siguruar edhe ndihmë financiare për rindërtimin.	4. Menaxhimi i kohës dhe përgjigja e menjëhershme për mbledhjen dhe lëvrimin e donacioneve.
5. Më e rëndësishmja, ndihma psikologjike nëpërmjet vullnetarëve, veçanërisht në kampe, ishte shumë e dobishme për qytetarët e prekur nga tërmeti.	5. Identifikimi i rasteve që kishin nevojë për mbështetje dhe koordinimi me aktorët e tjerë për të dhënë asistencën/shërbimet e nevojshme.

5.1.2 ROLI I MEDIAS NË KRIZËN E TËRMETIT

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe kriza që pasoi më pas shkaktuan një bujë mediatike me fluks intensiv lajmesh që mbulonin ngjarjen dhe ndikimin e saj. Nga analiza e përmbajtjes tregohet se numri i artikujve rreth tërmetit është i madh dhe vazhdoi të mbizotëronte titujt kryesorë për gjashtë javët në vazhdim. Në fazën fillestare, tërmeti u bë një lajm i veçantë dhe kryesor për pjesën më të madhe të organeve mediatike. Në fund të dhjetorit 2020, lajmet në lidhje me tërmetin u vendosën brenda kategorive ekzistuese në varësi të temës që raportohej: si lajmet sociale, ekonomike apo ato politike.

Mbulimi mediatik i tërmetit lidhet me fazat e njëpasnjëshme të fatkeqësisë: goditja nga tërmeti dhe shpëtimi; ndihma dhe lehtësimi; rimëkëmbja dhe ndikimi. Këndvështrimet më të spikatura të përdorura për të strukturuar lajmet ishin: interesi dhe siguria e njerëzve, dëmet dhe pasojat, caktimi i përgjegjësisë, solidariteti dhe mobilizimi, rindërtimi dhe mbështetja ndërkombëtare.

Analiza eidenton se media bëri një punë të lavdërueshme menjëherë pas goditjes së tërmetit me një mobilizim të përgjithshëm të medias menjëherë pas goditjes së madhe herët në mëngjesin e 26 nëntorit 2019. Media ishte e angazhuar në raportimin e informacionit të saktë nga vendet e goditura nga fatkeqësia dhe me transmetime, brenda mundësive të saj, të historive personale dhe pasojave tragjike të tërmetit. Ky këndvështrim i interesit njerëzor shoqërohet me rrëfimin ose temën e tragjedisë dhe fataliteteve. Në aspektin pozitiv, media e shfrytëzoi këtë moment, i cili ndihmoi në përcaktimin e agjendës. Zakonisht, personeli i marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin në institucionet qeveritare dhe politikanët ndikojnë në përcaktimin e axhendës, por në fazën e parë të katastrofës së tërmetit, media mori kontrollin e situatës. Përveç kësaj, në këto raportime mediatike ishin të pranishme këndvështrimi kritik dhe analiza.

Tabela 14: Raportimi nga media për tërmetin

Faza e fatkeqësisë	Këndvështrimi	Tematika/Mesazhi	Pjesëmarrja e qytetarë në përmbajtjen e raportimit	Lloji i raportimit
Goditja nga tërmeti dhe misionet e shpëtimit (Java 1)	<p>Interesi dhe siguria e njerëzve</p> <p>Dëmet dhe pasojat</p>	<p>Histori tragjike dhe personale të viktimave dhe familjeve</p> <p>Fatalitete për shkak të fatkeqësisë natyrore të paprecedentë</p> <p>Dëme shkatërrimtare dhe pasoja të rënda ekonomike</p> <p>Thirrje për ndihmë dhe asistencë</p> <p>Dhënia e informacionit të dobishëm për zonat e prekura</p> <p>Dhënia e hapësirës për ekspertët dhe inxhinierët për t'u dhënë qytetarëve mesazhe sigurie</p>	<p>Prani e drejtpërdrejtë me citime dhe dëshmi</p> <p>Komente të drejtpërdrejtë</p> <p>Përmbajtje e krijuar nga qytetarët</p>	Titujt kryesorë të lajmeve
Ndihma dhe mbështetja (Java 1 - 4)	<p>Interesi dhe siguria e njerëzve</p> <p>Caktimi i përgjegjësisë</p> <p>Solidariteti dhe mobilizimi</p>	<p>Fatalitete për shkak të fatkeqësisë natyrore të paprecedentë</p> <p>Dëme shkatërrimtare dhe pasoja të rënda ekonomike</p> <p>Thirrje për ndihmë dhe asistencë</p> <p>Caktimi i fajit: Përgjegjësia për fatkeqësitë</p> <p>Vlerësimi nga ekspertët i shkaqeve dhe pasojave të fatkeqësisë</p> <p>Solidariteti, donacionet dhe ofrimi i asistencës dhe ndihmës</p>	<p>Prani e drejtpërdrejtë me citime dhe dëshmi</p> <p>Komente të drejtpërdrejtë</p> <p>Përmbajtje e krijuar nga qytetarët</p>	Titujt kryesorë të lajmeve
Rimëkëmbja dhe ndikimi (Pas javës 4)	<p>Caktimi i përgjegjësisë</p> <p>Dëmet dhe pasojat</p> <p>Rindërtimi dhe mbështetja ndërkombëtare</p>	<p>Vlerësim kritik i situatës: shkaqet, ndikimi dhe pasojat</p> <p>Masat e ndihmës nga qeveria</p> <p>Planet e rindërtimit</p> <p>Mobilizimi i mbështetjes ndërkombëtare</p> <p>Solidaritët dhe mirënjohje</p>	<p>Prani e kufizuar</p> <p>Qeveritarët dhe politikanët rimarrin fokusin qendror</p> <p>Ekspertët mbeten të pranishëm</p>	<p>Më pak kryetituj</p> <p>Lajme sociale</p> <p>Lajme ekonomike</p> <p>Lajme politike</p>

Një tendencë tjetër pozitive që vazhdoi edhe gjatë fazës së rimëkëmbjes dhe ndikimit ishte fokusi te ekspertët dhe inxhinierët në media. Kjo e fundit u dha hapësirë të madhe atyre për të shpjeguar dukurinë, për t'u dhënë siguri qytetarëve dhe për të hedhur poshtë përmbajtjet që disinformonin dhe përhapnin panuk. Një temë bazë ishte analiza e shkaqeve të magnitudës së dëmeve, analizë që u krye publikisht nga ekspertët dhe jo vetëm nga opinionbërësit dhe komentuesit e medias. Vlen të theksohet se fillimisht media luajti një rol kyç në raportimin e rasteve abuzive dhe, ajo që është edhe më e rëndësishme, shërbeu edhe si platformë për të raportuar për nevojat e komunitetit. U vunë re edhe raste të dhënies së informacioneve të dobishme dhe thirrje për ndihmë dhe asistencë.

Shqetësimi kryesor në lidhje me rolin e medias në pasojat e tërmetit të nëntorit 2019 lidhet me investigimin e pasojave ose institucioneve përgjegjëse. Në vlerësimet dhe lajmet e para u përcaktua përgjegjësia për katastrofën; më pas kjo temë nuk u ndoqi më sistematikisht. Po ashtu, media nuk e ndoqi më ecurinë e procesit të rindërtimit, atë që nuk u bë apo u bë me cilësi të dobët nga qeveria. Në këtë drejtim, lajmet kryesore mbulonin kryesisht vizitat e Kryeministrit Rama në shtëpitë e rindërtuara ose te familjet që u ishte siguruar strehim i përkohshëm. Për më tepër, media nuk ndërmori asnjë nismë për të monitoruar procesin e rindërtimit, duke pasur parasysh projektet e shtrenjta të rindërtimit të financuara nga taksapaguesit dhe paratë e donatorëve. Siç theksoi edhe një nga të intervistuarit: *“nuk ka më ‘gërmime’ se çfarë po ndodh aktualisht me donacionet, me fondet e donatorëve dhe përpjekjet e qeverisë për rindërtim.”*¹⁰³

Një tjetër shqetësim lidhet me mungesën e aksesit tek informacioni. Një nga të intervistuarit theksoi se *“nëse institucionet do të ishin më të hapura për t'i thënë gjërat ashtu siç janë, puna e medias do të ishte më cilësore.”*¹⁰⁴ Edhe pse ekspertëve iu dha një rol i rëndësishëm, fokusi mbeti ende tek opinionbërësit dhe komentuesit e medias. Pas fazës së lehtësimit, ku reporterët ishin thjesht ofrues informacioni, rolin qendror e morën zyrtarët e marrëdhënies me publikun dhe ato e zhvendosën vëmendjen te diçka më spektakolare (si akomodimi në hotele me pesë yje).¹⁰⁵ Abuzimi me titujt kryesorë për të tërhequr vëmendjen u vu te veçanërisht te mediat online. Media u përball me sfida në përmbushjen e misionit të saj gjatë tërmetit, sfida që lidhen me probleme të sigurisë dhe mirëqenies së gazetarëve dhe profesionistëve të medias. Problem mbetet ende etika në raportimin nga media të fatkeqësisë, tragjedisë dhe pasojave. Gazetarët dhe profesionistët e medias kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme dhe trajnime për mënyrën e trajtimit të krizave, si t'i raportojnë ato dhe si të administrojnë materialet informative në kohë krizash si dhe si të luftojnë lajmet e rreme dhe disinformimin.

103 Intervistë me një përfaqësues të medias, shtator 2020.

104 Intervistë me një përfaqësues të medias, shtator 2020.

105 Intervistë me një përfaqësues të medias, shtator 2020.

Gjatë tërmetit të muajit nëntor 2019, lajmet e rreme (fake news)¹⁰⁶ kanë qenë shumë të përhapura në opinionin publik shqiptar. Në disa media pak ose aspak të njohura është shpërndarë një foto, në formën e një lajmi standard, ku thuhet se në mëngjesin e datës 27 nëntor 2019 një tërmet me magnitudë 7.2 ballë do të godiste sërish vendin.¹⁰⁷ Lajmet e rreme u shpërndanë në opinionin publik shqiptar edhe nëpërmjet manipulimit të imazheve, si në rastin e njoftimit me Facebook nga Ministria e atëhershme e Arsimit, Besa Shahini.¹⁰⁸ Edhe biznese private u bënë objekt i lajmeve të rreme. Në një foto të publikuar nga një portal online pretendohet se një hotel i madh me numër të lartë frekuentuesish ishte dëmtuar rëndë nga tërmeti. Në një postim të nxjerrë nga administrata e hotelit thuhet se ky i fundit do të ndërmerre hapat e nevojshëm ligjorë për këtë çështje¹⁰⁹. WhatsApp ka rezultuar të jetë platformë nga ku përhapen shumë lajmet e rreme. Në formatin e mesazheve audio, më 28 nëntor, një person paralajmëronte një tjetër në Durrës se sipas ushtarakëve italianë ata që jetojnë në katet e sipërme duhet të evakohen, pasi një tërmet tjetër që do të ndodhte gjatë natës mund të shkaktonte dëme të mëdha¹¹⁰. Një hetim nxjerr në pah se policia e shtetit kërkoi ndjekjen penale të shumë qytetarëve, shumica prej tyre gazetarë dhe drejtues të medias, me akuzën e përhapjes së panikut pas tërmetit.¹¹¹

Raporti Vjetor i KE për Shqipërinë (2020) i bën jehonë shqetësimeve të ngritura nga organizatat që merren me lirinë e shprehjes për sa i përket veprimeve të qeverisë ndaj medias pas tërmetit të 26 nëntorit. Në raport evidentohet mbyllja e portaleve online dhe arrestimi i individëve me pretekstin e përhapjes së panikut: Me pretekstin e përhapjes së panikut në publik në situata emergjente të periudhës pas tërmetit, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) mbylli disa portale që perceptoheshin përgjithësisht se kishin qëndrim kritik ndaj qeverisë. Një 25-vjeçar u mbajt në arrest për katër ditë nga drejtoria e policisë kundër terrorizmit, pasi shpërndau një artikull të një medie të huaj në lidhje me një shpërthim të mundshëm të depove të gazit natyror gjatë pasgoditjeve të tërmetit dhe ku u kërkohet autoriteteve të bënin një vlerësim urgjent për këtë çështje.¹¹²

106 Lajmet e rreme të lidhje me tërmetin ishin jashtëzakonisht alarmante pas tërmetit të 21 shtatorit 2019, kur portali online syri.net raportoi se një tjetër tërmet do të godiste Shqipërinë dhe u bëri thirrje qytetarëve të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Ky lajm u përcoll edhe nga gazeta Shekulli. 12 gazetarë të të dy mediave u vunë nën hetim me akuzën e përhapjes së panikut.

107 "Sërish lajme të rreme për tërmetin", gjendet në adresën <https://www.newsbomb.al/serish-fake-news-kriminal-per-termetin-kujdes-mos-i-besoni-187456> (aksesuar më 20 shtator 2020).

108 "Besa Shahini post", gjendet në adresën <https://www.facebook.com/shahinibesa/photos/a.1991075787816191/2431034423820323/?type=3> (aksesuar më 20 shtator 2020).

109 Artikull lajmi, gjendet në adresën <https://dosja.al/reagon-maritim-plaza-tirana-godina-ska-asnje-demtim-podermarrim-hapa-ligjore-per-fake-news/> (aksesuar më 20 shtator 2020).

110 Artikull lajmi, gjendet në adresën <https://shqiptarja.com/lajm/nje-audio-ne-italisht-shperthen-panikun-ne-durres-por-eshite-false> (aksesuar më 20 shtator 2020).

111 Emiri, G., gjendet në adresën <https://www.reporter.al/shpermdarje-paniku-policia-perndoqi-gazetaret-pas-termetit-dhe-covid-19/> (aksesuar më 26 shtator 2020).

112 Komisioni Evropian, Raporti Vjetor 2020, Shqipëria, p. 14 gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (aksesuar më 22 tetor 2020), p. 32.

Në tabelën e mëposhtme tregohet roli që u luajt nga mediat sociale gjatë krizës së shkaktuar nga tërmeti në Shqipëri, sipas modelit të ofruar në kreun 3 – *kuadri konceptual: OSHC-të dhe media në kohë krizash*.

Tabela 15: Roli i medias sociale në menaxhimin e krizës të shkaktuar nga tërmeti

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi
Para katastrofës	Zbulija	<p>Mungesa e veprimtarive të reduktimit të riskut dhe masave parandaluese në peizazhin e mediave sociale</p> <p>Ndonëse një tjetër tërmet goditi Shqipërinë më herët në 2019, nuk shihen përpjekje për rritjen e qëndrësës së komunitetit në mediat sociale para tërmetit të 26 Nëntorit 2020. Mediat sociale shërbyen për t'i bërë të mundur anëtarëve të një komuniteti të krijonin rrjete komunikimi gjatë dhe pas tërmetit.</p>	Përpjekje të kufizuara për reduktimin e riskut të fatkeqësisë
Para katastrofës	Përgatitja	<p>Para 26 nëntorit 2020 nuk ishte hartuar asnjë strategji specifike komunikimi të krizës dhe asnjë vëmendje e veçantë nuk i kushtojë informacionit dhe provave shkencore në lidhje me tërmetet në Shqipëri, pavarësisht se vendi konsiderohet të ketë një aktivitet të lartë sizmik.</p> <p>Tërmeti është një dukuri e paparashikueshme natyrore, por ka ende vend për përgatitje, veçanërisht nga autoritetet publike. Mediat sociale nuk u përdorën nga qeveria dhe autoritetet kompetente para tërmetit të nëntorit për të komunikuar me publikun se si të përgatiten, për të angazhuar qytetarët në aktivitete përgatitjeje për fatkeqësitë dhe për të ndarë informacione për të qenë të përgatitur për tërmetin. Për shembull, udhëzime për mësuesit se si të reagojnë në rast tërmeti.</p>	Përpjekje të kufizuara për reduktimin e riskut të fatkeqësisë. Nuk jepen paralajmërime paraprake

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi
Katastrofa	Përgjigja	<p>Mediat sociale ishin me rëndësi kritike për shpërndarjen e lajmeve mbi tërmetin shkatërrimtar. U shpërndanë dhe rishpërndanë në mënyrë masive postime, ripostime analiza, komente, paralajmërime dhe përmbajtje të tjera. Po ashtu, ishin të pranishme edhe komente, postime dhe materiale të pavërtetë dhe që nxisnin panik, ndonëse jo mbizotëruese.</p> <p>Mediat sociale shërbyen edhe për të trajtuar mungesën e informacionit nga qeveria duke përdorur burime alternative informacioni. Gjithsesi, kjo nxori në pah edhe të meta që kishin të bënin me cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit.</p> <p>Mediat sociale u përdorën edhe për të kërkuar ndihmë, për të rritur ndërgjegjësimin, për të mbledhur fonde, mobilizuar vullnetarë dhe për të organizuar dhe koordinuar asistencën dhe mbështetjen.</p> <p>Nga ana tjetër, mediat sociale u përdorën edhe për të denoncuar abuzimet dhe shpërdorimet, edhe kur kjo gjë raportohej nga gazetarë profesionistë.</p> <p>Mediat sociale u shërbyen edhe autoriteteve publike, si Kryeministrisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të përçuar mesazhet dhe informacionet zyrtare, duke vepruar kështu më shumë se mediat standarde.</p>	<p>Përhapja e informacionit</p> <p>U vunë re edhe përhapje paniku dhe lajmesh të rreme</p> <p>Mbivendosje informacioni që shpërndahet mes qytetarëve, organizatave dhe raporteve të gazetarëve për tërmetin në mediat sociale bëri të mundur të kuptohet më mirë fenomeni dhe rriti magnitudën e ndikimit të kësaj fatkeqësie.</p>

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi
Pas katastrofës	Rimëkëmbja	Në këtë fazë, mediat sociale, veçanërisht Facebook, që është edhe më e përdorura, u përdor gjerësisht për të mbledhur donacione, për të inkurajuar vullnetarizmin dhe për të zhvilluar fushata ndërgjegjësimi. Mediat sociale shërbyen edhe për të përcjellë mesazhe për rilidhjen e familjeve dhe komuniteteve dhe rikthimin e jetës së komunitetit dhe aktiviteteve të biznesit.	Përhapje e informacionit

Në tabelën e mëposhtme jepen tiparet kryesore të medias që raportoi për krizën pas tërmetit shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019.

Tabela 16: Tiparet kryesore të rolit të medias- Tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit 2019

Arritjet	Sfidat
1. Informimi, mobilizimi dhe interesi për njerëzit	1. ndjekja e mëtejshme e problematikës ka qenë në nivel të ulët dhe investigimet e mediave për pasojat e tërmetit apo për aktorët përgjegjëse
2. "Pushteti" i ekspertëve, inxhinierëve dhe shkencëtarëve	2. Aksesi i medias tek informacioni publik ka qenë i kufizuar
3. Rol mbikëqyrës	3. Lajme të rreme dhe disinformime

5.2 SHOQËRIA CIVILE DHE MEDIA GJATË PANDEMISË COVID-19

Shpërthimi Covid-19 e gjeti Shqipërinë duke u marrë ende me pasojat e tërmetit shkatërrimtar të nëntorit 2019. Shumë bashki vazhdonin të përballeshin me pasojat e tërmetit, rindërtimi ishte në fazën fillestare dhe ekonomia shqiptare nuk e kishte marrë ende veten nga dëmet tërmetit. Kështu, Covid-19 përbënte jo vetëm një krizë të paprecedentë të shëndetit publik në Shqipëri, por vuri në vështirësi edhe aftësitë dhe burimet e autoriteteve për t'u marrë me këtë emergjencë globale të pandemisë. Covid-19 ka ndikuar te të gjitha aspektet e jetës, nga arsimi të ekonomia dhe politika. Ai ka bërë dëme të konsiderueshme në shumë vende dhe ka pasur ndikime jashtëzakonisht të mëdha në të gjithë botën. Në këtë pjesë shqyrtohet me më shumë hollësi roli i shoqërisë civile dhe medias gjatë pandemisë Covid-19 në Shqipëri, duke mbuluar kryesisht periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme nga muaji mars deri në muajin qershor të vitit 2020.

5.2.1 SHOQËRIA CIVILE DHE COVID-19

Aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri po përballen me shumë pasiguri dhe sfida për shkak të krizës Covid-19. Si fillim, OSHC-të duhej të përshtatnin punën dhe funksionimin e tyre për shkak të mbylljes totale të vendit dhe me punën në distancë. Në të njëjtën kohë, aktorëve të shoqërisë civile iu duhej t'i përgjigjeshin emergjencës si dhe të përmbushnin objektivat, afatet kohore të projekteve dhe të trajtonin edhe çështje të tjera të sigurisë së stafit të tyre. Nga ana tjetër, OSHC-të kanë shumë vështirësi me financimet dhe mbështetjen e kufizuar nga donatorët dhe shteti. Shumë OSHC ofronin shërbime dhe disa prej tyre vazhduan ta bënin këtë edhe gjatë krizës së emergjencës. Disa OSHC ofronin ende shërbime (aktivitete mësimore dhe argëtimi, mbështetje sociale dhe psikologjike, ndihmë me aplikimet për grante për strehim dhe procedura të tjera të ngjashme) në situatën pas rimëkëmbjes nga tërmeti, duke u gjendur kështu në një krizë të dyfishtë.

Kriza Covid-19 i vuri OSHC-të përballë sfidave të mëdha për sa i përket fondeve në dispozicion, vazhdimin të veprimtarisë së tyre, zbatimit të projekteve dhe praktikave të punës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Pas intervistave dhe diskutimeve në fokus grupe, tipari kryesor i përbashkët që u vu re është fakti se veprimi i parë që ndërmoren OSHC-të lidhej me trajtimin e sfidave të tyre të brendshme. Kjo u theksua nga shumë pjesëmarrës duke qenë se kryesorja ishte "*mungesa e informacionit dhe mungesa e kapaciteteve për t'u përshtatur me punën online*"¹¹³. Vështirësia financiare ishte sfida më e madhe, pasi gjendja e jashtëzakonshme ndikoi në qëndrueshmërinë e organizatave. Këto të fundit u përballën me vështirësi financiare për të mbuluar pagat dhe kostot rutinë administrative, duke vënë në rrezik edhe vazhdimësinë e punës dhe ekzistencës së tyre. Megjithatë, OSHC-të ia dolën të siguronin më shumë fleksibilitet

113 Intervistë me përfaqësues të OSHC-ve

nga donatorët, ku disa prej tyre morën edhe mbështetje institucionale.¹¹⁴

Po ashtu, OSHC-të e zhvendosën punën në sistemin online duke përdorur platforma të ndryshme për të komunikuar dhe bashkëpunuar me partnerët e tyre, grupet e synuara/përfituesit dhe për të vazhduar punën për aktivitetet dhe objektivat e projekteve të tyre të vazhdueshme. Së treti, OSHC-të gjetën mënyra novatore dhe alternative për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen për komunitetet në nevojë dhe grupet e tyre të synuara pavarësisht mbylljes totale të vendit dhe masave të tjera kufizuese. Për shembull, Rrjeti “Më mirë së bashku”¹¹⁵ u bë një platformë online për donacione, për mobilizimin e ndihmës, sigurimin e informacionit dhe aksesin të mbështetja dhe ndihma. Platforma është krijuar përmes bashkëpunimit të disa organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të ndryshimit. Shumë prej tyre ishin të përfshirë edhe në sigurimin e ndihmave gjatë periudhës së tërmetit 2019. Platforma virtuale, që funksiononte përmes Facebook-ut, operonte si një treg ku takoheshin kërkesa për mbështetje dhe oferta për mbështetje, me qëllimin kryesor kapërcimin e hendekut mes të djyave¹¹⁶. Kjo formë e vetë-organizimit përbën një hap cilësor në krahasim me mbështetjen e hapërdarë që u vu re gjatë tërmetit. OSHC-të kombëtare me më shumë përvojë kanë ndërmarrë nisma për të hulumtuar dhe përcaktuar ndikimin, veçanërisht të Covid-19, në sektorin e OSHC-ve, siç janë Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

Ndryshe nga situata e tërmetit, gjatë pandemisë OSHC-të nuk u përfshinë në përgjigje të koordinuara në nivel kombëtar për krizën dhe aq më pak në proceset e konsultimit apo vendimmarrjes dhe në organet për menaxhimin e krizës. Gjatë diskutimeve në fokus grupe dhe në seminarin e vlefësisimit, ky pretendim u konfirmua kur një pjesëmarrës deklaroi se *“Konsultimet nuk ekzistonin fare, veçanërisht me OSHC-të dhe grupet që punojnë me persona me aftësi të kufizuara. Aftësitë e kufizuara nuk u morën fare parasysh për konsultime gjatë pandemisë.”*¹¹⁷ Gjithsesi, OSHC-të kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në plotësimin e boshllëqeve dhe përgjigjen ndaj nevojave në rritje të qytetarëve, veçanërisht ndaj grupeve më të rrezikuara dhe të marginalizuara. Edhe pa iu njohur meritat apo pa mbështetje ekonomike nga qeveritë, OSHC-të kanë vërtetuar se ato mund të jenë një partner i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm për shtetin në kohë kaq të paprecedenta.¹¹⁸

114 “Support NPO Sector Adaptability to Covid-19 Emergency”, gjendet në adresën http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/04/Support_NPO_Sector_Adaptability_to_Covid-19_Emergency_Assessment_Report.pdf (aksesuar më 1 tetor 2020).

115 “Më mirë së bashku” [Better Together], është një platformë e pavarur e krijuar nga një grup profesionistësh dhe përfaqësuesish të organizatave të shoqërisë civile për të dhënë mbështetje dhe për të lehtësuar komunikimin gjatë periudhës së Covid-19. Ajo është ngritur në media sociale dhe gjendet këtu: <https://www.facebook.com/Me-Mire-Se-Bashku-103455144629539> (aksesuar më 17 tetor 2020).

116 “Më mirë së bashku”, platforma virtuale kundër pasojave sociale të COVID-19”, gjendet në adresën <https://www.reporter.al/me-mire-se-bashku-platforma-virtuale-kunder-pasojave-sociale-te-covid-19/> (aksesuar më 18 tetor 2020).

117 Koment nga një pjesëmarrës gjatë seminarit të vlefësisimit, tetor 2020.

118 “The State of CSOs, their Involvement in the Crisis Response& State and Donor Support”, gjendet në adresën <http://www.balkanccd.net/novo/wp-content/uploads/2020/05/78-6-Balkan-Civil-Society-in-the-COVID-19-Crisis-Part-II.pdf> (aksesuar më 1 tetor 2020).

Një nga problematikat që Covid-19 nxori në pah në nivel botëror ka qenë dhuna në familje, veçanërisht dhuna ndaj grave. OKB e ka përshkruar rritjen e rasteve të abuzimit në familje në mbarë botën si një “pandemi në hije” krahas Covid-19, me një rritje prej 20%.¹¹⁹

Një tendencë e tillë ka qenë e pranishme edhe në Shqipëri. Bazuar në këtë tendencë, OSHC-të kanë punuar ngushtësisht me këtë grup të synuar dhe janë mbështetur edhe nga UN Women. Sipas raportit të fundit nga projekti EVAW i UN Women, “*Dymbëdhjetë OSHC që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për gratë e mbijetuara të dhunës në familje në Durrës dhe Elbasan u mbështetën me 1,100 pajisje mbrojtëse. Kjo është me shumë rëndësi për OSHC-të që ofrojnë shërbime që të vazhdojnë punën e tyre në këtë drejtim me gratë në nevojë, përfshirë strehimin në qendra duke respektuar disa nga kërkesat kryesore të Protokollit të MSHMS-së për menaxhimin dhe funksionimin e qendrave gjatë pandemisë Covid-19.*”¹²⁰

Raportet nga OSHC-të dhe vëzhguesit tregojnë se kriza Covid-19 ka prekur veçanërisht grupet e cenueshme, në mënyrë të veçantë në zonat e thella.¹²¹ Ashtu si edhe me krizën e tërmetit, gjatë pandemisë shumë OSHC e kanë kaluar vëmendjen e tyre tek ofrimi i shërbimeve dhe ndihmës humanitare për komunitetet më të rrezikuara.¹²² Gjithsesi, siç theksoi edhe një pjesëmarrës në seminarin e vlefshimit, “*OSHC-të nuk mund të zëvendësojnë shtetin dhe nuk mund të veprojnë si qeveri paralele.*”¹²³

Sipas përgjigjeve nga të intervistuarit dhe diskutimet në fokus grupe, për sa i përket ndihmës me mbështetje të ofruar nga OSHC-të, gjatë muajve të mbylljes totale, ato mund të klasifikohen si më poshtë:

119 “Coronavirus: Domestic violence ‘increases globally during lockdown’”, gjendet në adresën BBC News <https://www.bbc.com/news/av/world-53014211> (aksesuar më 30 tetor 2020).

120 “Response to COVID-19 in Albania”, gjendet në adresën <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2020/06/un%20p%20evawia%20response%20to%20covid-19.pdf?la=en&vs=1654> (aksesuar më 30 tetor 2020).

121 Komisioni Evropian, Raporti Vjetor 2020, Shqipëria, p. 14 gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (aksesuar më 22 tetor 2020). p.35.

122 Pjesëmarrës në seminar vlefshimi, tetor 2020.

123 Po aty.

Figure 2: CSOs' responses during COVID-19

Mbështetje e dhënë nga organizatat vendore dhe komunitare	Mbështetje nga organizatat humanitare	Mbështetje nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare
<ul style="list-style-type: none"> • Rritje ndërgjegjësimit • Përhapje informacioni • Shpërndarje maskash në komunitet (p.sh., Youth in Charge Lezha) • Mbështetje psikologjike online (Më mirë së bashku) • Takime online me komunitetin, kryesisht në kuadër të projekteve në vazhdim të financuara nga donatorët 	<ul style="list-style-type: none"> • Bamirësi (p.sh., Fundjavë Ndryshe, Fondacioni Firdeus) • Donacione në fonde dhe në natyrë për grupet e marginalizuara (World Vision ka ofruar mbështetje edhe me mjete bujqësore për familjet në zonat rurale) • Mbështetje online dhe në terren (World Vision Albania) 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje ndërgjegjësimit • Hulumente dhe studime studies (Partners Shqipëri, FES) • Ngjarje të rrjetëzimit online • Përhapje e informacionit për nevojat nga komunitetet • Vlerësim i shpejtë dhe analiza (IDM)

Duke u mbështetur në këtë pikë të fundit, tipari i tretë ishte edhe pika e kthesës kur OSHC u angazhuan në aktivizmin online me seminare të vazhdueshme online, fushata online në mediat sociale dhe aktivitete të tjera rrjetëzimi online. Një gjë e tillë rriti edhe aktivizmin online në përpjekje për t'u lidhur me sa më shumë grupe të synuara dhe përfitues të tjerë nëpërmjet mjeteve të komunikimit online. Një shembull i një OSHC-je në Lezhë pohon se *“për sa i përket Covid-19, i kaluam të gjitha nismat e projekteve tona online. Për t'u dhënë të rinjve mesazhe pozitive, hapëm platformën “Si të” që ka të bëjë me një sërë historish frymëzuese online të disa të rinjve të suksesshëm.”*¹²⁴ Edhe organizata humanitare me përvojë, si World Vision Albania prezantuan programe të drejtpërdrejta ndihme. *“Dhamë mbështetje për familjet në nevojë me paketa ushqimore ose edhe asistencë me para cash, ku kjo formë e fundit u aplikua kryesisht për zonat rurale. U fokusuam edhe në fuqizimin ekonomik të familjeve rurale nëpërmjet ofrimit të mjeteve bujqësore.”*¹²⁵

Me vlerë të veçantë ishin edhe shërbimet e ofruara nga OJF që punojnë në sektorin e shëndetësisë, të cilat vazhduan të ofronin shërbime për të sëmurët me sëmundje kronike apo në kujdesin paliativ, të cilët nuk kishin mundësi të tjera për të marrë shërbime të tilla. Përfaqësuesit nga Qendra e Kujdesit Paliativ në Korçë i vunë theksin kushteve tejet të vështira ku punuan stafi mjekësor dhe të tjerë gjatë krizës Covid-19: *“Vazhduan t'u shërbenim pacientëve me kancer në fazën e fundit në shtëpitë e tyre duke marrë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse kundër Covid-19. Përveç kësaj, vumë një rritje të kërkesës për shërbimet tona shëndetësore në grupe të ndryshme duke pasur parasysh se spitalet trajtonin vetëm emergjencat, por në disa raste njerëzit kishin frikë të shkonin në spitale.”*¹²⁶

¹²⁴ Intervistë me përfaqësues të OSHC-së, shtator 2020.

¹²⁵ Intervistë me përfaqësues të OSHC-së, shtator 2020.

¹²⁶ Pjesëmarrës në fokus grupin me shoqërinë civile, tetor 2020.

Një tjetër përfaqësues nxori në pah edhe këshillimet online për pacientët me sëmundje kronike: “Kemi angazhuar mjekët e familjes dhe kemi organizuar seanca të vogla me Zoom me pacientët me sëmundje kronike ku u kemi dhënë këshilla për Covid-19, mjekimin e tyre dhe masat që duhen marrë.”¹²⁷ Këto OJP shfrytëzuan mjetet digjitale për të nisur projekte sociale novatore dhe për të forcuar lidhjet me komunitetet dhe grupet e tyre të synuara.

Kutia 17: Platforma të ndihmës online gjatë Covid-19

Më mirë së bashku <https://www.facebook.com/Me-Mire-Se-Bashku-103455144629539/>
Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët ALOe <https://www.alo116.al/>
Nuk je vetëm <http://www.nukjevetem.al>
Urdhri i Psikologut të Shqipërisë <https://www.urdhriipsikologut.al/covid-19/>
Shërbim ligjor online <https://juristionline.al/rreth-nismes-2/>, with the support of OSFA

Shumë OSHC i kanë vazhduar veprimtaritë e tyre në kuadër të përgjigjes ndaj krizës së shkaktuar nga Covid-19 duke ofruar shërbime dhe produkte të drejtpërdrejta për grupet e synuara të cilëve u shërbejnë, përfshirë këtu të rinjtë, gratë, personat me nevoja të veçanta, komunitetin rom, njerëzit që jetojnë në zonat rurale, ndërmarrjet sociale, komunitetet vendore, e të tjerë. Në Planin e Veprimit Covid-19 për Shqipërinë për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen kundër Covid-19, një nga masat e planifikuara është edhe “Përgatitja e organizatave joqeveritare për të ndihmuar në procesin e sigurimit shërbimeve sociale për popullatën” dhe OSHC janë përfshirë si një nga aktorët përgjegjës për zbatimin e kësaj mase, ndonëse nuk është parashikuar mbështetjet për to.¹²⁸

Për sa i përket vendimmarrjes për përgjigjen ndaj Covid-19, qeveria shqiptare ndërmoi një sërë hapash për t’u përgatitur për krizat.¹²⁹ Megjithatë, masat fillimisht ishin të centralizuara dhe u prezantuan nga Kryeministri përmes llogarisë së tij në rrjetet sociale dhe në kanalën ERTV. Qeveria nxori akte normative për të ndryshuar legjislacionin me qëllim zbatimin e masave kufizuese të Covid-19 duke anashkaluar procesin e vendimmarrjes përmes Parlamentit dhe duke kufizuar kryerjen e procedurave gjyqësore vetëm për rastet urgjente.¹³⁰ OSHC-të nuk u përfshinë në asnjë proces konsultimi apo organ të krijuar për menaxhimin

127 Pjesëmarrës në fokus grupin, OJP në Durrës.

128 “COVID-19 Plan Veprimi për Shqipërinë”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjendet në adresën https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf (aksuesuar më October 12, 2020).

“The State of CSOs, their Involvement in the Crisis Response & State and Donor Support”, gjendet në adresën <http://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2020/05/78-6-Balkan-Civil-Society-in-the-COVID-19-Crisis-Part-II.pdf> (aksuesuar më 1 tetor 2020).

129 Aktet normative, gjenden këtu <https://coronavirus.al/akte-ligjore/> (aksuesuar më 1 tetor 2020).

130 Qirjazi, R., & Dafa, A., (2020). “COVID-19 dhe sfida e Shqipërisë për qeverisje demokratike”, gjendet në adresën <https://idmalbania.org/tales-of-region-albania/> (aksuesuar më 17 tetor 2020)

e krizës.

Organizatat e shoqërisë civile nuk janë përfshirë në masat e mbështetjes ekonomike që ka ndërmarrë qeveria. Për sa i përket financimit publik, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, që nga data 17.03.2020, e ka pezulluar afatin përfundimtar për aplikimet të Thirrjet e Hapura për Propozime deri në një njoftim të dytë. Po ashtu, deri tani nuk ka asnjë veprim konkret të ndërmarrë në mbështetje të OSHC-ve. Ndonëse pjesa më e madhe e donatorëve janë treguar mirëkuptues dhe fleksibël për shtyrjen e afateve të aktiviteteve, ndryshimet në metodologji, ose riplanifikimi i aktiviteteve të planifikuara, mbështetja institucionale (pagat e personelit dhe kostot administrative) gjatë mbylljes së vendit kanë mbetur çështje e patrajtuar ende nga donatorët.¹³¹

Burimi kryesor i financimit janë projektet e vazhdueshme të financuara nga donatorët, ose në rastin e fondacioneve fondet e tyre të bamirësisë. Më vonë u dhanë fonde për të trajtuar sfidat e Covid-19. Donatorët reagues menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për shembull, në kuadër të projektit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, zbatuar nga një konsorcium prej tre organizatash (Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Co-PLAN dhe Partnerët Shqipëri), Lëviz Albania hapi një thirrje për një reagim të shpejtë se si të përgjigjemi situatës së krijuar nga Covid-19.

Kutia 18: Shembuj të fondeve të angazhuara për të trajtuar krizën e Covid-19

'Reagim i Shpejte'-Thirrje për aplikime ishte një thirrje e përcaktuar për Covid-19, ku u bëhej thirrje OSHC-ve të ndërmerrnin nisma për demokracinë vendore në kohën e pandemisë. https://www.levizalbania.al/images/LEVIZALBANIA_UDH%C3%8BZUESI_I_THIRRJES_REAGIMI_I_SHEPJTE_COVID19.pdf

Lëviz Albania ka përfshirë edhe temën e Covid-19 dhe demokracisë vendore në skemën e granteve strategjike (http://www.levizalbania.al/media/files/2020/09/09/Udh%C3%ABzuesi_i_Thirrjes_p%C3%ABr_Aplikime_-_Grante_Strategjike.pdf)

Për sa i përket lirive civile gjatë periudhës së pandemisë, vihet re se angazhimi qytetar vazhdon me OSHC-të dhe aktorë të tjerë që janë mobilizuar si online ashtu edhe në terren. Megjithatë, janë dokumentuar shkelje të së drejtës për të protestuar ndërkohë që masat tepër të gjera dhe të rrepta të qeverisë po kufizojnë të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe në rajon.¹³² Po ashtu, edhe në zonat e dëmtuara nga tërmeti, kanë qenë me rëndësi aktivizmi online dhe ndërmjetësimi

¹³¹ 'The State of CSOs, their Involvement in the Crisis Response& State and Donor Support', gjendet në adresën <http://www.balkanccd.net/novo/wp-content/uploads/2020/05/78-6-Balkan-Civil-Society-in-the-COVID-19-Crisis-Part-II.pdf> (aksesuar më 1 tetor 2020).

¹³² 'Civic freedoms and COVID-19 pandemic', gjendet në adresën <https://monitor.civicus.org/COVID-19Oct2020/> (aksesuar më 1 tetor 2020).

për informim. *"Kemi ndarë informacione me aktorët vendorë të bizneseve, apo ndërmjetës aktivë me komunitetin në Durrës. Një nga problematikat që doli gjatë pandemisë Covid-19 është fakti se autoritetet vendore pothuajse pezulluan shërbimet që nuk kanë lidhje me rindërtimin pas tërmetit. Gati të gjitha kapacitetet e administratës vendore janë fokusuar në rishikimin e rasteve dhe dosjeve të tërmetit,"*¹³³ - tha një nga të intervistuarit nga komuniteti vendor i Durrësit.

Në këtë kuadër, kriza Covid-19 ka nxjerrë në pah brishtësinë e proceseve demokratike shqiptare teksa sistemi i kontrolleve dhe ekuilibrave mbetet në situatë të pasigurt. Edhe para se të vendosej gjendja e jashtëzakonshme, kufizimi i lirive, ngërçet e proceseve politike, dobësimi i legjislaturës dhe mungesa e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë kanë sjellë si rezultat daljen jashtë kontrollit të degës ekzekutive në përgjithësi¹³⁴. Raporti i Freedom House 2020 për Shqipërinë vëren se *"Vlerësimi i Qeverisjes Demokratike Kombëtare në Shqipëri ra nga 3.50 në 3.25 për shkak të një serie krizash që prekin institucionet qeverisëse të Shqipërisë, përfshirë këtu dorëheqjen në bllok të opozitës parlamentare, një procedurë hetimi ndaj presidentit dhe përplasjet mes gjykatave dhe parlamentit ."*¹³⁵ Pandemia u instrumentalizua nga qeveria për të zgjeruar më tej kompetencat e saj ekzekutive gjatë krizës së vazhdueshme politike. Aktet normative dhe proceset e përshpejtuara legjislative u bënë *modus operandi* i Qeverisë për të ndryshuar legjislacionin. Si rezultat, aktorët e shoqërisë civile u antagonizuan nga procesi i vendimmarrjes pa asnjë proces efikas konsultimi gjatë pandemisë. Raporti i fundit për Shoqërinë Civile dhe Covid-19 në Ballkanin Perëndimor i "Rrjetit 'Mendo për Evropën'"¹³⁶ evidenton përpjekjet e OSHC-ve në Shqipëri për të kufizuar rolin e fuqizuar në mënyrë disproporcionale të ekzekutivit, por pothuajse pa asnjë sukses. Dy shembuj të rëndësishëm këtu janë:

- ▶ Qeveria nuk mori parasysh një letër të OSHC-ve në Shqipëri ku kritikoheshin ndryshimet në Kodin Penal, ndryshime që synonin ndëshkimin me deri në 15 vjet heqje lirie për personat që thyenin kufizimet e karantinës, si ndëshkim jo në raport të drejtë me shkëlqen dhe një fyerje për dinjitetin e njeriut. Dispozitat anti-karantinë gjatë gjendjes së emergjencës për shkak të Covid-19 të përcaktuar në Kodin Penal i dhanë mundësi policisë të arrestonte disa aktivistë të shoqërisë civile që protestonin në Sheshin Skënderbej.
- ▶ Ndërkohë që vendi ishte në gjendje të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë Covid-19, më 17 maj u shkatërrua Teatri Kombëtar. Disa aktorë dhe aktivistë, të cilët kishin zënë ndërtesën për të parandaluar prishjen e saj, u nxorën me forcë nga policia dhe u arrestuan prej saj. Protestat vazhduan gjatë gjithë ditës dhe keqtrajtimet

¹³³ Intervistë me përfaqësues të OSHC-së, shtator 2020.

¹³⁴ Dyrmishi, Arjan. (2020) Kreu për Shqipërinë, "Demokracia dhe gjendja e emergjencës", gjendet në adresën <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16286.pdf> aksesuar më 17 tetor 2020), p. 6.

¹³⁵ Vurmo, Gjergji (2020). "Kombet në Tranzit: Albania 2020", gjendet në adresën <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020> (aksesuar më 23 tetor 2020).

¹³⁶ "The Western Balkan and COVID-19: Effects on Rule of Law, Good Governance and Civil Society", gjendet në adresën <https://www.thinkforeurope.org/wp-content/uploads/2020/07/The-Western-Balkans-and-the-COVID-19-Effects-on-good-governance-rule-of-law-and-civil-society.pdf> (aksesuar më 1 tetor 2020).

e protestuesve paqësorë nga policia ishin të zakonshme. Pas shembjes, grupe të shoqërisë civile, aktivistë, qytetarë dhe të rinj protestuan kundër shembjes së ndërtesës së teatrit dhe përdorimit të dhunës nga policia. Në veçanti, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, e krijuar për të kundërshtuar vendimin e qeverisë për prishjen e ndërtesës, organizoi tubime në disa qytete për të mbledhur nënshkrime për një peticion për të rindërtuar Teatrin Kombëtar sipas modelit të tij original. Aleanca ngriti padi penale kundër Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.¹³⁷

Ndryshimi i Ligjit për Parandalimin e Sëmundjeve Infektive përmes një akti normativ dhe miratimi i ndryshimeve të Kodit Penal përmes një procedure të përshpejtuar parlamentare të bëjnë të besosh se qeveria ka shfrytëzuar kushtet e pandemisë dhe krizën e vazhdueshme institucionale dhe kushtetuese për të zgjeruar më tej pushteti ekzekutiv. Aktet normative dhe procedurat e përshpejtuara legjislative janë bërë metodë pune e qeverisë për të ndryshuar legjislatcionin me deklarata nga ministra apo kryeministri që shkojnë më parë publikohen në media dhe më vonë miratohen në Kuvend. Raporti Special i Freedom House për Demokracinë në Shtetrrëthim nxjerr në pah se Shqipëria u qeveris me një “grusht të hekurt”¹³⁸, duke theksuar se një nga sfidat më të mëdha për demokracinë në Shqipëri ishte anashkalimi i çdo procesi demokratik dhe fakti që qeveria qeveris me dekrete që ndryshonin çdo ditë.¹³⁹ Të njëjtat raporte evidentojnë se tubimet dhe protestat ishin të ndaluara dhe se kishte raste kur njerëzit hetoheshin për postimet e tyre në Facebook. Po ashtu, kishte probleme me aksesin në informacion dhe me transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë ndaj qytetarëve dhe mediave.¹⁴⁰

Për më tepër, të tjerë argumentojnë se qeveria përdori pandeminë si justifikim për të dhënë kontrata emergjente për të ashtuquajturit oligarkë pranë qeverisë dhe për të forcuar pozicionin e saj duke rritur frikën dhe duke ekzagjeruar kërcënimin nga virusi që të dukej si shpëtimtarja e njerëzve në “luftën kundër armikut të padukshëm” që ka qenë edhe mesazhi mbizotërues i dhënë nga qeveria¹⁴¹. Këto veprime kanë anashkaluar sektorin e shoqërisë civile shqiptare nga procesi i vendimmarrjes duke mos kryer procesin e konsultimit publik.¹⁴² Ndikimi i Covid-19 në rolin e shoqërisë civile në proceset demokratike dhe përkeqësimi i demokracisë në Shqipëri në vitin 2019 tregojnë për një rritje të autoritarizmit dhe një sistem jofunksional të mekanizmave për të kontrolluar dhe ekuilibruar

137 Dyrmishi, Arjan. (2020) Kreu për Shqipërinë, “Demokracia dhe gjendja e emergjencës”, gjendet në adresën <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16286.pdf> aksesuar më 17 tetor 2020). p. 7.

138 Taylor, A., (2020). “Albanian Government ‘Ruled with an Iron Fist’ During COVID-19”, gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/10/03/albanian-government-ruled-with-an-iron-fist-during-covid-19/> (aksesuar më 30 tetor 2020).

139 Freedom House, 2020, Democracy under Lockdown, gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/10/03/albanian-government-ruled-with-an-iron-fist-during-covid-19/> (aksesuar më 30 tetor 2020).

140 Po aty.

141 Reporter.al Article as quoted in Dyrmishi, Arjan. (2020) Chapter on Albania, “Democracy and the state of emergency”, gjendet në adresën <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16286.pdf> aksesuar më 17 tetor 2020).

142 Qirjazi, R., & Dafa, Al., (2020). “COVID-19 dhe sfida e Shqipërisë për qeverisje demokratike”, gjendet në adresën <https://idmalbania.org/tales-of-region-albania/> (aksesuar më 17 tetor 2020).

kompetencat e qeverisë.¹⁴³

143 Vurmo, Gjergji (2020). "Kombet në Transit: Shqipëria 2020", gjendet në adresën <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020> (aksesuar më October 23, 2020).

Tabela 17: Karakteristikat kryesore të rolit të shoqërisë civile në pandeminë Covid-19 në Shqipëri

Arritjet	Sfidat
<p>1. Sektori, edhe pse me vështirësi, ia doli të kalonte online pjesën më të madhe të punës dhe të përshtatej me “punën nga shtëpia”.</p>	<p>1. OSHC-të në nivel vendor kanë më pak mundësi për të përdorur mjete pune online dhe, në fillim, hasën vështirësi të brendshme për sa i përket aftësive në përdorimin e teknologjisë së informacionit.</p>
<p>2. Projektet vazhduan online dhe donatorët në përgjithësi i pranuan ndryshime financiare. OSHC-të kanë përdorur mënyra alternative funksionimi dhe pune me grupet e synuara dhe aktorët kryesorë duke përdorur mundësitë e ofruara nga mjetet dixhitale.</p>	<p>2. Ndikimi i projektit nuk ishte ai që ishte parashikuar, pasi disa nga grupet e synuara nuk mund të arriheshin dot dhe nuk kishin të njëjtin nivel efekti, si operacione fizike apo ato në terren. Kjo u vu re më së shumti për OSHC-të vendore dhe të vogla që veprojnë kryesisht me projekte të financuara nga donatorë, ndonëse ato ia dolën të mobilizonin vullnetarë në ndihmë të komunitetit të tyre (me mbështetje online apo me shpërndarje maskash).</p>
<p>3. OSHC-të ofruan mbështetje në shtëpi, në komunitete dhe online dhe ndërmorën nisma të reja për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike, në kujdesin paliativ dhe të tjerët (si p.sh., Qendra e Kujdesit Paliativ).</p>	<p>3. Në zonat e prekura nga tërmeti (Durrës dhe Lezhë), Covid-19 u mbulua nga OSHC-të me ndihma të drejtpërdrejta, duke qenë se këshillat bashkiakë kanë ende në planin e tyre të punës rindërtimin duke lënë mënjatë sektorët e tjerë.</p>
<p>4. Organizatat humanitare ofruan mbështetje emergjence dhe po zbatojnë edhe programe të periudhës së pas-rimëkëmbjes (p.sh., Partnerë Shqipëri – fuqizimi i OSHC-ve vendore dhe World Vision Shqipëri – ndihmë financiare dhe psikologjike për fëmijët).</p>	<p>4. Mungesa e një zyre të vetme për menaxhimin e emergjencave dhe për informim për të ofruar informacion të saktë dhe për të qenë burimi kryesor i informacionit që koordinon, kontrollon dhe ofron informacione dhe të dhëna të sakta.</p>
<p>5. U vunë re forma të ndryshme aktivizmi veçanërisht për sa i përket prishjes së ndërtesës së Teatrit Kombëtar.</p>	<p>5. Rol i kufizuar i OSHC-ve për t'i kërkuar llogari qeverisë.</p>

5.2.2 MEDIA DHE COVID-19

Covid-19 plotëson serinë aktuale të krizave në Shqipëri: krizën social-ekonomike të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, krizën e përgjithshme ekonomike dhe nivelin e lartë të papunësisë dhe krizën e thellë institucionale dhe politike të trashëguar nga viti i kaluar. Në këtë kuptim, situata e krijuar nga Covid-19 përkeqësoi edhe më shumë krizën politike që kërcënon të drejtat dhe liritë e njeriut, lirinë e medias, dhe pavarësinë dhe që shton perspektivat për një krizë edhe më të madhe ekonomike. Qeveria shqiptare njoftoi tërheqjen nga disa detyrime sipas neneve të caktuara të Konventës për Mbrojtjen e Lirive Themelore të Njeriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.¹⁴⁴ Qeveria e anuloi tërheqjen nga detyrimi pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme në 24 qershor 2020.¹⁴⁵

Kutia 19: Sfidat ndaj lirisë së medias gjatë periudhës së Covid-19

Sfidat në krizën e Covid-19 për sa i përket lirisë dhe sigurisë:

- ▶ Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë ndaj gazetarëve dhe stafit të medias gjatë raportimit nga terreni. Njohuri të pakta, dhe mangësi në infrastrukturë e procedura për mënyrën e raportimit në kohë pandemie, për të mbrojtur veten dhe të tjetër si dhe mungesë udhëzimesh për etikën.
- ▶ Klimë pasigurie, frikësimi dhe presionesh ndaj gazetarëve me një trend të qartë të rënies së lirisë së medias
- ▶ Tkurrje të hapësirës së mediave kritike dhe të pavarura.

Sfidat në krizën e Covid-19 për sa i përket operacioneve të medias:

- ▶ Nevojë në rritje për informacion të saktë dhe të besueshëm nga media
- ▶ Qeveria dhe kryeministri si të vetmit burim informacioni dhe në disa raste prodhoni edhe vetë lajme të rreme
- ▶ Lajmet e rreme, disinformimi dhe teoritë konspirative vazhdojnë të përhapen dhe sqarohen dhe verifikohen shumë pak

Sfidat në krizën e Covid-19 për sa i përket situatës financiare të medias:

- ▶ Rënie e reklamave, që do të thotë rënie e të ardhurave duke pasur parasysh se reklamat janë një burim i rëndësishëm të ardhurash
- ▶ Rrezik për qëndrueshmërinë financiare, veçanërisht për mediat e vogla për shkak të rënies së të ardhurave dhe vështirësive për të administruar “biznesin si zakonisht”
- ▶ Gazetat nuk shtypen më dhe botohet vetëm versioni i tyre online.

¹⁴⁴ European Commission, Annual Report Albania, 2020, gjendet në adresën https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf (aksesuar më 17 tetor 2020).

¹⁴⁵ Notification to Council of Europe, gjendet në adresën <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations> (aksesuar më 17 tetor 2020).

Sfidat në krizën e Covid-19 për sa i përket aspektit të kërkesës:

- ▶ Nevoja për informacion të sakët dhe të besueshëm dhe për ekspertizë
- ▶ Cilësi më e mirë e gazetarisë online
- ▶ Më shumë transparencë dhe llogaridhënie

**Thomson Foundation assessment on media and COVID-19 in Albania and Western Balkans.

Media po minohet nga qeveria, veçanërisht nga Kryeministri Rama, i cili përdor kanalet e tij personale të mediave (ERTV) dhe platformat e mediave sociale (kryesisht Facebook) për të komunikuar drejtpërsëdrejti me publikun për vendimet dhe masat e marra. Që në ditën e parë të mbylljes së vendit, ai i kërkoi me ngulm popullit të qëndronte në shtëpi, të respektonte masat e higjienës personale dhe distancimit fizik duke shtuar: “mbrohuni nga media!”¹⁴⁶. Kjo është në vazhden e denigrimit të medias prej tij duke i quajtur “kazan”. Organizatat e mediave dhe të drejtave të njeriut e kanë kritikuar qeverinë për monopolizimin e informacionit.

Mediat e shkruara kanë vuajtur më shumë nga kufizimet e imponuara nga Covid-19: gjatë muajve mars dhe prill 2020 pati një pezullim total të shtypit dhe të gjitha gazetat dhe revistat u botuan vetëm online. Edhe spektaklet në TV u anuluan për shkak të rregullave të reja që nuk lejonin më shumë se dy persona në një sallë, duke i bërë të pamundura prodhimet e drejtpërdrejta apo edhe ato të regjistruara¹⁴⁷. Raportimi nga terreni po bëhej edhe më i vështirë. Gazetarëve u mungonin njohuritë dhe procedurat transparente për të raportuar gjatë pandemisë dhe për të mbrojtur veten dhe njerëzit me të cilët punonin dhe takonin kur raportonin nga terreni për Covid-19¹⁴⁸. Gazetarët u ankuan se kishin marrë gjysmën e pagës ose nuk kishin marrë pagë fare. Mediat online duket se po ecnin më mirë në këtë drejtim, por është e vështirë të vlerësohet, sepse është shumë e parregulluar.

Kutia 20: Shembuj të fushatave të medias për rritjen e ndërgjegjësimit

**UNDP + A2 CNN - Distancë sociale – asgjë personale (Campaign)
Top Channel, Hipokrati - Ndërgjegjësimi social**

EuroNews Albania, Ndërgjegjësim me video mesazhe nga gazetarët, reporterët dhe folësit e lajmeve

146 Bino, B., (2020) “Midis dy zjarreve: Media në kohën e COVID-19,” gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/05/10/caught-between-two-fires-albanian-media-in-time-of-coronavirus/> (aksesuar më 25 shtator 2020).

147 Po aty.

148 Reporter.al, 2020 – <https://www.reporter.al/kriza-e-koronavirusit-trondit-edhe-industrine-e-medi-as-ne-shqiperi/> (aksesuar më 20 gusht 2020).

Informacioni i saktë dhe i besueshëm ishte edhe më i rëndësishëm gjatë mbylljes totale të vendit të imponuar nga kriza Covid-19, ku dhe media pritej të luante një rol vendimtar. Megjithatë, në Shqipëri mediat e pavarura u dobësuan për shkak të presionit të vazhdueshëm nga qeveria dhe sulmet personale nga Kryeministri si dhe të një rënie të përgjithshme të demokracisë.¹⁴⁹ Shqipëria nuk është immune ndaj lajmeve të rreme, disinformimit dhe teorive konspirative. Për sa i përket pandemisë, qarkulluan shumë lajme të rreme dhe disinformime në lidhje me kurat dhe mjekimet që të mbronin nga Covid-19 apo, në rastin kur përballeshe me virusin, të ofronin mbrojtje efikase. Gjatë muajit shkurt, u shpërnda një mesazh zanor në Whatsapp ku thuhej se kishte më shumë se 12 raste të regjistruara në javë dhe që këshillonte të shmangeshin vendet e populluara, kontaktet, etj.¹⁵⁰ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i hodhi poshtë këto lajme. Po ashtu, në Whatsapp kanë qarkulluar në anglisht dhe shqip disa protokolle shëndetësore.

Kutia 21: Kryeministri dhe lajmet e rreme

Kryeministri Rama nuk ia doli dot të shmangte lajmet e rreme dhe disinformimin për sa i përket Covid-19. Rasti i parë u regjistrua përhapja e qëllimshme e një videoje ku disa policë po përdornin dhunë në rrugë, me titrat që i referoheshin Spanjës. Më vonë opozita vërtetoi se videoja ishte e shkëputur nga një protestë antiqeveritare në Algjeri. (<https://abcnews.al/rama-fake-news-me-videon-nga-spanja-pd-po-perhap-panik-per-covid-19/>).

Rastet e disinformimit nga Kryeministri Rama vazhduan me përhapjen e lajmeve të rreme për numrin e vdekjeve të regjistruara në Suedi, duke thënë se “Suedia ka numrin më të lartë të vdekjeve për 1 milionë banorë, ndërkohë që sipas WordlMeters, më 1 qershor, Suedia regjistronte 3,353 vdekje për 1 milionë banorë” (<https://faktoje.al/te-pavertetat-e-kryeministrit-rama-ne-komunikimin-per-vijimin-e-fazes-ii-te-hapjes-si-pasoje-e-covid-19/>).

Lajme të tjera të rreme por që provokonin më pak panin janë ndarë në mediat sociale nga profili i Kryeministrit, si fakti historik për origjinën e karantinës (<https://www.faktor.al/2020/04/13/rama-perseri-shperndan-fake-news-tani-per-karantinën/>).

Ndërsa COVID-19 krijoi disa kufizime të udhëtimit për shtetasit shqiptarë, çështja

149 Për shembull, shih Rüttershoff, T., (2020). “Albania: Autocratic Measures in the Shadows of Corona”, Konrad Adenauer Stiftung, gjendet në adresën <https://www.kas.de/en/country-reports/detail/-/content/albania-autocratic-measures-in-the-shadows-of-corona> (aksesuar më 17 tetor 2020).

Qirjazi, R., & Dafa, Al., (2020). “COVID-19 dhe sfida e Shqipërisë për qeverisje demokratike”, gjendet në adresën <https://idmalbania.org/tales-of-region-albania/> (aksesuar më 17 tetor 2020).

150 Artikulli gjendet në adresën https://shqiptarja.com/lajm/koronavirusi-ministria-e-shendetesisë-mos-i-konsideroni-informacionet-ne-rruge-jo-zyrtare-nuk-ka-asnje-rast-ne-shqiperi?r=read_more (aksesuar më 2 tetor 2020).

e vonesave të kontrollit të kufirit shqiptaro-grek gjithashtu u bë pjesë e lajmeve të rreme të shpërndara në mediat sociale, me Kryeministrin që postoi një foto të kufirit Greko-Bullgar. (<https://faktoje.al/kryeministri-edi-rama-bie-serisht-ne-kurthin-e-dezinformimit/>).

Shumica e fakteve të rreme të ndara nga kryeministri janë kontrolluar nga Faktoje. AI, e cila është një OJQ që kontrollon faktet në Shqipëri, një zhvillim mikpritës në peisazhin e mediave.

Kryeministri Rama kërkoi falje për shpërndarjen e videos me mesazhin e gabuar në të. Ai deklaroi se lajmi i rremë ishte prodhuar pa dashje dhe se ai konfirmoi më vonë se imazhet ishin ato të Algjerisë, në vend të Spanjës gjatë COVID-19. (<https://www.reporter.al/kryeministri-edi-rama-kerkon-ndjese-pasi-kapet-duke-prodhuar-fake-news/>).

Mediat sociale ishin platforma kryesore për përhapjen e disinformimit. Në muajt e parë të pandemisë, disinformimi për Covid-19 bënte kërdinë, veçanërisht në Facebook.¹⁵¹ Një pjesë e disinformimit lidhej me BE-në, e cila supozohej se nuk ishte gati për t'u përballur me krizën e koronavirusit apo për të ndihmuar shtetet e saj anëtare. Është vënë re që janë përhapur edhe kura të rreme për koronavirusin. Pretendohej se Covid-19 mund të trajtohej me hudhra apo alkool dhe qarkullonin edhe thashetheme se është gjetur vaksina për këtë sëmundje. Një tjetër lajm i rremë ishte ai i trajtimit të koronavirusit duke përdorur zbardhues rrobash apo alkool i pastër.¹⁵² Në një raport të fundit të Reporterit konstatohet se *“lajmet e rreme dhe disinformimi për Covid-19 bëheshin virale dhe përhapeshin në mediat sociale, duke bërë që të kishin më shumë klikime sesa postimet nga gazetat dhe televizionet më të mëdha në vend.”*¹⁵³

Një lajm kryesor mediatik ishte edhe mohimi i Covid-19 dhe teoria konspirative për të që u përdorur si eksperiment te njerëzit. Teoritë e tjera lidheshin në mënyrë të veçantë me vaksinën kundër Covid-19, që konsiderohej si instrument për të kontrolluar qytetarët duke u futur një çip në trup¹⁵⁴. Raporti, që citon ekspertë të medias, ngre shqetësimin se shumë media, megjithëse ishin të vetëdijshme për rreziqet e Covid-19, i kanë bërë jehonë dhe e kanë shpërndarë këtë lajm të

151 Preci, Z., (2020). "Albania", in "The Shrinking Space for Media Freedom in Southeast Europe", CDC and KAS, 2020.

152 Hasanaliaj, I. "Lajmet e rreme që qarkulluan më shumë për COVID-19". Faktoje.al, 2 prill 2020.

153 Likmeta, B., (2020). "Si u bënë virale lajmet e rreme për pandeminë e Covid-19 në Shqipëri", gjendet në adresën <https://www.reporter.al/si-u-bene-virale-lajmet-e-rreme-per-pandemine-e-covid-19-ne-shqiperi/> (aksesuar më 22 tetor 2020).

154 "The Suspicious Virus: Conspiracies and COVID19 in the Balkans", available at <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2020/12/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf> (Accessed December 22, 2020).

rremë me tituj bombastikë, për të marrë sa më shumë vëmendje dhe klikime¹⁵⁵. Në panoramën e mediave shqiptare, koronavirusi u bë karrem i përsosur për klikime online, sepse lidhej drejtpërsëdrejti me pasigurinë dhe frikën e njerëzve. Pjesa më e madhe e informacioneve disinformuese përktheheshin nga burime të huaja, por një pjesë e tyre prodhohej edhe në Shqipëri¹⁵⁶. Shpesh disinformimi dhe lajmet e rreme ushqeheshin nga informacionet kontradiktore dhe të paqarta që jepeshin nga autoritetet publike.¹⁵⁷

E gjitha kjo shton edhe më shumë ndjenjën e pasigurisë, paragjyqimeve dhe ankthit për situatat e tashme dhe të ardhshme. Me justifikimin për të luftuar "armikun e padukshëm" të gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të Covid-19, qeveria shqiptare mbajti një qëndrim të ashpër ndaj lajmeve të rreme dhe disinformimit për koronavirusin, gjë që ka çuar në goditje të mediave të pavarura. Qeveria e imponoi veten si i vetmi burim informacioni, gjë që u komunikua drejtpërsëdrejti edhe nga Kryeministri¹⁵⁸. Kjo kontribuon në gërryerjen e besimit të shoqërisë tek institucionet dhe media¹⁵⁹. Masmediat nuk kishin asnjë mënyrë për të monitoruar apo verifikuar të vërtetën në lidhje me pasojat shëndetësore të pandemisë përtëj shifrave zyrtare që u ishin dhënë¹⁶⁰. Nuk është kryer asnjë investigim i mirëfilltë për reagimin e qeverisë ndaj krizës dhe të kapaciteteve të saj institucionale dhe teknike¹⁶¹. Gjithsesi, pas prishjes së Teatrit Kombëtar, mund të vihet re rritje e kritikave dhe aktivizmit, si online ashtu edhe në terren, me ndryshimin e qëndrimeve ndaj Qeverisë.¹⁶²

155 Likmeta, B., (2020). "Si u bënë virale lajmet e rreme për pandeminë e Covid-19 në Shqipëri", gjendet në adresën <https://www.reporter.al/si-u-bene-virale-lajmet-e-rreme-per-pandemine-e-covid-19-ne-shqiperi/> (aksesuar më 22 tetor 2020).

156 Rasti i Sazan Gurit që pretendonte se shërbimet funerale paguanin para që familjarët e të vdekurve të deklaroronin se i afërmi i tyre e kishte humbur jetën si pacient i Covid-19

157 Likmeta, B., (2020). "How the fake news about the COVID-19 pandemic in Albania went viral", available at <https://www.reporter.al/si-u-bene-virale-lajmet-e-rreme-per-pandemine-e-covid-19-ne-shqiperi/> (Accessed October 22, 2020).

158 Shembuj ku Kryeministri Edi Rama komunikon nëpërmjet ERTV, statuseve me mesazhe apo video në Facebook vendimet e qeverisë për trajtimin e situatës në muajt mars dhe prill duke filluar nga oraret e dyqaneve që qytetarët të bënin pazar deri masat e ndihmës për bizneset. Shih Maksimović, S., (2020). "Western Balkans media during COVID-19: Reporting on corruption became even harder", gjendet në adresën <https://europeanwesternbalkans.com/2020/05/08/western-balkans-media-during-covid-19-reporting-on-corruption-became-even-harder/> (aksesuar më 17 tetor 2020).

Po aty. p.

159 Vrutgman, L., & Bino, B., (2020). Besimi në qeverisje – Sondazhi i Opinioneve 2019. Tirana: IDM, gjendet në adresën [UNDP Albania](https://www.undp.org/albania).

160 Preci, Z., (2020). "Albania", in "The Shrinking Space for Media Freedom in Southeast Europe", CDC and KAS, 2020.

161 Qirjazi, R., & Dafa, Al., (2020). "COVID-19 dhe sfida e Shqipërisë për qeverisje demokratike", gjendet në adresën <https://idmalbania.org/tales-of-region-albania/> (aksesuar më 17 tetor 2020).

162 Pjesëmarrës në diskutimet në fokus grupe.

Tabela 18: Raportimi nga media i pandemisë Covid-19

Faza e fatkeqësisë	Këndvështrimi	Tema/Mesazhi	Pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e mediave	Lloji i raportimit
Shpërthimi i Covid-19 (mars 2020)	Frika nga nga "armiku i padukshëm"	Rreziku serioz nga virusi	Prani e kufizuar e drejtpërdrejtë nëpërmjet citimeve dhe dëshmime	Lajmet kryesore Titujt kryesorë Edicionet speciale
	Interesi për njerëzit	Roli i qeverisë dhe uniteti në trajtimin e krizës		
	Shëndeti dhe siguria publike	Histori njerëzore të njerëzve të infektuar	Raportim i kufizuar i drejtpërdrejtë nga qytetarë për shkak të distancimit social	
	Qeveria si shpëtimtare	Dhënia e informacionit paraprak të dobishëm në lidhje me masat		
	Rritja e ndërgjegjësimit	Dëgjimi i mendimit të ekspertëve të shëndetit publik, zyrtarëve të qeverisë dhe mjekëve	Përbajtje e krijuar nga qytetarë, veçanërisht në mediat online	
Mbyllja e vendit (prill – mesi i muajit maj 2020)	Frika nga "armiku i padukshëm"	Rreziku serioz nga virusi	Prani e kufizuar e drejtpërdrejtë nëpërmjet citimeve dhe dëshmime	Lajmet kryesore Titujt kryesorë Edicionet speciale
	Interesi për njerëzit	Histori njerëzore të njerëzve të infektuar dhe fokusi në numrin e viktimave/tek historitë nga Italia		
	Vdekjet dhe e ardhmja e paparashikueshme	Përplasje politike për veprimet e qeverisë	Raportim i kufizuar i drejtpërdrejtë nga qytetarë për shkak të distancimit social	
	Ndikimi	Dëgjimi i mendimit të ekspertëve të shëndetit publik, zyrtarëve të qeverisë dhe opozitës	Përbajtje e krijuar nga qytetarë, veçanërisht në mediat online	
	Rritja e ndërgjegjësimit			
	Kritika për veprimet e qeverisë	Solidaritet, donacione dhe dhënie asistence e ndihme		
Rihapja dhe fundi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore (mesi i majit– 23 qershor 2020)	Ndikimi dhe rimëkëmbja	Vlerësim kritik i situatës: shkaqet, ndikimi dhe pasojat	Prani e kufizuar	Më pak tituj kryesorë Lajmet kryesore
	Rritja e ndërgjegjësimit	Masat e ndihmës nga qeveria	Zyrtarët e qeverisë dhe politikanët rimarrin vëmendjen kryesore	Lajmet sociale, Lajmet ekonomike Lajmet politike
	Kritika për veprimet e qeverisë	Planet gjatë verës	Ekspertët mbeten të pranishëm	
	Interesi për njerëzit	Dëgjimi i mendimit të ekspertëve të shëndetit publik, zyrtarëve të qeverisë dhe mjekëve, dhe opozitës		

Raportimi nga media për Covid-19 ishte në formën e alarmit dhe sensacionit, që fokusohet në skenarët më të këqij dhe me gjuhë të ngarkuar emocionale, si virusi vdekjeprurës, armiku i padukshëm, e ardhmja është në rrezik. Buja e fillimit shoqërohet me mesazhe alarmuese ndonëse më vonë u vu re një ton më neutral që fokusohen më shumë në dhënien e informacionit. Gjatë pandemisë u vunë re shumë pak raste të medias në rolin e vëzhguesit.

Tabela 19: Roli i medias sociale gjatë pandemisë Covid-19

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi në praktikë
Para katastrofës	Zbutja	Mungesë e aktiviteteve të konsiderueshme për reduktimin e riskut dhe për masat parandaluese në fushën e mediave sociale.	Limited efforts for disaster risk reduction
Para katastrofës	Përgatitja	Nuk pati strategji specifike për komunikimit të krizës para marsit 2020 dhe nuk i kushtua vëmendje e veçantë informacionit dhe të dhënave shkencore në lidhje me epideminë dhe pandeminë.	Limited efforts for disaster risk reduction. No early warning

Faza e katastrofës	Faza e menaxhimit të katastrofës	Roli i medias sociale	Implikimi në praktikë
Katastrofa	Përgjigja	<p>Media sociale ishte jetike me raportimin e lajmeve për shpërthimin e pandemisë Covid-19. Postimet, ripostimet dhe rindarja e analizave, komenteve, paralajmërimeve dhe përmbytjeve të tjera ishin masive. Ishte i pranishëm edhe paniku që përhapej me komente, postime, dhe përmbytje të pavërtetë, ku lajmet e re me bëheshin virale.</p> <p>Mediat sociale shërbyen edhe për të mbushur boshllëkun e informacionit, të shkaktuar nga autoritetet duke përdorur burime alternative informacioni. Gjithsesi, kjo gjë nxori në pah të metat e veta për sa i përket cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit.</p> <p>Mediat sociale u përdorën edhe nga OSHC-të për rritjen e ndërgjegjësimit, koordinimin dhe dhënien e mbështetjes për grupe të ndryshme.</p> <p>Mediat sociale u përdorën edhe për të denoncuar abuzimet dhe shpërdorimet, edhe kur kjo gjë raportohej nga gazetarë profesionistë.</p> <p>Mediat sociale u shërbyen edhe autoriteteve publike, si Kryeministrisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të përçuar mesazhet dhe informacionet zyrtare, duke vepruar kështu më shpejt se mediat standarde.</p>	<p>Përhapje informacioni</p> <p>Ishin të pranishme përhapja e panikut dhe lajmeve të re me</p>
Pas katastrofës	Rimëkëmbja	<p>Në këtë fazë, mediat sociale, veçanërisht Facebook, që është edhe më e përdorura, u përdor gjerësisht për të zhvilluar fushata ndërgjegjësimi. Mediat sociale shërbyen edhe për të përhapur mesazhet për sigurinë e shëndetit publik dhe distancimin social dhe fizik.</p>	<p>Përhapje informacioni</p>

Raporti Special i Freedom House për demokracinë gjatë mbylljes totale të vendit vëren se medias së pavarur shpesh i mbyllet zëri gjatë pandemisë, duke e bërë të vështirë kërkesën e llogarisë dhe duke penguar përhapjen e informacionit të rëndësishëm. Raporti evidenton se vendet e renditura si pjesërisht të lira (si Shqipëria) përjetuan kufizime ndaj mediave të lajmeve si pjesë e përgjigjes ndaj shpërthimit të koronavirusit¹⁶³. Raporte të ndryshme¹⁶⁴ nxjerrin në pah një rritje në përvetësimin e pushtetit në Shqipëri, një trend tashmë i konsoliduar para krizës. Kriza Covid-19 i dha Kryeministrit Rama mundësinë për të marrë një rol më të rëndësishëm politik dhe institucional personalisht¹⁶⁵. Në një studim të kohëve të fundit nga Qendra për Studimin e Demokracisë për ndikimin e Covid-19 tek mediat në Evropën Juglindore konfirmohet se *"kriza Coronavirus ka nxjerrë në pah deficitet e vazhdueshme të qeverisjes, gjë që ka kufizuar efektivitetin e përgjigjeve të politikës dhe është shfrytëzuar për prezantimin e masave që kufizojnë liritë themelore."*¹⁶⁶

163 Freedom House, 2020, Democracy under Lockdown, gjendet në adresën <https://exit.al/en/2020/10/03/albanian-government-ruled-with-an-iron-fist-during-covid-19/> (aksesuar më 30 tetor 2020).

164 Dyrmishi, A., (2020). "Albania", pp. 4-8, in "Democracy and the state of emergency: Responses to Coronavirus crisis in the Western Balkans, Croatia, Slovenia – Report One", Friedrich Ebert Stiftung, gjendet në adresën <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16119.pdf> (aksesuar më Octobr 15, 2020).

165 Po aty, f. 7.

166 Filipova, R., (2020) (Ed.) "The Shrinking Space for Media Freedom in Southeast Europe", Center for Study of Democracy and Konrad Adenauer Stiftung, gjendet në adresën <https://csd.bg/publications/publication/the-shrinking-space-for-media-freedom-in-southeast-europe/> (aksesuar më 21 tetor 2020).

Tabela 20: Tiparet kryesore të rolit të medias në pandeminë Covid-19 në Shqipëri

Arritjet	Sfidat
<p>1. Roli parësor i medias si ofruer i rëndësishëm informacioni mes frikës dhe mungesës së informacionit. Media dha informacione shumë të rëndësishme me fushata ndërgjegjësimi dhe ofroi hapësirë të bollshme për ekspertët, mjekët dhe zyrtarët e shëndetit publik.</p>	<p>1. Mungesa e aksesit tek informacioni me izolimin, mungesën e transparencës, monopolizimin e informacionit, informacione kontradiktore dhe çoroditëse.</p>
<p>2. Raportimet e vazhdueshme nga terreni, veçanërisht nga spitalet, treguan mangësi në menaxhimin e krizave, të cilat publiku nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për t'i mësuar, duke marrë parasysh mungesën e informacionit nga burimet qeveritare.</p>	<p>2. Politizimi i medias shqiptare vazhdoi. Gjatë javëve të para të pandemisë, pati një ton përgjithësisht pozitiv ndaj qeverisë dhe u kryen fare pak funksione monitorimi. Megjithatë, teksa pandemia u bë “normaliteti i ri”, media rimori nuancat e saj të zakonshme të kornizimit së bashku me interesat politike dhe të tjera. Disa media të krijuara kohët e fundit dhe disa portale online mbeten profesionale.</p>
<p>3. Mediat sociale luajtën një rol jetik në komunikimin, mirëqenien psikologjike, qëndresën e komunitetit, thirrjen për ndihmë, mbledhjen e donacioneve dhe denoncimin e abuzimeve.</p>	<p>3. Disinformimi dhe lajmet e rreme për Covid-19 ishin të pranishme veçanërisht në mediat sociale.</p>
<p>4. Media shfrytëzoi teknologjinë e përparuar dhe arriti të ndërthurë raportimin profesional me përmbajtjen e krijuar nga qytetarët. Programimi u përshtat me masat e mbylljes përmes përdorimit të platformave online.</p>	<p>4. Interesat e disa mediave (ato të mëdhatë) janë të lidhura ngushtë me pushtetin dhe bizneset, këto të fundit në fushën e shëndetësisë. Një shembull i tillës ishte promovimi në televizion i liberalizimit të testeve molekulare/serologjike në laboratorë privatë, gjë që nga ana e vet do të rriste shumë kostot për taksapaguesit.</p>

6 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull jepen përfundime dhe rekomandime për rolin e shoqërisë civile dhe medias në kohë krizash duke i përcaktuar ato për secilën fazë të fatkeqësisë: para katastrofës -zbutja dhe përgatitja; katastrofa -përgjigja; pas katastrofës -rimëkëmbja. Këtu jepen edhe rekomandimet kryesore për secilin aktor kryesor.

6.1 PËRFUNDIMET

Që nga muaji nëntori i vitit 2019, Shqipëria po vuan efektet e dy krizave të mëdha të njëpasnjëshme - atë të një tërmeti shkatërrimtar me magnitudë 6.4 dhe pandeminë globale Covid-19. Të dy krizat e njëpasnjëshme padyshim që kanë nxjerrë më në pah problemet dhe sfidat ekzistuese dhe të reja, por në të njëjtën kohë kanë treguar edhe arritjet e mëdha dhe aftësitë e shoqërisë shqiptare për t'i ringritur. Krizat ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror si dhe në cilësinë e demokracisë.

Gjatë të dy krizave, shqetësimet kryesore të OSHC-ve dhe mediave lidhen me mungesën e organizimit të institucioneve, koordinimit dhe të kapaciteteve për të reaguar si dhe me mungesën e transparencës dhe aksesit tek informacioni.

